VENDIM
Nr. 91, datë 12.2.2025

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PRIORITARE 2026–2028

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 5, të vendimit nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2026–2028, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, si dhe të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore, që janë pjesë e procesit të buxhetimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

DOKUMENTI I POLITIKAVE PRIORITARE
2026–2028

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS
shkurt 2025

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive
Hyrje
A. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, 2022–2030
B. Kuadri strategjik (strategjitë sektoriale/ndërsektoriale)
C. Prioritetet politike të Bashkimit Evropian 2024–2029
Kreu I
1.1 Reformat afatmesme dhe afatgjata të qeverisë shqiptare
1. Integrimi në Bashkimin Evropian
2. Plani i ri i rritjes, instrumenti për reforma dhe rritje dhe agjenda e reformave
3. Reforma në drejtësi
4. Siguria në komunitet
5. Inteligjenca artificiale si sektor zhvillimi horizontal i së ardhmes
6. Inovacioni, vështrim i shkurtër në raport me konceptin e industrive inovative, kreative dhe kulturore
7. Specializimi inteligjent dhe avantazhi krahasues
8. Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030
Kreu II

2.1 Përparësitë afatshkurtra dhe afatmesme të qeverisë
1. Menaxhimi i financave publike
2. Reforma në administratën publike
3. Lufta kundër korrupsionit
4. Digjitalizimi
5. Bujqësia
6. Turizmi
7. Energjia
2.2 Programet IPA 2022–2027 dhe fushat prioritare të tyre
2.3 Programet e bashkëpunimit me Bankën Botërore
Kreu III
3.1 Kuadri makroekonomik dhe fiskal
1. Vështrim i përgjithshëm i objektivave ekonomikë
2. Zhvillimet e fundit ekonomike
3. Politika fiskale
4. Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm
5. Përshkrimi i risqeve financiare
Kreu IV
4.1 Programe prioritare të reja për periudhën 2025–2027
1. Programi i garancisë rinore
2. Programi i kodimit në shkolla
3. Programi i nxitjes së kodimit
4. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës
5. Mbrojta e natyrës
6. Plani i Parkut Kombëtar për lumin e egër Vjosë
Kreu V
Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Hartimi i Dokumentit të Politikave Prioritare është i parashikuar në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2025 (miratuar në janar 2025), dhe i referohet vendimit "Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2025–2027" (miratuar në janar 2025), si pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Hartimi i Dokumentit të Politikave Prioritare (DPP) është koordinuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe agjencitë e aparatit të Kryeministrisë, me qëllim orientimin e përgjithshëm e racional të procesit të shpërndarjes së burimeve financiare midis sektorëve.

Dokumenti i Politikave Prioritare 2026–2028 për nga përmbajtja e tij është dokumenti që përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe është një nga elementet më të rëndësishme të planifikimit të integruar strategjik. Përmes këtij dokumenti, procesi i hartimit të buxhetit afatmesëm dhe i alokimit të burimeve financiare orientohet drejt përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara.

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare është pjesë integrale kyçe e dokumentit. Lista Unike ka për qëllim forcimin e procesit të menaxhimit të financave publike, procedurave mbi propozimin dhe miratimin e projekteve të investimeve publike të klasifikuara si projekte strategjike, si dhe adresimin e kërkesave të institucioneve ndërkombëtare partnere dhe të institucioneve ndërkombëtare financiare që mbështesin financimin e projekteve të investimeve.

Bazat referenciale për draftimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2026–2028, janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 100 dhe 102;

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 16;
- Programi i qeverisë 2021–2025;
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2024;
- Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027, miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave;
- Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës 2023–2030;
- Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030;
- Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike 2024–2030;
- vendimi nr. 887, datë 27.12.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", i ndryshuar;
- udhëzimi nr. 5, datë 8.4.2024, "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik";
- dokumentet e kuadrit strategjik kombëtar (strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, planet e veprimit, dokumentet e politikave të miratuara deri në dhjetor 2025 etj.);
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030;
- Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022–2025;
- Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027;
- Strategjia Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026;
- Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe plani i veprimit 2022–2029;
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015–2030;
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030;
- Strategjia Sektoriale e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023 –2030;
- Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023–2027;
- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Miturit 2022–2026;
- Dokumenti i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar 2021–2030;
- Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2022–2030;
- Vendimi nr. 594, datë 10.9.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit";
- Vendimi nr. 412, datë 19.6.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit";
- Korniza e Partneritetit me Bankën Botërore 2023–2027;
- Dokumenti i Përgjigjes Strategjike Kombëtare IPA III 2021–2027 – Shqipëri (2022);
- Prioritetet e Programit IPA 2024 & 2026;
- Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022–2026;
- Projekti i Kërkimit për vendet e Ballkanit Perëndimor WB6, "Inventari i Subvencioneve të Energjisë, *OECD Dev. Centre Project* 2024–2025;
- Prioritetet e Programit IPARD III (Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural) 2021–2027;
- Prioritetet e marrëveshjes së huas (2022) midis Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për Mbështetjen e Barazisë Gjinore në Aksesin ndaj Mundësive Ekonomike;
- Programi i Bashkëpunimit Zviceran 2022–2025;
- Programi i Reformave Ekonomike ERP 2025–2027;
- Dakordësimet e Komitetit të Planifikimit Strategjik, janar 2024–janar 2025.

Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) përbën një fazë të ndërmjetme midis kuadrit makro-fiskal trevjeçar dhe përcaktimit të tavaneve buxhetore përkatëse. Tavanet e shpenzimeve për vitet 2026 dhe 2027 janë përcaktuar gjatë PBA 2025–2027. Megjithatë është e vetëkuptueshme, që gjatë kësaj periudhe kohore mund të dalin në pah disa prioritete, të cilat duhet të shqyrtohen nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), përpara se të përfshihen në tavanet e PBA-së.

HYRJE

Përmbajtja e Dokumentit të Politikave Prioritare bazohet në vizionin dhe objektivat e disa dokumenteve qendrore politikash, si: Programi Politik i Qeverisë 2021–2025, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, Agjenda Kombëtare e Reformave (AKR) 2024–2027, Programin e Reformave Ekonomike (ERP) 2025-2027, PKIE 2025–2027, Kuadrin e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022–2026 dhe angazhimet në përmbushjen e OZHQ-ve. Vlen të përmendet edhe kuadri strategjik i Integrimit të Shqipërisë në BE, në kuptimin e rritjes së harmonizimit të prioriteteve të politikave.

A. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030

SKZHIE III është përgatitur nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në bashkëpunim me institucionet e tjera të vendit. Ky dokument përbën kuadrin e politikave afatgjata më të rëndësishme të qeverisë shqiptare, që parashtron vizionin e zhvillimit dhe prioritetet strategjike të Shqipërisë, si një ekonomi në nivelin e sipërm të grupit të vendeve me të ardhura mesatare.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 shtrihet në harkun kohor 2022–2030 dhe vijon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2016–2020 (SKZHI II) në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integrimit të saj në Bashkimin Evropian. Në dallim nga ciklet e mëparshme të kuadrit strategjik, SKZHIE 2030 synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht më të gjatë kohore, duke konsideruar:

- Harmonizimin e zbatimit të SKZHIE 2022–2030 me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030;
- Ndërtimin dhe zbatimin e një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit;
- Shtrirjen deri në vitin 2030 të disa prej strategjive të rëndësishme sektoriale të miratuara, apo në proces përgatitjeje;
- Dobinë e ndërtimit të një kuadri strategjik afatgjatë që ndihmon procesin e integrimit të Shqipërisë në BE brenda një kornize të qartë e të qëndrueshme strategjike;
- Mbështetjen e procesit të buxhetimit afatmesëm (PBA) duke ndërtuar projeksione afatgjata të shpenzimeve buxhetore për arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave të politikave për zhvillimin e vendit.

Procesi i hartimit të SKZHIE 2022–2030 është realizuar përmes koordinimit nga ana e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe angazhimit të një numri të konsiderueshëm institucionesh shtetërore ku përfshihen të gjitha ministritë e qeverisë shqiptare, institucione të pavarura, agjenci të rëndësishme zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të përfshirë.

Përgjatë këtij procesi, SKZHIE III është shoqëruar me konsultime me palët e interesit, shoqërinë civile, përfaqësuesit e biznesit, akademinë dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Tiranë, mbi çdo fushë politike zhvillimi.

SKZHIE III është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, duke përcaktuar vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2022–2030: *"Shqipëria 2030: Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut"*.

SKZHIE III paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive të mëposhtme:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, me fokus të qartë të zhvillimit të gjelbër dhe digjital, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;

- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, veçanërisht të rinjve/të rejave dhe vajzave e grave;

- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde që i përgjigjen anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian;

- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, duke e integruar denjësisht atë me vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian.

Mbështetur në vizionin për zhvillimin e vendit, SKZHIE III bazohet në një qëllim parësor që synon integrimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian dhe tri shtylla kryesore:

1. Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë;
2. Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër;
3. Kohezioni social.

SKZHIE 2022–2030 përcakton përparësitë kryesore të kësaj strategjie në fushat e mëposhtme:

Integrimi evropian;

Lufta ndaj korrupsionit;

Energjia;

Bujqësia;

Turizmi;

Digjitalizimi.

B. KUADRI STRATEGJIK (STRATEGJITË SEKTORIALE/NDËRSEKTORIALE)

Prioritetet e zhvillimit të vendit përcaktohen dhe institucionalizohen përmes kuadrit strategjik, i cili konsiston në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale.

Tabela: Kostoja e zbatimit të dokumenteve strategjike 2026–2028 (në mijë lekë)

Nr.	STRATEGJIA	2026	2027	2028	Totali 2026 - 2028 (000)
1	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030	330,587	330,587	330,587	991,761
2	Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030	44,897,500	44,897,500	44,897,500	134,692,500
3	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030	40,769,730	40,769,730	40,769,730	122,309,190
4	Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029	795,726	795,726	795,726	2,387,178
5	Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023 – 2030	3,445,161	3,445,161	3,445,161	10,335,483
6	Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023 – 2027	481,088	481,088		962,176
7	Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 -2030	285,714	285,714	285,714	857,142
8	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015 – 2030	48,604,000	48,604,000	48,604,000	145,812,000
9	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027	21,882,600	21,882,600		43,465,200
10	Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe Plani i Veprimit	7,876,910	7,940,910	7,940,910	23,758,730
11	Strategjia për zhvillim in e biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të Planit të saj të veprimit	1,200,942	1,200,942		2,401,884
12	Strategjia sektoriale e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030	9,439,233	9,439,233	9,439,233	28,317,699
13	Strategjia sektoriale e Zvogëlimit të Rriskut nga fatkeqësitë 2023 -2030	23,259,160	23,259,160	23,259,160	69,777,480
14	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim in dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	3,353,686	3,353,686	3,353,686	10,061,058
15	Strategjia e Specializim it Inteligjent (S3) 2025-2030	20,703,321	20,703,321	20,703,321	62,109,964
16	Strategjia sektoriale e furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023 – 2030	17,557,825	17,081,326	23,457,655	58,096,806
17	Strategjia Sektoriale e Menaxhimit te Financave Publike 2023 - 2030	3,310,594	3,310,594	3,310,594	9,931,782
18	Strategjia e Kombëtare të Zhvillim it të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030	260,050	260,050	260,050	780,150
19	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Plani Veprimit 2024-2030	638,264	638,264	638,264	1,914,792
20	Strategjia Kombëtare e zhvillim it të Sipërmarrjes Inovative 2024 - 2030 dhe plani i veprimit	262,408	262,408	262,408	787,224
Strategjitë Sektoriale që janë akoma në proces dhe që përfundojnë në 2026					
21	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026	2,875,000			2,875,000
22	Strategjia Kombëtare per Arsimin 2021-2026 dhe Plani i saj i Veprimit	11,657,553			11,657,553
23	Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë për të mitur 2022-2026	3,786,852			3,786,852
24	Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026	1,552,078			1,552,078

Totali i fondeve të nevojshme për të financuar aktivitetet/masat specifike të strategjive të mësipërme të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave specifikë dhe atyre strategjikë kap vlerën e **afro 750 miliardë lekëve ose rreth 7,63 mld euro** (përditësuar vlera për 2026–2028).

C. PRIORITETET POLITIKE TË BASHKIMIT EVROPIAN 2024–2029

Prioritetet e BE-së për ciklin institucional 5-vjeçar janë të përshkruara në Agjendën Strategjike të Këshillit Evropian. Më pas, Komisioni Evropian përcakton prioritetet e tij në udhëzimet politike të Presidentit, të cilat janë hapi i parë në funksionalizimin e prioriteteve të BE-së të përshkruara në Agjendën Strategjike.

Pas zgjedhjeve Evropiane në qershor 2024, BE-ja vendosi një sërë prioritetesh që formësojnë agjendën politike dhe atë të politikëbërjes deri në vitin 2029. Ato shërbejnë për të adresuar sfidat kryesore me të cilat përballen BE-ja dhe qytetarët e saj.

Prioritetet derivojnë nga një dialog ndërmjet liderëve të BE-së, ministrave kombëtarë, institucioneve të BE-së dhe grupeve politike të zgjedhura në Parlamentin Evropian. Në qershor 2024, Këshilli Evropian përcaktoi prioritetet e tij në Agjendën Strategjike të BE-së 2024–2029.

- **Agjenda Strategjike e BE-së për 2024–2029-n**

Në Agjendën Strategjike 2024–2029, të miratuar nga Këshilli Evropian, liderët e BE-së përcaktuan 3 fusha prioritare për të udhëhequr punën e institucioneve të BE-së gjatë këtyre 5 viteve. Në vitet e fundit, BE-ja është përballur me shumë kriza, nga lufta kundër ndryshimeve klimatike deri tek pandemia COVID-19 dhe mbështetja e Ukrainës pas agresionit Rus. Duke u fokusuar në fusha të reja prioritare, BE-ja do të ndihmojë që Evropa të jetë më sovrane dhe më e përgatitur për t'u përballur me sfidat e ardhshme.

3 prioritetet janë:

Një Evropë e lirë dhe demokratike:

- Ruajtja e vlerave evropiane brenda BE-së;
- Mbështetja tek vlerat e BE-së në nivel global;

Një Evropë e fortë dhe e sigurt:

- Sigurimin e veprimit të jashtëm koherent dhe me ndikim;
- Forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së dhe mbrojtjen e qytetarëve të BE-së;
- Përgatitja për një bashkim më të madh dhe më të fortë;
- Ndjekja e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj migracionit dhe menaxhimit të kufijve;

Një Evropë e begatë dhe konkurruese:

- Duke forcuar konkurrencën e BE-së;
- Duke arritur sukses me tranzicionin e gjelbër dhe atë digjital;
- Promovimi i një mjedisi miqësor ndaj inovacionit dhe biznesit;
- Duke përparuar së bashku.

- **Prioritetet e Komisionit Evropian për 2024–2029-n:**

Presidenti i Komisionit përcaktoi 7 prioritete (udhëzime politike) për mandatin 2024–2029 të Komisionit Evropian. Ato bazohen në Agjendën Strategjike të Këshillit të BE-së dhe diskutimet me grupet politike të Parlamentit Evropian.

Prioritetet janë:

Një plan i ri për prosperitetin dhe konkurrencën e qëndrueshme të Evropës

Lehtësimi i të bërit biznes për të nxitur rritjen ekonomike, duke mbështetur industritë konkurruese të BE-së dhe duke krijuar vende pune cilësore, duke zhvilluar një ekonomi rrethore dhe elastike që vendos kërkimin dhe inovacionin në qendër, dhe përshpejton investimet, duke trajtuar hendeqet e aftësive dhe të punës, dhe duke u udhëhequr drejt inovacionit të teknologjisë digjitale.

Një epokë e re për mbrojtjen dhe sigurinë evropiane

Duke siguruar që qytetarët evropianë të jenë më të sigurt duke ndërtuar një Bashkim Evropian të Mbrojtjes, duke adresuar të gjitha kërcënimet *online* dhe *offline*, dhe duke qenë të përgatitur për të reaguar ndaj krizave. Forcimi i kufijve tanë të përbashkët dhe administrimi i migracionit në mënyrë të drejtë dhe të vendosur.

Mbështetja e njerëzve, forcimi i shoqërive tona dhe modelit tonë social

Mbajtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës që gëzojmë sot në Evropë, duke promovuar drejtësinë sociale në ekonominë moderne, duke forcuar solidaritetin midis qytetarëve, duke ribashkuar shoqëritë tona dhe duke mbështetur të rinjtë, dhe duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë.

Mbështetja e cilësisë së jetës sonë: Siguria ushqimore, uji dhe natyra

Ndërtimi i një sistemi bujqësor dhe ushqimor konkurrues dhe elastik, dhe ruajtja e biodiversitetit për të mbështetur fermerët tanë dhe për të mbrojtur ushqimin tonë të shëndetshëm. Përshtatja dhe përgatitja për një klimë në ndryshim për të qenë gati dhe për të ndihmuar të prekurit.

Mbrojtja e demokracisë sonë, ruajtja e vlerave tona

Mbrojtja e demokracisë dhe rritja e elasticitetit, dhe gatishmërisë shoqërore, forcimi i shtetit të së drejtës për një shoqëri të drejtë dhe mirëfunksionale, përkrahja e angazhimit dhe pjesëmarrjes qytetare për të sjellë idetë e qytetarëve në zemër të politikëbërjes.

Një Evropë globale: Duke amplifikuar fuqinë dhe partneritetet tona

Puna për zgjerimin e BE-së për të rritur ndikimin tonë në skenën globale, duke u fokusuar në fqinjësinë tonë më të gjerë për të promovuar paqen, partneritetet dhe stabilitetin ekonomik; ndjekja e një politike të re ekonomike të jashtme dhe reformimi i sistemit ndërkombëtar për ta bërë atë të përshtatshëm për botën e sotme.

Jetësojmë së bashku objektivat dhe e përgatisim unionin tonë për të ardhmen

Zhvillimi i një buxheti më të thjeshtë dhe me ndikim të BE-së për të ofruar fondet aty ku ato kanë më shumë rëndësi, zbatimin e reformave për të garantuar funksionimin e duhur të një bashkimi më të madh dhe forcimin e partneritetit midis Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian për të na ndihmuar të jetësojmë objektivat në mënyrë më efektive së bashku.

Për shkak të ndryshimeve në realitetin gjeopolitik gjatë viteve të fundit, prioritetet politike vënë theksin më të madh në rolin e jashtëm të BE-së, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen dhe zgjerimin. Politika e jashtme, në përgjithësi, tani influencon mbi të gjitha fushat e politikave dhe, në rastin e Agjendës Strategjike të Këshillit Evropian, politika e **brendshme dhe e jashtme ndërthuren sistematikisht.**

Fokusi në sovranitetin dhe sigurinë ekonomike, është një risi në prioritetet politike afatgjata të BE-së. Ndërsa më parë përdorej vetëm në kontekstin e politikave digjitale, fokusi mbi sovranitetin përdoret tani më gjerësisht në sektorë të ndryshëm strategjikë, veçanërisht në mbrojtje, energji, ushqim dhe në politikat ekonomike.

Kjo pasqyron mësimet e nxjerra nga BE-ja nga pandemia COVID-19 dhe lufta në Ukrainë. Një thirrje për sovranitet në këta sektorë strategjikë është përmendur në konkluzione të shumta të Këshillit Evropian gjatë viteve të fundit dhe tani përdoret për herë të parë në prioritetet strategjike afatgjata.

KREU I

1.1 REFORMAT AFATMESME DHE AFATGJATA TË QEVERISË SHQIPTARE

1. Integrimi në Bashkimin Evropian

Procesi i negociatave

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është synimi politik dhe strategjik i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit, dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit. Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisës ka përcaktuar se: "*Evropa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë*".[1]

Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme, në lidhje me prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, politikën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar,

[1] https://kryeministria.al/ëp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf.

mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administrimin publik (administrata publike në veçanti), të cilat mbeten prioritete edhe në kuadër të procesit të negociatave (sidomos në lidhje me Grupkapitujt themelorë, si dhe kapitujt 23 dhe 24).

Me vendimin nr. 424, datë 22.6.2022, të Këshillit të Ministrave, u miratua Deklarata Hapëse e Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Më 19 korrik 2022, u zhvillua Konferenca Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, ku Shqipërisë iu dha formalisht korniza e përgjithshme dhe kuadri negociues për anëtarësimin.

Komisioni filloi menjëherë procesin e shqyrtimit analitik të *acquis* të BE-së (*screening*), i cili u konkretizua në 2 faza, nëpërmjet: i. takimeve shpjeguese – ku shërbimet e Komisionit Evropian paraqitën zhvillimet e legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian; dhe ii. takimet bilaterale – ku pala shqiptare analizon dhe paraqet situatën aktuale ku ndodhet vendi përkundrejt kërkesave të *acquis* të BE-së, përmes prezantimeve për çështje të ndryshme sipas kapitujve dhe kritereve.

Ky proces intensiv maratonë përgjatë 14 muajve, nga 15 shtatori 2022 deri në 24 nëntor 2023, ku u angazhuan mbi 1800 zyrtarë publik, që përfaqësonin 157 institucione shtetërore dhe 32 institucione të pavarura. U zhvilluan 67 takime dypalëshe BE–Shqipëri, ku u prezantuan sipas agjendave të përcaktuara nga Komisioni Evropian 777 prezantime nga pala shqiptare.

Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit analitik të *acquis* me Komisionin Evropian (*screening*), bazuar në letrën e Presidencës Spanjolle datë 30.11.2023, Shqipëria përgatiti dy piketat hapëse të negociatave për Grupkapitullin e I "Themelorët":

- Udhërrëfyesi "Shteti i së Drejtës";[2]
- Udhërrëfyesi "Reforma në Administratën Publike"[3].

Piketat hapëse u miratuan me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030" dhe u dorëzuan zyrtarisht pranë Bashkimit Evropian, nga Republika e Shqipërisë, më datë 13.12.2023.

Gjithashtu, sipas metodologjisë së zgjerimit të Bashkimit Evropian, Republika e Shqipërisë hartoi edhe udhërrëfyesin "Funksionimi i institucioneve demokratike"[4], si një kërkesë e Bashkimit Evropian në këtë metodologji, edhe pse nuk përbën kusht për procesin e negociatave. Ky udhërrëfyes u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 611, datë 2.10.2024, "Për miratimin e udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike".

Pas marrjes së letrës zyrtare nga Presidenca Hungareze, më datë 25.9.2024, mbi dorëzimin e Pozicionit Negociues të Republikës së Shqipërisë për Grupkapitullin e I "Themelorët", Këshilli i Ministrave miratoi, në datë 2.10.2024, "Pozicionin Negociues për Grupkapitullin e I 'Themelorët'", i cili iu përcoll po në këtë ditë Presidencës Hungareze, si dhe Komisionit Evropian, me qëllim hapjen e negociatave për Grupkapitullin e I.

Pozicioni Negociues trupëzon në mënyrë integrale masat e përcaktuara në piketat hapëse – udhërrëfyesi "Shteti i së Drejtës" dhe udhërrëfyesi "Reforma në administratën publike", por edhe ato në udhërrëfyesin "Për funksionimin e institucioneve demokratike", si dhe përcakton masa për përafrimin gradual dhe të plotë për çdo kapitull tjetër të *acquis* të Bashkimit Evropian, të përfshirë në Grupkapitullin e I "Themelorët", drejt përmbushjes së kritereve për anëtarësim, deri në vitin 2030.

Në këtë dokument, Shqipëria ka ndërmarrë, gjithashtu, reforma dhe masa të domosdoshme për të përmbushur kërkesat dhe standardet evropiane në fushat kyçe për çdo kriter dhe kapitull, si më poshtë:

---

[2] https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/736/a53e6796-bf25-47e7-b157-0607b1aab777;q=udh%C3%ABrr%C3%ABfyes

[3] https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/737/01303320-3536-4f02-991f-7f59fcde80b3;q=udh%C3%ABrr%C3%ABfyes

[4] https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611/a556637f-882f-4a0c-9eaa-ac6bbd350ba4;q=udh%C3%ABrr%C3%ABfyes

- **Sa i përket funksionimit të institucioneve demokratike**, Shqipëria angazhohet që në të ardhmen:

- Të modernizojë procesin zgjedhor, duke zbatuar plotësisht identifikimin biometrik të votuesve dhe numërimin elektronik të votave për të siguruar një proces votimi të saktë dhe transparent;

- Të përmirësojë përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve dhe të sigurojë depolitizimin e komisioneve zgjedhore, duke krijuar, gjithashtu, kushte të favorshme për votimin e diasporës;

- Të thellojë proceset e digjitalizimit të Kuvendit, duke lehtësuar përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset legjislative përmes konsultimit publik;

- Të përmirësojë transparencën në Kuvend përmes përditësimit të Kodit të Sjelljes për Deputetët dhe garantimit të integritetit në takimet me grupet e interesit.

- Sa i përket **Kapitullit 23, "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore"**, Shqipëria synon të:

- Sigurojë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit përmes reformave të vazhdueshme që përmirësojnë cilësinë dhe eficiencën e gjykatave;

- Thellojë strategjitë kundër korrupsionit, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar duke përmirësuar mekanizmat ligjorë për parandalimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

- Sa i përket **Kapitullit 24, "Drejtësia, Liria dhe Siguria"**, Shqipëria është e angazhuar për të:

Forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore, përmes:

- bashkëpunimit të vazhdueshëm me agjenci të BE-së, si EUROPOL-i dhe FRONTEX-i;

- intensifikuar hetimet financiare dhe luftën kundër pastrimit të parave, duke forcuar strukturat e zbatimit të ligjit dhe përmirësuar sistemet e kontrollit të transaksioneve financiare;

- përmirësuar politikat e migracionit dhe azilit, duke respektuar standardet evropiane dhe duke u angazhuar për një trajtim të drejtë dhe të ligjshëm të azilkërkuesve dhe emigrantëve.

- Sa i përket **"Kriterit Ekonomik"**, Shqipëria synon të forcojë stabilitetin ekonomik, të forcojë konkurrencën në tregun e brendshëm dhe të përmirësojë klimën e biznesit përmes lehtësirave ligjore dhe rregullatore.

- Sa i përket **Kapitullit 5, "Prokurimi Publik"**, Shqipëria synon të rrisë transparencën në proceset e prokurimit publik, duke përdorur teknologji moderne si inteligjenca artificiale dhe digjitalizimin e plotë të tenderimeve për të minimizuar rreziqet e korrupsionit.

- Sa i përket **Kapitulli 18, "Statistikat"**, Shqipëria do të vijojë të standardizojë metodologjitë e mbledhjes së të dhënave sipas normave dhe metodologjive ndërkombëtare për të siguruar transparencë dhe besueshmëri.

- Sa i përket **Kapitullit 32, "Kontrolli Financiar"**, Shqipëria angazhohet të vijojë përmirësimin e kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimin publik për të rritur llogaridhënien dhe eficiencën e shpenzimeve publike.

Në Pozicionin Negociues të Grupkapitullit të I "Themelorët", **Republika e Shqipërisë e pranon plotësisht dhe angazhohet për përfarimin dhe zbatimin e plotë të *acquis* të Bashkimit Evropian të Grupkapitullit të I "Themelorët", që hyn në fuqi nga data e dorëzimit të Pozicionit Negociues**.

Në këtë kuptim, **Republika e Shqipërisë nuk kërkon të negociojë me Bashkimin Evropian masa/periudha transitore, gjithashtu, nuk parashikon të paraqesë kërkesa ndaj Bashkimit Evropian për "shmangie" (*derogation*) të mundshme në përafrimin me *acquis* të BE-së për këtë grupim kapitujsh.**

Pas vlerësimit të Pozicionit Negociues të Shqipërisë, strukturat e Bashkimit Evropian zhvilluan Konferencën e 2-të Qeveritare, datë 15.10.2024, për hapjen e negociatave për Grupkapitullin e I "Themelorët".

Hapja e negociatave për Grupkapitullin e I "Themelorët" është një hap i rëndësishëm që pasqyron angazhimin e vendit për të përmbushur standardet evropiane dhe për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme dhe më të sigurt për qytetarët e tij.

Në vijim të Konferencës së Dytë Ndërqeveritare, nga ana e shërbimeve të Komisionit Evropian u përcoll dokumenti i Qëndrimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian, i cili shpreh qëndrimin e

përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërinë. Dokumenti, i hartuar bazuar në Pozicionin Negociues të Shqipërisë, përcakton **piketat e ndërmjetme si në nivel horizontal për Grupkapitullin e I, ashtu edhe në mënyrë të veçantë për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", por dhe piketa mbyllëse për Kapitujt 5 "Prokurimi Publik", 18 "Statistikat" dhe 32 "Kontrolli Financiar".**

Ky dokument i nënshtrohet parimeve të negocimit të miratuara gjatë kësaj Konference. Asnjë kapitull nuk mund të mbyllet pa përmbushjen e Piketave të Ndërmjetme, të cilat janë kusht për të vijuar më tej me diskutimin mbi Piketat Mbyllëse të Grupkapitullit të I.

Në vijimësi të procesit të negociatave gjatë vitit 2024, Shqipëria arriti t'i hapë ato edhe për Grupkapitullin e VI "Marrëdhëniet me Jashtë".

Në datën 25 nëntor 2024, Presidenca Hungareze e Këshillit të BE-së dërgoi zyrtarisht letrën për paraqitjen e dokumentit të Pozicionit Negociues për Grupkapitullin e VI "Marrëdhëniet me jashtë", për çeljen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian të Republikës së Shqipërisë.

Dokumenti i Pozicionit Negociues të Grupkapitullit të VI "Marrëdhëniet me jashtë", u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 4.12.2024, dhe iu përcoll po në këtë ditë Presidencës Hungareze, si dhe Komisionit Evropian, me qëllim hapjen e negociatave për Grupkapitullin e VI.

Pozicioni Negociues shpreh qëndrimin politik dhe politikëbërës, strategjik, por edhe teknik të Republikës së Shqipërisë, lidhur me çështjet e përfshira në kapitullin 30 "Marrëdhëniet me Jashtë" dhe kapitullin 31 "Politika e jashtme, siguria dhe mbrojtja", përmes nismave dhe masave që përcakton, si dhe parashikueshmërinë kohore për përmbushjen e tyre, afatet e përafrimit gradual dhe të plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian, bazuar në një analizë të detajuar të situatës ekzistuese të kuadrit strategjik, atij të politikave publike, atij ligjor dhe institucional, të kapaciteteve etj., si dhe sfidat e zbatimit të *acquis* të BE-së në vendin tonë, duke ofruar një vizion të qartë për procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Republika e Shqipërisë, sa i përket Grupkapitullit të VI "Marrëdhëniet me jashtë", nuk ka parashikuar të paraqesë kërkesa ndaj Bashkimit Evropian për "shmangie" (*derogation*) të mundshme të përafrimit të *acquis* të BE-së.

Në dokumentin e Pozicionit Negociues, Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë, gjithashtu, angazhimet për masa të domosdoshme për të përmbushur kërkesat dhe standardet evropiane në fushat kyçe për çdo kriter dhe kapitull, si më poshtë:

- **Sa i përket politikës së përbashkët tregtare,** Republika e Shqipërisë, nëpërmjet përafrimit të vazhdueshëm me standardet e OBT-së dhe pjesëmarrjes aktive në nismat shumëpalëshe, synon të forcojë lidhjet e saj ekonomike dhe të nxisë rritjen e qëndrueshme të tregtisë. Deri në datën e anëtarësimit në BE Shqipëria është e angazhuar që në kontekstin shumëpalësh dhe dypalësh të jetë në përputhje me qëndrimin e BE-së në politikën e përbashkët tregtare.

- **Sa i përket rregullave specifike të tregtisë, në lidhje me kontrollet e eksporteve me përdorim të dyfishtë,** Republika e Shqipërisë është e angazhuar për të harmonizuar kuadrin e saj legjislativ dhe rregullator me *acquis* të BE-së për transferimin ndërkombëtar të mallrave me përdorim të dyfishtë.

- **Sa i përket investimeve**, Republika e Shqipërisë është e angazhuar të rrisë përpjekjet e saj në tri fusha kryesore:

- në tërheqjen e investitorëve që kryejnë investime me përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm;

- në rritjen e përpjekjeve për t'u angazhuar me investitorët potencial dhe për të zgjeruar programet ekzistuese, duke synuar të tërheqë dhe mbajë një spektër më të gjerë investimesh; dhe

- të përmirësojë bazat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD-ve), duke përditësuar dhe modernizuar kuadrin ligjor për të krijuar një mjedis më të favorshëm për investime.

- **Politika humanitare:** Angazhimi për krijimin e një strukture formale të dedikuar për ndihmën humanitare, duke krijuar një njësi të specializuar, duke caktuar një buxhet të dedikuar, duke zhvilluar një

strategji gjithëpërfshirëse të ndihmës humanitare dhe duke vendosur protokolle të qarta për koordinim dhe bashkëpunim.

- **Sa i përket institucioneve dhe proceseve vendimmarrëse**, Republika e Shqipërisë do të rrisë më tej angazhimin e saj në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (CFSP), duke kontribuar në takimet e Këshillit të BE-së të Çështjeve me Jashtë (FAC) dhe takimet e Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) – Ballkani Perëndimor në nivele të larta zyrtare. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të zbatojë vendimet e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (CFSP) për masat kufizuese nëpërmjet vendimeve zyrtare të Këshillit të Ministrave, duke siguruar që sanksionet dhe masat kufizuese të BE-së të zbatohen me saktësi brenda vendit.

- **Dialogu politik**, Republika e Shqipërisë angazhohet të ketë një dialog politik me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, në përputhje me prioritetet e politikës së jashtme dhe objektivat strategjikë.

- **Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë**, Republika e Shqipërisë është, gjithashtu, e përkushtuar të përafrohet me kornizat ndërkombëtare të mospërhapjes dhe të adoptojë praktikat më të mira të BE-së për zbatimin dhe vlerësimin efektiv të masave kufizuese. Ky përafrim me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (CFSP) pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për të rritur rolin e saj në sigurinë rajonale dhe globale, dhe për të siguruar përputhjen me standardet ndërkombëtare të sanksioneve**.**

- **Politika e përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes**, Republika e Shqipërisë është thellësisht e angazhuar në bashkëpunimin ndërkombëtar të mbrojtjes për ruajtjen e interesave kombëtarë dhe për të promovuar paqen dhe stabilitetin global.

Pas vlerësimit të Pozicionit Negociues të Shqipërisë, më datë 17 dhjetor 2024, u zhvillua Konferenca e 3-të Ndërqeveritare për hapjen e Grupkapitullit të VI "Marrëdhëniet me Jashtë". Kjo konferencë rikonfirmon angazhimin serioz të të gjitha institucioneve tona, si dhe vërteton vullnetin politik për të qenë pjesë e familjes evropiane.

Pas zhvillimit të dy konferencave ndërqeveritare dhe hapjen e 7 kapitujve dhe 3 kritereve, vijon procesi i përgatitjes së draftpozicioneve negociuese edhe për 4 grupkapitujt e tjerë me synimin ambicioz për hapjen e tyre brenda vitit 2025.

Progresi i reformave themelore të integrimit

Komisioni Evropian, publikoi më datë 30 tetor 2024[5] Raportin për Shqipërinë për vitin 2024, ku vlerëson se: "*Në Shqipëri, autoritetet kanë deklaruar vazhdimisht angazhimin e vendosur politik për integrimin në BE si prioritetin strategjik të vendit dhe kanë ruajtur një nivel të lartë ambicie për të ecur përpara në negociatat e anëtarësimit.* ***Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres në reformat nën Grupkapitullin e I "Themelorët", veçanërisht në reformën gjithëpërfshirëse në drejtësi dhe procesin e rivlerësimit kalimtar****, përfundimi i të cilit është i pashmangshëm, nëpërmjet rezultateve të mira në çështjet antikorrupsion, duke rritur kapacitetet e saj në hetimet financiare kundër krimit të organizuar. Angazhimi aktiv i Shqipërisë gjatë mandatit të saj si anëtare jo e përhershme në Këshillin e Sigurimit të OKB-së deri në fund të vitit 2023, si dhe të dhënat e saj të përafrimit të plotë me politikën e përbashkët dhe të jashtme të sigurisë së BE-së, dëshmojnë për zgjedhjen e saj strategjike për anëtarësimin në BE dhe rolin e një partneri të besueshëm ndërkombëtar...".*

Gjithashtu, në raport Komisioni rikonfirmon mbështetjen në rrugëtimin e vendit drejt anëtarësimit në BE: "*...Qeveria shqiptare sinjalizoi objektivin e saj për mbylljen e negociatave të anëtarësimit deri në fund të vitit 2027 dhe Komisioni është i gatshëm ta mbështesë këtë objektiv ambicioz. Për këtë qëllim, është thelbësore që autoritetet të shtojnë ritmin e reformave të orientuara nga BE-ja, veçanërisht në shtetin e së drejtës, duke konsoliduar historikun në zbatimin e ligjit, në luftimin efektiv të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në promovimin e të drejtave themelore, përfshirë lirinë e medias, të drejtave pronësore dhe pakicave*". Komisioni ka vlerësuar linjëzimin e plotë që Shqipëria ka arritur në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Gjatë mandatit të saj si një anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, Shqipëria u angazhua në mënyrë aktive si bashkëmbajtëse e rezolutave që dënojnë luftën e agresionit të

[5] https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

Rusisë kundër Ukrainës, në përputhje me qëndrimin e BE-së, duke përfshirë masat kufizuese dhe sanksionet kundër Rusisë. Qëndrimi i Shqipërisë dërgon një sinjal të fortë për zgjedhjen strategjike të anëtarësimit në BE dhe për rolin e saj si një partner i besueshëm.

Reforma e sistemit të drejtësisë dhe çdo veprim i ndërmarrë nga qeveria në funksion të sundimit të ligjit ka për qëllim përfundimtar krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës në Shqipëri, i cili është në gjendje të ofrojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe për të zbatuar legjislacionin e përafruar me *acquis* të BE-së. Strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë ngritur dhe janë funksionale.

Miratimi i **Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës 2023–2030** është një përpjekje kyçe e qeverisë për konsolidimin e mëtejshëm të arritjeve të reformës në fushën e gjyqësorit në mënyrë të qëndrueshme dhe konsistente, që synon që të rrisë më tej pavarësinë, llogaridhënien, cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë. Ky udhërrëfyes planifikon vazhdimin më me intensitet të kryerjes së kontrolleve të rregullta të përshtatshmërisë ligjore, si dhe miratimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin, efikasitetin dhe rritjen e besimit të qytetarëve, në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane duke përforcuar në vazhdimësi parimet e reformës së vitit 2016.

Sistemi gjyqësor ka shënuar përmirësime të rëndësishme, duke filluar me përzgjedhjen e plotë të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët tashmë funksionojnë me strukturat e tyre të plota dhe me drejtues të rinj. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka arritur një rezultat të jashtëzakonshëm, me 99.9% të çështjeve të përfunduara. Njëkohësisht, janë hedhur hapa të rëndësishëm për digjitalizimin e drejtësisë, përmes zhvillimit të një Sistemi të Menaxhimit të Çështjeve, i cili synon modernizimin e gjykatave. Për më tepër, janë hartuar strategji të reja ndërsektoriale, si ajo për drejtësinë dhe kundër korrupsionit për periudhën 2024–2030, duke përfshirë konsultime të gjera publike. Ndryshimet në rregulloren e Shkollës së Magjistraturës, në përputhje me standardet më të larta të BE-së, sigurojnë një proces më të drejtë dhe më cilësor për pranimet.

Udhërrëfyesi për "Funksionimin e Institucioneve Demokratike", i miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 611, datë 2 tetor 2024, përcakton masat për përmirësimin e funksionimit demokratik të institucioneve në Shqipëri. Një arritje kyçe deri më tani në zbatimin e tij është miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në korrik 2024, të cilat mundësojnë votimin e shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit, duke përmbushur një detyrim të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e pjesëmarrjes demokratike dhe përfshirjen e diasporës në proceset vendimmarrëse.

Përparim është arritur edhe në **Reformën në Administratën Publike** dhe zbatimin e kuadrit strategjik dhe atij ligjor. Vlerësimi periodik rajonal i kryer në vitin 2024 nga OECD/SIGMA mbi performancën e administratës publike, si monitorimi më reputativ i fushës, rikonfirmon performancën e Shqipërisë si lider rajonal në funksionimin e administratës publike në disa fusha tematike, duke përfshirë menaxhimin e financave publike, shërbimin publik dhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin, dhe koordinimin e politikave. Në total, Shqipëria shënon vlera më të larta se mesatarja rajonale për 5 nga 6 parimet e administratës publike, mbi bazën e të cilave kryhet vlerësimi.[6]

---

[6] Parimet e OECD/SIGMA për Administratën Publike janë:
a) Kuadri strategjik;
b) Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
c) Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
d) Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja;
e) Shërbimet publike dhe digjitalizimi;
f) Menaxhimi i financave publike.



Në pjesën e strategjive të fushës së RAP-së (PAR), pesë (5) strategjitë janë miratuar nga Këshilli i Ministrave; Strategjia Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2023–2030, Agjenda Digjitale 2022–2026, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2023–2030 (qershor 2024) dhe Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, (kjo e fundit i përket grup dokumenteve strategjike të rëndësisë së veçantë, miratimi i të cilit është kusht për avancimin e reformës në fushën e luftës kundër korrupsionit në vlerësimin e raportit *Screening* për Grupkapitullin e Parë, si dhe Raportit Vjetor të Komisionit Evropian, si dhe mbetet kyç në avancimin e zbatimit të Agjendës së Reformave në kuadër të Planit të Rritjes 2024–2027, ndërsa Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike është drejt finalizimit, e cila parashikohet të miratohet në katërmujorin e parë të vitit 2025. Të gjitha strategjitë e reja në fushën e Reformës në Administratën Publike kanë kohëzgjatje deri në vitin 2030, në harmonizim të plotë me agjendën kombëtare për integrimin evropian. Kostimi i të gjitha strategjive aplikohet në bazë të metodologjisë së buxhetit afatmesëm dhe afatshkurtër që parasheh kostimin e aktiviteteve, rezultateve dhe objektivave të programeve buxhetore.

Me vendimin nr. 29, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin", u miratua fusha e përgjegjësisë shtetërore e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Plotësimi i kabinetit qeveritar prej janarit 2024 me ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, konsiderohet, gjithashtu, një dëshmi e vëmendjes së shtuar ndaj prioriteteve të deklaruara, në drejtim të luftës kundër korrupsionit për të sinergjizuar punën e institucioneve të ekzekutivit në raport me politikat antikorrupsion të qeverisë dhe zbatuar të gjitha zotimet, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Krahas marrjes së rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, rol ky, i krijuar për të udhëhequr angazhimin qeveritar për:

- Zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë; dhe
- Udhëheqjen dhe koordinimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave për menaxhimin, energjizimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore të administratës publike.

Në vlerësimin e fundit të vitit 2024, OECD/SIGMA e vlerëson emërimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin si një tregues të qartë të përkushtimit të qeverisë shqiptare për garantimin e drejtimit politik të Reformës në Administratën Publike.

Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030 është miratuar nga Qeveria Shqiptare në dhjetor 2023, si piketë hapëse e Grupkapitujve të I "Themelorët", në kuadër të

negociatave për anëtarësim në BE. Udhërrëfyesi shërben si dokumenti kyç udhëheqës i prioriteteve për politikat shtetërore dhe masat në nivel ligjor dhe rregullator që do të duhet të ndërmerren deri në vitin 2030 për avancimin e Reformës në Administratën Publike drejt përafrimit me standardet evropiane. Mes parimeve kryesore që karakterizojnë masat e parashikuara në udhërrëfyes janë garantimi i harmonizimit midis planifikimit të buxhetit dhe politikave publike, mirëpërcaktimi, monitorimi dhe vlerësimi i objektivave të politikave, transparenca dhe qëndrueshmëria e planifikimit të financave publike, si edhe zhvillimi i politikave publike përmes një procesi të hapur, të bazuar në evidenca dhe analiza solide, koherente dhe të mirëkoordinuara në të gjitha nivelet e qeverisjes. Përmes këtyre masave të ndërmarra në kuadër të agjendës kombëtare për integrimin evropian, synohet ngritja në një nivel të ri të performancës së qeverisjes së integrimit evropian për "Themelorët" drejt përafrimit me standardet evropiane.

Pesë institucione themelore përbëjnë **Qendrën e Qeverisjes** (*Centre of Government*): Zyra e Kryeministrit, Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (sipas ndryshimeve të fundit në qeveri), ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) drejtohet nga Kryeministri dhe përfshin ministrat si anëtarë. Ai drejton procesin e reformave dhe merr vendime.

Në vitin 2024, Këshilli i Ministrave miratoi paketën e re strategjike kundër korrupsionit, e cila përfshin **Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030** dhe Planin e Veprimit 2024–2026, së bashku me Pasaportën e Indikatorëve. Si një nga 5 strategjitë përbërëse të kuadrit gjithëpërfshirës strategjik të Reformës në Administratën Publike, dhe njëherësh si një nga dokumentet kyçe për koordinimin e politikave për thellimin e luftës kundër korrupsionit. Përmes masave dhe aktiviteteve të parashikuara, Strategjia e re adreson gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit për Shqipërinë të identifikuara nga Komisioni Evropian, GRECO dhe vlerësime të organizatave lokale. Strategjia 2024–2030 ruan të njëjtën strukturë organizimi në tre Qëllime Politikash në përputhje me 3 qasjet e mirëkonsoliduara të luftës kundër korrupsionit: i. Parandalimi; ii. Ndëshkimi; dhe iii. Edukimi e ndërgjegjësimi për luftën kundër korrupsionit.

Risitë kryesore të paketës strategjike synojnë thellimin e luftës kundër korrupsionit në drejtimet e mëposhtme:

- Kryerja e vlerësimeve të riskut me synim parandalimin e korrupsionit në sektorë me rrezik të lartë korrupsioni, si të drejtat pronësore, tatimet, doganat, shëndetësia, arsimi dhe prokurimi publik. Këta sektorë janë identifikuar bazuar në gjetjet e Raporteve të Progresit Vjetor dhe të Raportit të Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grupkapitujt e Themelorëve;
- Rishikimi i legjislacionit kombëtar me synim përafrimin me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane të kuadrit ligjor për konfliktin e interesit, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, lobimin, financimin e partive politike dhe luftën kundër përfshirjes së zyrtarëve të huaj në ryshfet në transaksionet ndërkombëtare;
- Forcimi i mekanizmave për parandalimin e korrupsionit në qeverisjen vendore;
- Thellimi i partneritetit me sektorin privat për promovimin e integritetit dhe rritje të ndërgjegjësimit dhe bashkëveprimit proaktiv të grupeve të ndryshme shoqërore në luftën kundër korrupsionit;
- Investimi i shtuar për edukimin e të rinjve për integritetin dhe sundimin e ligjit;
- Forcimi i strukturave ligjzbatuese me synim krijimin e një historiku të fortë për hetimin, ndjekjen penale, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me korrupsionin;
- Përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit;

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026 (i pari në zbatim të saj) ka një kosto prej ALL 1.033 miliardë, për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën 3-vjeçare 2024–2026, të cilat do të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave specifikë dhe atyre strategjikë të DPP për vitet 2026–2028.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030 dhe Plani i Veprimit 2023–2026 është hartuar dhe miratuar me VKM-në nr. 390, datë 12.6.2024. Ky dokument merr në konsideratë zhvillimet

dhe progresin e rezultuar nga zbatimi i strategjisë së MFP 2019–2022, reformat përkatëse të kryera, si dhe adreson mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë dhe sfidat e hasura. Strategjia ka marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit në fushën e financave publike, si ato kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të krijojë një sistem të menaxhimit të financave publike që garanton transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale, efikasitet dhe barazi në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimit ekonomik që të sigurojë një integrim të lehtë dhe të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE). Masat e reformës së MFP-së janë formuluar në gjashtë shtylla: 1. Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut; 2. Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent; 3. Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave; 4. Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit; 5. Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik; 6. Mbikëqyrja e jashtme.

Strategjia Kombëtare e Migracionit 2024–2030 dhe plani i saj i veprimit 2024–2026 është miratuar nga Qeveria Shqiptare, në maj 2024. Ajo siguron një kornizë të plotë për qeverisjen e duhur të migracionit në vend, deri në vitin 2030, duke adresuar edhe detyrimet e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Dokumenti strategjik përbëhet nga katër qëllime kryesore politike, që janë: i. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri; ii. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal; iii. Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare; iv. Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve, dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme.".

Fusha e prokurimit publik në Shqipëri është vlerësuar me nota të larta në treguesit përkatës duke marrë vlerësim maksimal sa i takon cilësisë së kuadrit ligjor në fushën e prokurimit, kapaciteteve institucionale në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe eficiente, si dhe sistemit të shqyrtimit të ankesave.

Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030, si dhe planit të veprimit për zbatimin e saj 2024–2027, të miratuara me VKM-në nr. 304, datë 22.5.2024, janë në koherencë të plotë me objektivat ndërkombëtarë për zhvillim të qëndrueshëm, me kuadrin ligjor të BE-së në këtë fushë, si dhe me angazhimet e ndërmarra nga pala shqiptare në takimet bilaterale me BE-në.

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është garantimi i një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv, në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para (*value for money*).

Risia që planifikon të sjellë qeveria shqiptare në fushën e prokurimeve publike është dizenjimi dhe implementimi i një sistemi dinamik të blerjeve. Do të krijohet një sistem i informatizuar që nëpërmjet Inteligjencës Artificiale do të zhvillojë procedurat dhe shpalljen e fituesit të një tenderi. Kjo do të jetë mënyra e re e funksionimit të prokurimeve publike, duke rritur ndjeshëm nivelin e transparencës dhe integritetin e sistemit të prokurimeve publike.

Procesi i integrimit evropian i jep shtysë arritjes së të gjithë objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, pjesë e Agjendës 2030 dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhet me realizimin e Objektivit 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet" dhe synimit 16.6 "Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet".

2. Plani i Ri i Rritjes, instrumenti për reforma dhe rritje, dhe agjenda e reformave

Komisioni Evropian, më 8 nëntor të vitit 2023, publikoi **Planin e Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor**. Synimi i Planit të Ri të Rritjes është për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të përshpejtuar konvergjencën socio-ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë një hendek të dallueshëm konvergjence krahasuar me vendet anëtare të BE-së. Objektivi kryesor i Planit të

Rritjes, përveç reduktimit të pabarazisë me vendet e BE-së, është t'u mundësojë vendeve të Ballkanit Perëndimor të nxisin reformat dhe investimet për të përshpejtuar ndjeshëm shpejtësinë e procesit të anëtarësimit dhe zhvillimin e rritjes së tyre ekonomike. Kjo iniciativë e re zhvillimore ofron mundësinë për mbështetje financiare deri në 6 miliardë euro, për periudhën 2024–2027, për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe mundësinë e integrimit të përshpejtuar në Tregun e Vetëm Evropian, në disa drejtime, edhe para anëtarësimit.

Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor bazohet në katër shtylla: **a) rritja e integrimit me tregun e vetëm të BE-së; b) nxitja e integrimit ekonomik rajonal, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, duke zbatuar plotësisht Planin ekzistues të Veprimit të Përbashkët të Tregut Rajonal; c) përshpejtimi i reformave themelore, duke përfshirë grupimin e parë themelor, mbështetja e rrugës së Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, përmirësimi i rritjes së qëndrueshme ekonomike** duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal; dhe **d) krijimin e një instrumenti të ri financimi: Faciliteti i Reformave dhe Rritjes ('Faciliteti') për Ballkanin Perëndimor** (miratuar më 14 maj 2024, nëpërmjet rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian dhe vendimit zbatues të Komisionit Evropian 23.10.2024).

Objektivat e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor synojnë integrimin e shpejtë të vendeve kandidate në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zbatimit të iniciativave dhe reformave (në kuadër edhe të zbatimit të planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal), të cilat do t'i japin gradualisht akses vendeve të Ballkanit Perëndimor të bëhen pjesë e Tregut të Vetëm të Bashkimit Evropian, edhe para anëtarësimit.

Instrumenti "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor" mbështet shtyllën e tretë dhe të katërt të Planit të Ri të Rritjes së Bashkimit Evropian. Ky Instrument do të ofrojë nxitje kyçe për zbatimin e Reformave të Rritjes, përmes mbështetjes financiare e cila do të mbulojë periudhën 2024–2027 dhe do të ofrojë asistencë financiare në formën e mbështetjes së pakthyeshme (deri në 2 miliardë euro) dhe kredive (deri në 4 miliardë euro) për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, përmes disbursimit direkt në buxhetet kombëtare, dhe ose si financim i investimeve kapitale përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

Dokumenti i politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027" për Shqipërinë është miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Dokumentit të Politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të Instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor", pas një konsultimi të gjerë me Komisionin Evropian, institucionet shqiptare, grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

Agjenda Kombëtare e Reformave (AKR) 2024–2027 është një agjendë e përmbledhur reformash e masash (31 reforma) për të krijuar mjedisin e nevojshëm për transformimin ekonomik dhe integrimin e vendit, ndërsa prioritetet e reformave të përcaktuara janë në përputhje me drejtimet prioritare që përcakton Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, në përputhje me Programin Ekonomik të Reformave (ERP) 2024–2026, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, si edhe me një serë dokumentesh kombëtare strategjike për vendin. Ky dokument i politikës mikse do të shërbejë edhe si instrument plotësues për detyrimet e lindura nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Shqipërisë dhe Komisionit Evropian dhe veçanërisht ato gjatë AKR 2024–2027, është dokumenti kryesor që shërben si bazë për planifikimin, hartimin dhe zbatimin e një sërë masave ligjore (që përafrojnë *acquis* të Bashkimit Evropian), administrative (që forcojnë kapacitete dhe aftësi) dhe investime, në kuadër të Planit të Ri të Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Qëllimi kryesor i AKR 2024–2027 është çlirimi i potencialit ekonomik të vendit, përmes stimulimit të transformimit ekonomik dhe përmirësimit të klimës së biznesit, për të hyrë gradualisht dhe i përgatitur në Tregun e Vetëm të BE-së, përmes forcimit të shtetit të së drejtës, me progres të vazhdueshëm në integrimin e përshpejtuar, konsolidimin dhe efikasitetin e reformave, dhe ecjes së qëndrueshme përpara në përmbushjen e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Synimi kryesor i AKR 2024–2027 është mbështetja e objektivit të dyfishimit të rritjes ekonomike në Shqipëri, nëpërmjet konsolidimit të ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe modernizimit të saj, përmes avancimit të teknologjisë dhe digjitalizimit, me burim të çmuar kapitalin human, dhe në bazat e qëndrueshme të reformave për shtetin e së drejtës.

Prioritetet kryesore të Reformave për Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027 (miratuar më 23 tetor edhe me vendim zbatues të Komisionit Evropian) **janë organizuar sipas politikave** prioritare.

I. Klima e biznesit (6 reforma)

Shtylla e parë e politikës fokusohet në konsolidimin e reformave që mundësojnë e mbështesin transformimin e mëtejshëm të Shqipërisë në një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e drejtuar nga qeverisja ekonomike transparente, infrastruktura ekonomike efikase dhe një kuadër ligjor i favorshëm për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e eksporteve, që përputhet me *acquis* dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Shtylla I përfshin disa iniciativa reformuese që nxisin një klimë biznesi edhe më konkurruese dhe tërheqëse, përmes një kornize kohezive dhe mbështetëse për zhvillimin ekonomik, si më poshtë vijon:

1. **Forcimi i administrimit tatimor dhe i kuadrit strategjik për sistemin dhe politikat tatimore**, përmes miratimit të strategjisë afatmesme për të ardhurat, zbatimin e masave konkrete të strategjisë për forcimin e administrimit tatimor.

2. **Përmirësimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës, për qytetarët dhe bizneset,** përmes kryerjes së regjistrimit fillestar në 95% të zonave dhe përfundimit të digjitalizimit 100% të kartelave të pasurive të paluajtshme, forcimit të kuadrit strategjik të politikës së tokës (Udhërrëfyesi dhe Politika e Tokës dhe Plani i Integritetit të Kadastrës).

3. **Përmirësimi i tërheqjes dhe transparencës së investimeve, përmirësimi i drejtimit të shoqërive shtetërore publike**, si dhe miratimi i kuadrit ligjor për PPP/koncesionet sipas standardeve të BE-së dhe aktet nënligjore, ngritjes dhe operacionalizimit të një autoriteti të pavarur, nga ana operacionale, të ndihmës shtetërore, përfshirjen në bordet e shoqërive shtetërore publike të anëtarëve të pavarur dhe procedurave transparente e proceseve të rekrutimit të bazuar në merita.

4. **Përmirësimi i tërheqjes dhe transparencës së investimeve të huaja direkte dhe në përgjithësi i klimës së biznesit, përmes derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve ndaj biznesit**, nëpërmjet masave që lidhen me miratimin e ligjeve të unifikuara për investimet, kuadrit ligjor për inspektimet, përmirësimit të raportimit për bizneset, miratimit të planit të veprimit për rritjen në renditjen e OECD *Policy SME Index*.

5. **Përmirësimi i eficiencës së transportit përmes Sistemeve Inteligjente të Transportit (SIT) dhe *E-transporti***, për lehtësimin e tregtisë me BE-në, duke përafruar legjislacionin kombëtar me direktivat e BE-së për informacionin elektronik të transportit të mallrave; ratifikimit të protokollit të Konventës së UN-së për transportin e mallrave; miratimit të legjislacionit përkatës për kornizat dhe standardet e Sistemeve Inteligjente të Transportit në transportin rrugor dhe hekurudhor.

6. **Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve,** përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës me BE-në; zbatimi i Udhërrëfyesit mbi Korsitë e Gjelbra/Programi i Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit, dhe Programi i Nxitjes së Eksporteve; Rritja e peshës së eksporteve ndaj PBB-së në vlerë neto 40%; Ligjet në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore.

II. Kapitali njerëzor (6 reforma)

Shtylla e dytë fokusohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke krijuar një sistem arsimor dinamik që pajis studentët dhe punonjësit me aftësitë përkatëse dhe kompetencën digjitale të nevojshme në ekonominë globale, duke nxitur inovacionin dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare, zhvillimin e produktivitetit dhe fuqisë punëtore të kualifikuar. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen reforma për rritjen e efektivitetit të sistemit arsimor profesional, përafrimin e tij me kërkesat në përgjigje të zhvillimeve dinamike të tregut të punës dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në tregun e punës, si dhe më gjerë, me zhvillimin e ekonomisë, që konsistojnë në:

1. **Rishikim i sistemit të Arsimit & Formimit Profesional (AFP) për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës**, përmes ngritjes së dy Komiteteve të reja të Aftësive Sektoriale (Bujqësia; Aftësitë e Gjelbra - Energjia), 5 Kurrikulave të rishikuara të AFP-së në fushat S3, 85% e mësuesve AFP të trajnuar për kurrikulat e rishikuara të AFP-së, 50% e të diplomuarve nga shkollat e AFP-së të punësuar në sektorin përkatës të studimeve (3 muaj/6 muaj) pas diplomimit.

2. **Përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar,** përmes ngritjes së një sistemi të ri të vlerësimit të performancës; përditësimit të kurrikulës bazë në arsimin bazë parauniversitar; zbatimi i kurrikulës së re, Programi "Art dhe Zeje" në 65% të shkollave të arsimit parauniversitar, 95% të mësuesve të trajnuar për kurrikulat e reja.

3. **Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve**, përmes njohjes së të mësuarit joformal dhe futja në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, akreditimi për 90% të ofruesve publikë & privatë të AFP-së, zbatimit (të pjesshëm) të *European Standard Guidelines*.

4. **Arsimi digjital dhe infrastruktura TIK në shkolla**, përmes lidhjes së internetit për 95% të shkollave publike të arsimit parauniversitar, *Smart Labs* në 75% të shkollave publike të arsimit parauniversitar, lënda TIK në të gjitha klasat e arsimit bazë, 500 mësuesve të trajnuar, sistemi SMIAL i arsimit të lartë; 6000 individë të certifikuar nga programet e aftësive digjitale.

5. **Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Papunësisë**, përmes Programeve të reja Aktive të Tregut të Punës, rritjes në 8% të punëkërkuesve të papunë në Programet Aktive të Tregut të Punës, rritjes së numrit të punëkërkuesve të regjistruar në zyrat e punësimit në 60% të totalit të të papunëve, rritjes 20% të punëkërkuesve të papunë në Formim Profesional; 5000 të papunë që punësohen përmes Programeve të Promovimit të Punësimit.

6. **Forcimi i mjedisit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit**, përmes Strategjisë së Specializimit Inteligjent, platformës për promovimin e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS), Plan Veprimit për "*European Inovation Scorebord*" (ESI), Ligjit për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë.

III. Aftësitë digjitale (4 reforma)

Shtylla e tretë parashikon nismat reformuese, në lidhje më transformimin digjital, për të krijuar një shoqëri digjitale udhëheqëse të zhvillimit dhe rritjes, ku infrastrukturat digjitale të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbimet publike dhe transformimin ekonomik, e sigurojnë qëndrueshmëri kibernetike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen iniciativa reformuese, që konsistojnë në:

1. **Përputhshmëria me Rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i *E-Portofolit* Digjital për shërbimet publike**, përmes miratimit të legjislacionit përkatës të përafruar me BE-në; zbatimit të Portofolit Digjital për shërbimet publike (pilotim në të paktën 10 shërbime); përfshirja në listën e vendeve të treta të besuara të Bashkimit Evropian për validimin e nënshkrimeve elektronike, marrëveshjes së njohjes reciproke për Portofolin Digjital (*Digital Wallet*) dhe përgatitjet për nënshkrim të marrëveshjes me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor.

2. **Forcimi i qëndrueshmërisë kibernetike**, përmes përditësimit të listës së infrastrukturës kritike, në përputhje me Direktivën NIS2 të Bashkimit Evropian, CERT-et kombëtare dhe qeveritare janë plotësisht funksionale dhe të 'akredituara' në TF CSIRT *Trusted Introducer*, përafrimit të Direktivës NIS2, Ushtrimi i kompetencave të plota të Autoritetit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (AKSK), në përputhje me Direktivën NIS2 të Bashkimit Evropian.

3. **Infrastrukturë digjitale e sigurt dhe e qëndrueshme**, përmes përmirësimit të bazës ligjore të *broadbandi*-t dhe harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe të zbatimit të masave rregullatore për futjen e infrastrukturave 5G.

4. **Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative,** përmes miratimit të strategjisë së sipërmarrjes inovative, miratimit të instrumenteve mbështetëse për inovacionin, përgatitjes dhe zbatimit të skemave të mbështetjes për inkubatorët/përshpejtuesit, *startups*, SME-të, duke synuar inovacionin e gjelbër dhe/ose digjital, rritjes dhe promovimit të inovacionit përmes një Plan Veprimi me masat përkatëse për inovacionin, sipas "*European Inovation Scoreboard*" (EIS).

IV. Energjia dhe tranzicioni i gjelbër (6 reforma)

Shtylla e katërt fokusohet në energjinë dhe tranzicionin e gjelbër, me synimin për të transformuar Shqipërinë në një lider rajonal të energjisë, nëpërmjet adoptimit të standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, duke nxitur një treg konkurrues të energjisë, duke adresuar risqet nga varfëria energjetike dhe aspektet mjedisore, si dhe duke rritur përpjekjet e mëtejshme në tranzicionin e gjelbër. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen iniciativa reformuese, që konsistojnë në:

1. **Harmonizimi me aktet ligjore të paketës së energjisë së BE-së,** me qëllim integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, dhe krijimin e tregut të energjisë elektrike "brenda ditës", si edhe operacionalizimit të paketës së integrimit të energjisë elektrike.

2. **Tërheqja graduale nga ndërhyrja publike në përcaktimin e çmimeve për furnizimin me energji elektrike**, shoqëruar me masa për adresimin e grupeve vulnerabël, përmes një metodologjie dhe masave përkatëse.

3. **Zhvillimi i një plani ankandi transparent dhe konkurrues për energjinë e rinovueshme**.

4. **Forcimi i kuadrit ligjor për energjitë e rinovueshme,** përmes miratimit të legjislacionit për energjitë e rinovueshme, miratimit të legjislacionit për ngritjen e komuniteteve të energjisë, operacionalizimi i sistemit për garancitë e origjinës për energjinë e rinovueshme, 600 mw kapacitete të reja shtesë të energjisë së rinovueshme të instaluara, rritjes së energjive të rinovueshme në totalin e miksit të energjisë së gjeneruar.

5. **Progresi në reformat për emetimet e karbonit të BE-së**, me qëllim vendosjen e sistemit të tregtimit të emetimeve të karbonit[7] (ETS), përmes miratimit të akteve ligjore e nënligjore për Monitorimin, Raportimin, Verifikimin dhe Akreditimin (MRVA), në përputhje me *acquis* të Bashkimit Evropian.

6. Ndryshimet ligjore dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë për rinovimin e ndërtesave, si edhe skemës së eficiencës së energjisë, miratimin e legjislacionit për etiketimin dhe eko-dizajn, si edhe ngritjes së kapaciteteve të nevojshme për mbikëqyrjen e tregut, ngritja e skemës së detyrueshme të eficiencës së energjisë, në përputhje me Direktivën e Energjisë së BE-së, zbatimi i objektivave vjetorë për rinovimin e ndërtesave, në përputhje me strategjinë përkatëse.

V. Themelorët/Shteti i së Drejtës (9 reforma)

Shtylla e pestë prioritizon garantimin e pakthyeshmërisë së reformës në drejtësi dhe të konsolidimit më tej të punës për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, nëpërmjet masave që luftojnë krimin e organizuar, parandalojnë dhe ulin incidencën e korrupsionit, rrisin efikasitetin e gjyqësorit dhe promovojnë transparencën dhe lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen iniciativa reformuese, që konsistojnë në:

1. **Luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar**, përmes ngritjes së Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, ripërdorimi për qëllime sociale i aseteve të konfiskuara, brenda gjashtë muajve nga konfiskimi.

2. **Forcimin e luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar**, përmes miratimit të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Krimit dhe Planit Respektiv të veprimit, zgjerimit të ndërveprimit midis bazave të të dhënave dhe mjeteve IT, progres i vazhduar me cilësinë e hetimeve, dënimet, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive për krime të lidhura me korrupsionin, në përputhje të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor, progres i vazhdueshëm me rezultatet e hetimeve, dënimeve, sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive të krimit të organizuar.

3. **Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik**, me qëllim uljen e kërkesës dhe ofertës së drogave të paligjshme, përmes ngritjes dhe operacionalizimit të Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Observatorit Kombëtar të Drogës, miratimit të Planit të Veprimit për parandalimin, trajtimin dhe uljen e dëmeve nga droga 2023–2026.

4. **Sigurimin e një kornize strategjike të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave**, përmes Planit të Veprimit dhe Vlerësimit Kombëtar të Riskut Kundër Pastrimit të

[7] ETS (*Emission Trade System*).

Parave 2024–2027, Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Kundër Financimit të Terrorizmit & Planit të Veprimit 2024–2030.

5. **Konsolidimin e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit**, përmes referimit të rasteve të *vetting*-ut të dyshuar për elemente kriminale në prokurori, ndryshimit të dispozitave që rregullojnë përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së për t'iu përshtatur standardeve të larta të integritetit, kontrollit të figurës dhe deklaratës së pasurisë, dhe për të siguruar zbatimin sa më të plotë të parimit të bazuar në merita për renditjen e pavarur, rritjes së transparencës për KLGJ-në dhe KLP-në për informacionet e lidhura me emërimet, promovimet, transferimet në gjyqësor, si edhe rekomandimeve nga inspektimet e ILD-së.

6. **Rritjen e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet**, përmes udhërrëfyesit të KLGJ-së për çështjet e pashqyrtuara, përmirësimit të statistikave penale, ngritjes së Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS), reduktimit të numrit të çështjeve të pashqyrtuara dhe kohës së disponimit në gjykata, sigurimit të një zgjidhjeje për ambientet e Gjykatës së Apelit, rritja e kapaciteteve të ILD-së, plotësimi i vendeve vakante në nivelet e gjyqësorit.

7. **Parandalimin efektiv të korrupsionit, zvogëlimi i incidencës së korrupsionit**, përmes platformës së hapur të të dhënave për buxhetin qendror dhe vendor, publikimit të të gjitha deklaratave të pasurisë në faqen e internetit të ILDKPKI-së, sipas parashikimeve ligjore, ndryshimeve në kuadrin ligjor për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), kuadri ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, kuadri ligjor për konfliktin e interesit, kuadri ligjor për financimin e partive politike.

8. **Forcimin e lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet evropiane**, përmes rritjes së kapaciteteve në organet ligjzbatuese për trajtimin e rasteve të dhunës që përfshijnë gazetarë, përafrim i legjislacionit me *Digital Service Act Regulation* të BE-së dhe Direktivën Anti-SLAPP të BE-së, harmonizimi i legjislacionit penal dhe civil mbi shpifjen, me standardet e BE-së.

9. **Përafrimin me politikën dhe kërkesat e vizave të Bashkimit Evropian,** nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve pa viza me vendet (të paktën 4) për të cilat kërkohen viza për në Bashkimin Evropian.

Në datën 23 shtator 2024, u miratua nga Komisioni Evropian "Vendimi zbatues i Komisionit Evropian për miratimin e Agjendave të Reformës dhe programit shumëvjeçar të punës në kuadër të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor" (për 5 vende nga Ballkani Perëndimor).

Vendimi zbatues i Komisionit udhëzon dhe përcakton edhe modalitetet për zbatimin e Facilititetit për Reforma dhe Rritje. Disbursimi i mbështetjes së Bashkimit Evropian do të kushtëzohet nga progresi i matshëm në zbatimin e reformave të parashikuar në Agjendë. Kushtet e pagesës do të përcaktohen në bazë të plotësimit të hapave cilësorë dhe sasiorë, sipas afateve kohore të përcaktuara për secilin vend dhe për secilën reformë, të cilat kanë si qëllim stimulimin e rritjes dhe vendosjen e përfituesve në një rrugë të qëndrueshme konvergjence, për t'i orientuar ata drejt reformave specifike që lidhen me bazat e zgjerimit, proces ky që përfshin ndër të tjera edhe sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Stabiliteti makrofinanciar, menaxhimi i shëndoshë i financave publike, transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit janë kushte të përgjithshme që duhet të përmbushen për pagesat dhe lirimin e fondeve.

Vlera e përgjithshme që pritet të përfitojë, në parim, vendi ynë, për periudhën 2024–2027, në total kap vlerën e 922,085,888 euro (grant dhe kredi), pagesa të kushtëzuara me zbatimin e reformave kyçe siç janë përcaktuar në Agjendën Kombëtare të Reformave të secilit vend.

Në tabelën më poshtë paraqiten alokimet e mbështetjes për secilin sektor:

Fusha e politikës/reformave	**Vlera e mbështetjes (grant+kredi)**
Klima e biznesit	209,086,359.60 EURO
Kapitali njerëzor	189,531,520.21 EURO
Aftësitë digjitale	127,858,565.22 EURO

Energjia dhe tranzicioni i gjelbër	127,858,565.22 EURO
Themelorët/Shteti i së Drejtës	267,750,877.76 EURO
Totali	**922,085,888.00 EURO**

Në përputhje me nenin 19 të Rregullores (BE) 2024/1449, për të maksimizuar ndikimin e mbështetjes financiare të Bashkimit për të tërhequr investime shtesë dhe për të siguruar kontrollin e Bashkimit Evropian mbi shpenzimet, investimet në infrastrukturë që mbështesin Agjendat e Reformave, duhet të zbatohen përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor ('ËBIF') dhe Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor të krijuar në kuadër të ËBIF për marrjen e kontributeve të donatorëve ('EËBJF') në përputhje me rregullat e fondit ('Kushtet e përgjithshme të fondit të përbashkët').

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në përshpejtimin e procesit të përafrimit me *EU acquis*

Shqipëria, pas zhvillimit të Konferencës së 1-rë Ndërqeveritare, në korrik 2022, duhet të përshpejtojë procesin e përafrimit të kuadrit të saj ligjor me ligjet dhe standardet e BE-së – të përcaktuara në *acquis* të BE-së, në kuadër të përgatitjes për t'u bërë anëtare e BE-së.

Detyrimi i Republikës së Shqipërisë për të harmonizuar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së buron nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE–Shqipëri, e nënshkruar më 12 qershor 2006.

Cikli i përafrimit të *acquis* në legjislacionin kombëtar i referohet procesit të vazhdueshëm të përafrimit të ligjeve dhe rregulloreve të një vendi kandidat me *acquis* të BE-së, korpusi i ligjeve dhe standardeve të BE-së. Ai përfshin një seri hapash që ndiqen njëra pas tjetrës derisa të arrihet pajtueshmëria e plotë e kuadrit ligjor vendas me atë të BE-së.

Aktualisht niveli i përafrimit me *acquis* të BE-së nuk është shumë i lartë, marrë në konsideratë objektivat e vendit, me rreth 60 akte në vit.

Për sa më sipër:

- Ekziston nevoja që Shqipëria të përshpejtojë procesin e përafrimit, veçanërisht për t'u bashkuar me Tregun Unik dhe për të mundësuar përfitime nga BE-ja për qytetarët/bizneset përpara se të bëhemi vend anëtar i BE-së.

- Shqipëria nevojitet të adoptojë mjete teknologjike për të reduktuar barrën administrative të transpozimit të legjislacionit të BE-së në kontekstin shqiptar.

- Inteligjenca artificiale mund të luajë një rol të vlefshëm në mbështetjen e përafrimit me *acquis* të BE-së nëpërmjet automatizimit të disa nga proceseve të punës së përafrimit, si: përkthimi, vlerësimi i ndikimit të *acquis* të BE-së, identifikimi i boshllëqeve, etj.

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në procesin e përafrimit është pilotuar nga institucionet shqiptare gjatë periudhës gusht–dhjetor 2023 dhe ka rezultuar që ky instrument mund të përdoret gjerësisht nga administrata publike për përshpejtimin e procesit të përafrimit.

3. Reforma në drejtësi

Gjatë viteve të fundit sistemi i drejtësisë ka qenë në qendër të reformave më të thella e njëkohësisht më të rëndësishme në funksion të përmbushjes së standardeve evropiane. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë, që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj.

Në kuadër të kësaj reforme, një hap vendimtar shënoi ngritja e organeve të qeverisjes së gjyqësorit, si: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si dhe u krijua një kuadër institucional i plotë për hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar që përfshin Prokurorinë e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, është miratuar me vendimin nr. 787, datë 18.12.2024, të Këshillit të Ministrave. Kjo strategji synon forcimin e shtetit të së drejtës, avancimin e

reformave të nisura dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke mbështetur Shqipërinë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Me gjithë arritjet tepër të rëndësishme, jetësimi me sukses i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje të shtuar, gjithashtu, edhe mbi përgjegjësitë që burojnë për institucionet e përfshira, të cilat kërkojnë përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sipas standardeve Evropiane, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së sektorit dhe krijimin e një baze të dhënash elektronike për gjyqësorin të cilat ndikojnë në rritjen e efikasitetit, llogaridhënies, forcimit të besimit të publikut dhe transparencës në këtë sektor, duke ndihmuar edhe eliminimin e *backlog*-ut. Zbatimi i fazës së mëtejshme deri në 2030 do të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve në sektorin e drejtësisë në nivelet e standardeve evropiane dhe do të synojë të eliminojë *backlog*-un dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Jetësimi i prioriteteve të qeverisë shqiptare, lidhur me Reformën në Drejtësi, vjen si rrjedhojë e rekomandimeve të lëna gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Miratimi i Kodit të ri Penal, përmirësimet ligjore që lidhen me Reformën në Drejtësi, dhe përmirësimi gradual i infrastrukturës gjyqësore, priten të rrisë ndjeshëm cilësinë e shërbimeve të drejtësisë, në përputhje me standardet më të larta të BE-së.

Reforma në Drejtësi, ka kaluar në disa faza:

Faza I: SND 2016–2020, ku u hodhën bazat ligjore dhe institucionale të reformës në drejtësi, përfshirë ndryshimet kushtetuese, ndryshime të tjera legjislative në të gjithë sektorin, duke e sjellë kornizën ligjore në standardet evropiane dhe krijimin e institucioneve të reja në përputhje me modelet evropiane, përfshirë këtu dhe një proces rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Faza II: Kjo fazë mbulon vitet 2021–2025, konsolidon ndryshimet institucionale, përfshin praktikat moderne evropiane në drejtësinë penale, përmirëson infrastrukturën e sistemit të drejtësisë dhe ofron zgjidhje për IT-në, duke përfshirë këtu zgjidhjet inovative elektronike që mbështesin një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë.

Faza III: Kjo fazë konsiderohet si faza e fundit e reformave madhore: 4–5 vite pas fazës II, eliminon *backlog*-un dhe rrit cilësinë e shërbimeve/ofrimit të drejtësisë në të njëjtat nivele, si edhe në vendet e BE-së.

Reforma në Drejtësi ka shënuar progres me disa nga arritjet kryesore, që janë:

- Miratimi i hartës së re gjyqësore me vendimin nr. 495, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave;
- Miratimi i ndryshimeve kushtetuese për zgjatjen e afatit për funksionimin e organeve të *vetting*-ut;
- Miratimi i Udhërrëfyesit për zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve nga Qendra e Teknologjisë së Informacionit;
- Plotësimi i vendeve vakante dhe funksionimi i plotë nga Gjykata Kushtetuese;
- Miratimi i Masterplanit të ri të Burgjeve që nxit ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të stafit dhe përmirëson performancën profesionale;
- Rritja e efikasitetit të hetimeve të kryera nga Prokuroria bazuar në numrin e lartë të raportit të personave të dënuar dhe atyre të hetuar;
- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përforcuar kuadrin rregullator;
- Procesi i rivlerësimit i drejtuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ishte i mirëorganizuar dhe përfundoi brenda afatit kushtetues (31 dhjetor 2024);
- Shkolla e Magjistraturës siguron trajnime cilësore të përshtatura sipas nevojave të pjesëmarrësve, duke u bazuar në metodologjinë e re.

"**SND 2024–2030**" synon të forcojë dhe të konsolidojë më tej Reformën në drejtësi, duke u mbështetur në objektiva si:

- Konsolidimi i kuadrit ligjor në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane;
- Finalizimi i procesit të *vetting*-ut në përputhje me praktikat më të mira të vendosura nga organet e *vetting*-ut;
- Ulja dhe eliminimi i *backlog*-ut në gjykata;

- Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës për të rritur besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe për të promovuar kulturën e llogaridhënies;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe integritetit të magjistratëve për një drejtësi më cilësore;
- Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara në përputhje me standardet më të mira evropiane;
- Fuqizimi i edukimit ligjor të publikut dhe rritja e aksesit në sistemin e drejtësisë, me anë të informimit, sensibilizimit, ndërgjegjësimit mbi ligjin dhe sistemin e drejtësisë;
- Ulja e mbipopullimit në burgje;
- Miratimi i Kodit Penal në përputhje me *acquis* dhe rekomandimet e *screening report*, lidhur me fushën penale dhe kriminalitetin;
- Zbatimi efektiv i hartës së re gjyqësore;
- Ngritja dhe funksionimi i plotë i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS);
- Emërimi dhe plotësimi i vakancave të magjistratëve në gjykata dhe në prokurori përmes transferimeve dhe ngritjes në detyrë, me transparencë të plotë;
- Plotësimi i vakancave të inspektorëve të ILD-së, veçanërisht lidhur me inspektorët e profilit magjistrat;
- Zbatimi nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, lidhur me standardet e përdorura nga organet e *vetting*-ut, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe figurës së magjistratëve.

Reforma në Drejtësi lidhet me Agjendën 2030, në kuadër të realizimit të Objektivit 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet", synimit 16.3 "Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë", synimit 16.6 "Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet", synimit 16.7 "Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet", dhe 16.10 "Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.".

Lufta kundër korrupsionit është një prioritet kyç i qeverisë shqiptare, mes të tjerash edhe në drejtim të fazës së ardhshme të konsolidimit të reformës në drejtësi. Në Strategjinë e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, politika e ndështkimit është kryesisht e orientuar drejt ruajtjes dhe konsolidimit të masave për kapacitete të përmirësuara të hetimit administrativ dhe atij penal të rasteve të korrupsionit.

Edhe pse verifikimi (*vettingu*) i anëtarëve të gjyqësorit është një proces administrativ, progresi në këtë fushë është i rëndësishëm për të vlerësuar Shqipërinë në luftën kundër korrupsionit. Përparim i mirë ka vazhduar përmes konsolidimit të mëtejshëm të përpjekjeve për krijimin e një baze të dhënash të forta për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve të nivelit të lartë të korrupsionit. Për më tepër, qeveria shqiptare angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti për zbatimin e mëtejshëm të politikave kundër diskriminimit, për të përmirësuar situatën, në lidhje me të drejtat sociale me fokus të veçantë në grupet e rrezikuara dhe të miturit. Reformat janë në fushën e të drejtave të pronësisë, si dhe në planin e veprimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të GjEDNj-së për kthimin dhe kompensimin e pronës.

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha Konventat mbi *të drejtat e njeriut* në kuadrin e OKB-së, si dhe një sërë Konventash të Këshillit të Evropës. Traktatet dhe konventat ndërkombëtare, dhe rekomandimet e organeve monitoruese luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucionet kombëtare zbatojnë Kushtetutën dhe kuadrin ligjor për të garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave themelore, si të drejtat politike, ekonomike, dhe sociale.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare", janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore të paketës së zbatimit të ligjit.

Metodologjia e re e anëtarësimit kërkon vazhdimësinë e reformave dhe politikave të koordinuara dhe të njëkohshme në të gjithë sektorët, për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe detyrimeve të MSA-së. Sfidat kryesore lidhen me domosdoshmërinë e: i. vazhdimit të mëtejshëm

dhe thellimit në zbatimin e reformave themelore, duke përfshirë reformën në drejtësi, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformës së administratës publike; ii. përmbushjes së të gjitha detyrimeve të MSA-së dhe harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, sikurse kërkohet nga MSA-ja dhe anëtarësimi në BE; iii. angazhimit të përgjithshëm për finalizimin e procesit *screening*, plotësimin e kritereve për hapjen e negociatave në grupimin themelorët dhe më pas në grupimet e tjera; iv. koordinimin dhe integrimin vertikal dhe horizontal të politikave, dhe reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit.

4. Siguria në Komunitet

Një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, krijimi i kushteve për një jetesë më të sigurt për qytetarët, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për fuqizimin e sigurisë publike, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me qytetarët në këtë drejtim.

Niveli i rendit publik dhe sigurisë në vendin tonë paraqitet në parametra normalë, si rezultat i rritjes së aftësive profesionale të Policisë së Shtetit dhe forcimit të kontrollit të territorit me IKMT-në dhe strukturat përgjegjëse, por edhe i vëmendjes, gjithnjë e më të shtuar, të autoriteteve lokale kundrejt çështjeve të sigurisë publike dhe trajtimit të duhur të problemeve nga ana e tyre, rritjes së ndërgjegjësimit, por edhe të përfshirjes së komunitetit dhe kontributit të këtij të fundit, investimeve të bëra në të gjithë infrastrukturën fizike dhe institucionale që kanë mundësuar parametra më cilësorë të shërbimeve publike dhe të sjelljes qytetare. Shqipëria është sot një vend më i sigurt për të gjithë qytetarët që jetojnë në territorin e saj, për jetën, bizneset dhe pronat e tyre, për investimet e huaja dhe turistët që e vizitojnë atë.

Progresi i arritur në forcimin e rendit dhe të sigurisë publike, gjatë vitit 2024, lidhet me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, si miratimi i:

Ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit";

Ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 12 "Detyra në lidhje me organet e Policisë së Shtetit", neni 12/1, pika 3;

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024, "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet";

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 20.11.2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1139, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit 2021–2023'", i cili ka miratuar Planin e Veprimit 2024–2026, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026.

Drejtimet kryesore të politikave:

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit, dhe masat parandaluese:
- Parandalimi dhe forcimi i masave të sigurisë në shkolla nëpërmjet zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla;
- Përmirësimi i sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes;
- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të Komisariatit Digjital;
- Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit i orientuar nga inteligjenca dhe informacioni;
- Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit;
- Siguria e sezonit turistik gjithëvjetor;
- Siguria e komunitetit me fokus të shtrirë në identifikim dhe parandalim;
- Siguria në kuadër të kontrollit të territorit për veprimtari të paligjshme;
- Siguria në kuadër të parandalimit të ngacmimeve dhe dhunës seksuale fizike, psikologjike apo në hapësirat kibernetike;
- Siguria e komunitetit, në kuadër të menaxhimit të qarkullimit rrugor dhe ndërgjegjësimit;

- Siguria e komunitetit, në kuadër të përballimit të emergjencave;
- Institucionalizimi dhe funksionimi i KVSP-ve;
- Analizimi i kuadrit ligjor, organizativ, të sigurisë publike në nivel qendror dhe vendor, si dhe përgjegjësitë përkatëse të institucioneve në fushën e sigurisë;
- Orientimi i veprimtarisë së prefektit të qarkut për mbështetjen dhe implementimin e nismës së qeverisë "*Smart City*".

Ndër prioritetet e përcaktuara për vitin e ardhshëm janë ngritja dhe funksionimi i plotë i këshillave vendorë të sigurisë publike në të gjitha bashkitë në vend dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet, krijimi i një mekanizmi efektiv për monitorimin e zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore dhe reduktimin e numrit të aksidenteve me pasoja fatale, nëpërmjet digjitalizimit të monitorimit të akseve rrugore (radarët, makinat inteligjente dhe dronët), nëpërmjet zbatimit të projektit "Sistemi i kamerave në administrim të Policisë së Shtetit *Smart City*" zbatimi dhe implementimi i fazës së tretë të programit suedez me afat 2-vjeçar "Fuqizimi i policimit në komunitet".

5. Inteligjenca artificiale si sektor zhvillimi horizontal i së ardhmes

Ndërsa fusha e teknologjive të AI-së nëpër botë zgjerohet, presioni i pajtueshmërisë së saj me zakonet individuale, mënyrat e të bërit biznes, profesionet dhe strukturat institucionale shkakton një transformim rrënjësor në strukturën socio-ekonomike të një vendi.

Megjithëse është e qartë se ky transformim ka filluar dhe do të vazhdojë të përshpejtohet, mjetet dhe shpejtësia e ndërveprimit të këtij transformimi me strukturat ekzistuese sociale, institucionale dhe ekonomike janë ende të paqarta.

AI ose inteligjenca artificiale, është një fushë e zgjeruar dhe në zhvillim që përfshin zhvillimin e programeve kompjuterike inteligjente të cilat kryejnë detyra që zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, si perceptimi vizual, njohja e të folurit, vendimmarrja dhe përpunimi i gjuhës. Zhvillimi i AI-së ka qenë domethënës, pasi i ka lejuar këto sisteme të mësojnë, përshtaten dhe gjenerojnë njohuri nga sasi të mëdha të dhënash.

Zhvillimi dhe përhapja e shpejtë e llogaritjeve të performancës së lartë, internetit të sendeve dhe teknologjive *blockchain* (mekanizëm i avancuar rrjeti informacioni), në vitet e fundit kanë hapur rrugën për shfaqjen e teknikave dhe aplikimeve të reja të AI. Në mënyrë të ngjashme, falë teknikave të të dhënave me kompleksitet të lartë (*big data*) të përdorura në përpunimin e të dhënave digjitale, grupe të mëdha të dhënash vihen në dispozicion të aplikacioneve të AI.

Koncepti i AI-së mund të ndahet në tre kategori: AI "e ngushtë", "e përgjithshme" dhe "e lartë".

1. AI e ngushtë: Kjo lloj AI është krijuar për të kryer një detyrë të specifike (p.sh. njohjen e fytyrës, kërkimet në internet ose drejtimin e një makine). AI funksionon nën një gamë të kufizuar të paracaktuar ose grup kontekstesh. Shumica e sistemeve të AI-së në përdorim sot janë shembuj të AI-së të ngushtë.
2. AI e përgjithshme: Kjo i referohet një forme teorike të AI-së që mund të arrijë performancë të nivelit njerëzor ose më të lartë në shumicën e njohësve detyrat.
3. AI e lartë: Një formë teorike e AI-së që ka inteligjencë më të madhe se njerëzit dhe tejkalon performancën e tyre njohëse në shumicën e fushave.

Ndërsa sistemet e AI-së mund të jenë të suksesshme në kryerjen e detyrave rutinë, procedurale dhe të modeleve të inteligjencës analitike, përdorimi i tyre është shumë i kufizuar në detyrat që përfshijnë inteligjencën emocionale dhe pasigurinë e lartë që kërkojnë dizajn, ndjeshmëri dhe përshtatshmëri. Në këtë kontekst, diskutimet dhe debatet konceptuale dhe teknike mbi kufijtë, dhe të ardhmen e AI-së vazhdojnë.

Qeveria shqiptare ka nisur një rrugëtim ambicioz për të integruar inteligjencën artificiale (AI) në sektorë të ndryshëm publikë, për të transformuar shërbimet publike, për të përmirësuar punën e institucioneve dhe për të rritur angazhimin e qytetarëve. Duke përdorur potencialin e AI-së dhe *big data*, Shqipëria synon të nxisë një qeveri më efikase, transparente dhe më të përgjegjshme.

Synimi afatgjatë është të integrojmë AI-në në të gjithë sektorët, duke synuar një ndikim transformues në kujdesin shëndetësor, arsim, bujqësi, taksa dhe tatime etj. Iniciativa të tilla si diagnostikimi i hershëm

i sëmundjeve asistuar nga AI, rrugëtimet e personalizuara të arsimimit dhe bujqësia precize pritet të përmirësojnë ndjeshëm rezultatet e politikave dhe efikasitetin e shërbimeve. Për më tepër, këto iniciativa parashikohen të reduktojnë ndjeshëm punën manuale, të minimizojnë gabimet njerëzore dhe të thjeshtojnë proceset në të gjithë administratën. Adoptimi i teknologjive të AI-së do ta pozicionojë Shqipërinë në krye të inovacionit digjital në qeverisje, duke kontribuar në modernizimin e administratës publike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët.

E-Albania 2.0 do të vijë bashkë me Platformën e Ndërveprimit me teknologjinë më të fundit dhe e riorganizuar sipas modelit "*life events*", do t'i bëjë shërbimet edhe më të thjeshta për të gjithë, por dhe për ata me aftësi ndryshe dhe të moshuarit që do të kenë shërbyesin virtual të dedikuar, asistentin virtual të *e-albania*-s. Aktualisht, në portalin *e-Albania* është implementuar Asistenti Virtual 1.0, i cili përdor inteligjencën artificiale për të gjeneruar automatikisht pyetjet që qytetarët mund të kenë rreth shërbimeve të ofruara në portal. Paralelisht me përmirësimin e portalit *e-Albania*, është në zhvillim edhe Asistenti Virtual 2.0, i cili do të jetë një version më i avancuar. Ky version i ri do të përfshijë jo vetëm përmirësime funksionale, por edhe vizualizimin e asistentit, duke e bërë ndërveprimin më intuitiv dhe miqësor për përdoruesit.

Në *e-Albania* do të integrohet inteligjenca e biznesit (*business intelligence*), për të vizualizuar dhe analizuar siç duhet të dhënat e shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në mënyrë që t'u mundësohet institucioneve të marrin vendime më të mira, më të shpejta dhe më efikase gjatë ofrimit të shërbimeve publike, por edhe parashikime më të sakta në këtë aspekt.

Gjithashtu, janë në zhvillim e sipër një sërë projektesh që përfshijnë inteligjencën artificiale:

AI në transpozimin e acquis të BE-së në legjislacionin shqiptar: Përshtatja e legjislacionit shqiptar me *acqui*s të BE-së, është një detyrë e komplikuar që kërkon vite nëse realizohet manualisht nga ekspertë ligjorë dhe specialistë të integrimit. Për të adresuar këtë sfidë, do të përdorim Inteligjencën Artificiale për ta automatizuar këtë proces, duke përfshirë përkthimin e akteve ligjore me asistencë të AI-së, analizimin dhe krahasimin e tyre me legjislacionin shqiptar për të identifikuar mbivendosje apo kontradikta, dhe automatizimin e hartimit të tabelave të përputhshmërisë. Ky modul synon të përshpejtojë punën e ekspertëve të përputhshmërisë ligjore, duke ruajtur njëkohësisht saktësinë, por pa zëvendësuar faktorin njerëzor, i cili mbetet element thelbësor dhe i pazëvendësueshëm në procesin e integrimit evropian. Përdorimi i AI-së nuk zvogëlon rolin e ekspertëve, përkundrazi, e fuqizon atë duke i mundësuar të fokusohen te detyrat më strategjike dhe vendimmarrëse, që janë kritike për procesin e integrimit evropian.

AI në transformimin rrënjësor të sistemit të prokurimeve: Do të automatizohen plotësisht procedurat e prokurimit përmes një sistemi elektronik me inteligjencë artificiale, duke eliminuar nevojën për letra dhe komunikim me zyra, duke kaluar në qasjen zero letra dhe zero komunikim me zyrat. Bizneset do të kenë dosjet e tyre virtuale që do të ndërveprojë me sistemet e tjera shtetërore, duke e bërë procesin më të thjeshtë dhe të barabartë për të gjithë, përfshirë edhe bizneset evropiane. Për më tepër, sistemi *e-Certis*, i cili është sistemi evropian i prokurimeve, do të mundësojë verifikimin e deklarimeve, ndërsa sistemi *Single Window* i Doganave do të lehtësojë më tej këtë ndërveprim. Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe *machine learning* do të reduktojë gabimet njerëzore dhe do të automatizojë proceset si hartimi i termave të referencës, përcaktimi i fondeve limit dhe vlerësimi i procedurave të prokurimit. Kjo do të sjellë kursime financiare dhe do të krijojë një garë të drejtë, të barabartë dhe transparente në tendera.

6. Inovacioni, vështrim i shkurtër në raport me konceptin e industrive inovative, kreative dhe kulturore

Potenciali transformues i inovacionit është i pamohueshëm. Fuqia e ideve të reja dhe teknologjive të reja po drejton ndryshimet globale në një shkallë të paprecedent. Vendet që do të munden të shfrytëzojnë këtë potencial do të lulëzojnë në shekullin e 21-të, duke e tërhequr maksimalisht talentin dhe investimet, duke u bërë eksportues të gjeneratës së ardhshme të produkteve dhe shërbimeve, dhe duke rritur ndjeshëm cilësinë e jetës së qytetarëve të tyre.

Sektorët inovativë kërkojnë mbështetje të madhe për t'u zhvilluar. Në mënyrë që ato të mund të ndërkombëtarizohen dhe eksportohen më pas gjatë një faze të avancuar, duhen ndërtuar partneritete ndërkombëtare, duke nxjerrë mësime krahasuese nga rajoni e më gjerë dhe duke u mbështetur në praktikat e mira kudo që ato gjenden.

Kjo do të rezultonte në rritjen e produktivitetit, në tërheqjen e më shumë investimeve dhe do të rriste më tej cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve publike. Duke bashkëpunuar dhe duke u përqendruar në prioritetet strategjike, mund të sigurohet që përfitimet dhe mundësitë e një ekosistemi të zhvilluar inovacioni të shpërndahen në të gjithë vendin, për të gjithë qytetarët, bizneset dhe komunitetet tona.

Strategjitë e politikave për zhvillimin e industrive kulturore, krijuese dhe inovative zakonisht lidhen me zgjerimin e tregjeve për mallrat dhe shërbimet kulturore. Ato kërkojnë t'i zhvillojnë këto industri, duke promovuar inovacionin dhe kreativitetin, duke çuar në zhvillimin e formave origjinale të pronësisë intelektuale dhe duke mbështetur industritë e bazuara në kulturë dhe argëtim. Në disa raste, të tilla si strategjitë e rigjenerimit urban të udhëhequr nga kultura, industritë kulturore dhe krijuese pozicionohen si një alternativë ndaj industrive tradicionale të prodhimit.

Si një fushë akademike, interesi për industritë kulturore dhe krijuese ka përfshirë gjerësisht fushat e komunikimit, mediave dhe studimeve kulturore, gjeografisë ekonomike dhe kulturore, arteve krijuese dhe interpretuese, dhe ekonomisë kulturore të aplikuar.

7. Specializimi inteligjent dhe avantazhi krahasues

- Nga koncepti tek kuadri i politikës, konteksti ndërkombëtar

Ideja e specializimit të zgjuar u zhvillua mbi idetë e ekonomistëve klasikë (avantazhi krahasues dhe tregtia e lirë), të cilët theksuan nevojën e fokusimit në ato aktivitete ose fusha në të cilat kombet ose rajonet ishin më të afta sesa në ato aktivitete ku ato ishin më të dobëta.

Në nëntor 2009, Komisioni Evropian publikoi raportin "Dija për Rritjen", që publikonte rezultatet e një grupi këshillimor ekspertësh në BE. Të ngarkuar me gjetjen e një alternative për politikat publike që deri atëherë ishin parë (dëshmuar) se i shpërndanin dobët investimet publike në njohuri dhe inovacion, kërkime, edukim, mbështetje publike për kërkimin dhe zhvillimin e biznesit, etj. – tek fusha të tilla, si: bioteknologjia, ICT-ja dhe nanoteknologjia, grupi i ekspertëve propozoi që qeveritë kombëtare dhe veçanërisht ato rajonale duhet të inkurajojnë investimet në fusha që do të "plotësonin asetet e tjera produktive të vendit për të krijuar aftësitë e ardhshme të brendshme dhe avantazhin krahasues ndërrajonal".

Ky propozim strategjik u emërtua "specializimi i zgjuar" dhe ai u përhap shpejt dhe u miratua në Agjendën e BE-së 2020, me objektivat e saj të rritjes së zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse (*smart*, *sustainable and inclusive*).

Në të vërtetë, strategjitë e kërkimit dhe inovacionit për specializimin *smart* propozohen si një kusht *ex-ante* për programet e ardhshme të Fondeve Strukturore të BE-së, me synimin për të përqendruar burimet në kërkimin dhe inovacionin për të maksimizuar impaktin e fondeve strukturore. Megjithatë, çështjet e ngritura nga specializimi i zgjuar shkojnë përtej diskutimit në kontekstin e BE-së. Një numër vendesh, brenda OECD-së ose jo, tani po interesohen për specializimin *smart* si një mënyrë për të nxjerrë ekonomitë e tyre nga kriza, duke përdorur dinamizmin rajonal për zhvillimin intensiv ekonomik të udhëhequr nga dija dhe inovacioni.

Ajo që e dallon specializimin e zgjuar nga politikat tradicionale industriale dhe të inovacionit është kryesisht procesi i përcaktuar si "zbulimi i sipërmarrjes" – një proces ndërveprues në të cilin forcat e tregut dhe sektori privat zbulojnë dhe prodhojnë informacion për aktivitete të reja dhe qeveria vlerëson rezultatet, dhe fuqizon ata aktorë që janë më të aftë për të realizuar potencialin e tyre.

Prandaj, strategjitë e specializimit inteligjent janë shumë më tepër nga "poshtë–lart" sesa politikat industriale tradicionale.

Ashtu si politikat tradicionale industriale, strategjitë e zgjuara të specializimit synojnë të adresojnë tregun/sistemet dhe dështimet e koordinimit. Por politikat tradicionale industriale kërkonin nivele të konsiderueshme informacioni për të justifikuar mbështetjen e subvencioneve dhe ato priren të

zbatohen në sektorë të integruar vertikalisht me paradigma teknologjike të qëndrueshme. Në të kundërt, specializimi i zgjuar njeh mungesën e informacionit të përsosur, të nivelit të avancimit të një aktiviteti të caktuar dhe risqet relative për politikat. Kështu, ai përqendrohet në ndihmën ndaj sipërmarrësve në mënyrë që këta të fundit të identifikojnë pikat e tyre të forta, të bazuara në njohuri në nivel rajonal dhe të zhvillojnë një qasje më eksploruese në të cilën vendimmarrësit publikë dëgjojnë sinjalet e tregut, duke përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi (p.sh. analiza *SWOT*, sondazhe) dhe mekanizma të tillë si partneriteti publik-privat, prognoza dhe hartëzimi teknologjik etj.

8. Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent "S3" 2025–2030

Strategjia Kombëtare për Specializimin Inteligjent (S3) 2025–2030 u miratua nga qeveria në shjetor 2024. Ajo synon të transformojë Shqipërinë në një qendër të inovacionit, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur lidershipin e saj rajonal. Kjo strategji është hartuar për të identifikuar dhe zhvilluar fusha me potencial të lartë për rritje dhe inovacion, duke përfshirë sektorët strategjikë si energjia e rinovueshme, turizmi i qëndrueshëm dhe zinxhiri i ushqimit të shëndetshëm.

Qasja S3 përfaqëson një koncept të politikës së inovacionit të bazuar në vend dhe identifikon fushat kyçe të inovacionit, të njohura si fusha prioritare, për ndërhyrje publike dhe private, duke rritur vlerën përmes aktiviteteve të bazuara në njohuri. Strategjia promovon lidhjet ndërsektoriale dhe diversifikimin përtej industrive tradicionale. Procesi i Zbulimit të Sipërmarrjes (EDP), një kornizë pjesëmarrëse dialogu, gjithëpërfshirëse, midis palëve të interesuara të territorit, përfshin të gjitha palët e interesuara nga qeveria, sektori privat, akademia dhe shoqëria civile – duke formuar të ashtuquajturin "Hiliksin e katërfishtë" – për të identifikuar në bashkëpunim këto fusha prioritare.

Shqipëria filloi udhëtimin e saj drejt S3-shit në vitin 2016, e mbështetur nga TAIEX dhe e njohur nga Qendra e Përbashkët e Kërkimeve të BE-së (JRC). Ky proces përfaqëson një nismë të rëndësishme për të përballuar sfidat shoqërore dhe për të shfrytëzuar inovacionin në një kontekst të ndryshimeve globale.

Duke përdorur kuadrin e ofruar nga JRC-ja, Shqipëria zhvilloi një udhërrëfyes kombëtar S3 me një perspektivë rajonale, duke bashkuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE) dhe strategjitë sektoriale. Ky udhërrëfyes, i pozicionuar si një ombrellë strategjike, ka për qëllim të nxisë inovacionin dhe sipërmarrjen, duke mbështetur njëkohësisht dhe objektivat e Shqipërisë për integrim në BE. Në qendër të strategjisë janë fushat prioritare:

1. Energjia e Rinovueshme dhe Burimet Natyrore: Synon të pozicionojë Shqipërinë si një lider në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, duke përafruar qëndrueshmërinë mjedisore me rritjen ekonomike, veçanërisht në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

2. Turizëm i qëndrueshëm dhe i larmishëm: kërkon të riemërojë Shqipërinë si një destinacion të qëndrueshëm turistik, duke shfrytëzuar peizazhet e saj kulturore dhe natyrore, duke nxitur ekonomitë lokale, duke ruajtur trashëgiminë e vendit.

3. Zinxhiri ushqimor i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm: Fokusohet në bujqësinë organike dhe prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit për të garantuar sigurinë dhe sigurinë ushqimore, duke rritur rolin e Shqipërisë si një model për bujqësinë e qëndrueshme.

Për të mbështetur këto fusha prioritare të S3-shit, janë parashikuar disa masa thelbësore që përfshijnë:

- Zhvillimin e kapitalit njerëzor, veprimet kryesore përfshijnë investimin në arsim dhe trajnim, veçanërisht në fushat STEM;
- Promovimin e kërkimit dhe inovacionit nëpërmjet krijimit të qendrave të inovacionit dhe transferimit të teknologjisë;
- Përmirësimin e mjedisit të biznesit, duke krijuar kushte më të favorshme për sipërmarrësit dhe bizneset. Strategjia, gjithashtu, ka prioritet digjitalizimin dhe ndërlidhjen, duke theksuar nevojën për infrastrukturë digjitale dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në të gjithë sektorët.

Strategjia e Specializimit të Zgjuar të Shqipërisë, në përputhje me politikat evropiane dhe burimet e financimit, shpreh përkushtimin e vendit për të ndërtuar mbi parimet evropiane të zhvillimit ndërsa angazhohet në këtë rrugë. Ky përfaqëson një vizion, jo thjesht një strategji, për integrimin e ekosistemit

të veçantë në kuadrin më të gjerë të Zonës Evropiane të Arsimit, Zonës Evropiane të Kërkimit, Zonës Evropiane të Inovacionit dhe Tregut të Përbashkët Evropian. Strategjia e Specializimit *Smart* (S3) për Shqipërinë është krijuar për t'u harmonizuar me disa politika kyçe të BE-së, duke siguruar një qasje të koordinuar ndaj zhvillimit rajonal, inovacionit dhe rritjes ekonomike. S3-shi kontribuon dhe përputhet me disa nga këto politika, si: Agjenda e Re Evropiane e Inovacionit; Politikat Industriale Evropiane; Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, etj.

S3-shi, gjithashtu, lehtëson tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie digjitale, duke përgatitur vendin për të kontribuar në vizionin e BE-së për një Evropë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050.

Perspektiva e Besueshme e Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor thekson iniciativat për të nxitur sipërmarrjen dhe për të nxitur një ekonomi rrethore, duke përforcuar angazhimin e Shqipërisë me BE-në. Kjo është pjesë e Planit Ekonomik dhe Investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili synon të mbështesë reformat e nevojshme për integrimin në BE dhe krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës.

Për të mbështetur Shqipërinë në arritjen e objektivave S3, disa instrumente të BE-së janë vendimtare, si shembull:

1. Horizon Europe 2021–2027: Ky program ambicioz kërkimor inkurajon inovacionin dhe promovon përparimet teknologjike në përputhje me qëllimet S3;

2. Programi *LIFE*: Ndihmon zhvendosjen e Shqipërisë drejt një ekonomie të qëndrueshme, rrethore dhe neutrale ndaj klimës;

3. Programi i Evropës Digjitale (DEP): Ky program lehtëson integrimin e teknologjive digjitale në të gjithë sektorët, duke rritur qëllimet e transformimit digjital nën S3;

4. Evropa krijuese: Promovimi i diversitetit kulturor, mbështet sektorët kulturorë të Shqipërisë, duke rritur fuqinë e butë dhe aspektet e inovacionit të S3;

5. IPARD: Ky program ndihmon në zhvillimin rural dhe bujqësinë, duke u përafruar me objektivat e S3;

6. Erasmus+: Ai ofron mundësi thelbësore arsimore dhe trajnimi për të ndërtuar kapital njerëzor për objektivat e S3-shit.

Nëpërmjet këtyre instrumenteve dhe rreshtimeve strategjike, S3-shi jo vetëm që vepron si një politikë e pavarur, por shërben si një komponent kritik i agjendës më të gjerë të Shqipërisë drejt konvergjencës së BE-së dhe rritjes së qëndrueshme socio-ekonomike. Duke shfrytëzuar këto burime, Shqipëria është e pozicionuar të ndikojë pozitivisht në trajektoren e saj të zhvillimit, duke përmbushur aspiratat e saj për integrim, duke nxitur inovacionin dhe qëndrueshmërinë. Në kontekstin rajonal është i dukshëm fakti që të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor po avancojnë drejt strategjive të e tyre të Specializimit të Zgjuar (S3), duke identifikuar fushat për specializim inteligjent. Këto përpjekje kërkojnë bashkëpunim ndërmjet qeverive, studiuesve, bizneseve dhe aktorëve shoqërorë për të nxitur inovacionin dhe rritjen rajonale. S3-shi ndihmon në përcaktimin e sektorëve prioritarë rajonalë, në përputhje me pikat e forta kombëtare, duke mundësuar specializimin ku secili vend ka përparësi në burimet njerëzore dhe kapitale. Ndërkohë iniciativa të tjera kanë ndikuar në intensifikimin e bashkëpunimit, si shembull miratimi i Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA) në Samitin e Triestes 2017, që synon nxitjen e investimeve rajonale, tregtisë dhe përafrimin me BE-në. Miratimi në vitin 2020 të Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021–2024, etj. Integrimi i S3-shit brenda këtyre kornizave siguron statusin e tij si një prioritet rajonal dhe kombëtar.

Fushat kryesore të bashkëpunimit të identifikuara, përfshijnë:

1. **Platformat dhe rrjetet e përbashkëta:** zhvillimi i platformave për kërkime, veçanërisht në TIK dhe përpunimin e ushqimit, për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe projektet bashkëpunuese;

2. **Marrëveshjet dypalëshe dhe rajonale:** vendosja e marrëveshjeve formale për bashkëpunim në arsim, kërkim dhe teknologji për të maksimizuar përdorimin e burimeve;

3. **Financimi i BE-së dhe rajonal:** përdorimi i fondeve dhe programeve të BE-së si Agjenda e Ballkanit Perëndimor për të mbështetur iniciativat dhe infrastrukturën e përbashkët.

4. **Specializimi i zgjuar:** përdorimi i specializimit të zgjuar për të identifikuar prioritetet me interes të përbashkët, duke nxitur shtigjet e bashkëpunimit;

5. **Projektet e zhvillimit të qëndrueshëm:** fokusimi në praktikat e qëndrueshme në bujqësi, energji dhe lëndë të para për përfitime afatgjata.

Kjo qasje rajonale thekson përpjekjet kolektive të Shqipërisë dhe fqinjëve të saj për të inovuar dhe zhvilluar çdo ekonomi, duke shfrytëzuar forcat unike për avantazh konkurrues.

KREU II

2.1 PËRPARËSITË AFATSHKURTRA DHE AFATMESME TË QEVERISË

1. Menaxhimi i financave publike

Në buxhetin e vitit 2025 janë parashikuar të shpenzohen rreth 822.7 miliardë lekë ose rreth 31.4% e PBB-së, duke rezultuar rreth 51.4 miliardë lekë më shumë se plani i rishikuar i vitit 2024. Do të vijohet me financimin e një vëllimi të konsiderueshëm investimesh publike prej mesatarisht 6.1% të PBB-së përgjatë 2025–2027, të cilat përqendrohen në financimin e projekteve me rëndësi strategjike dhe të lidhura me Planin e Rritjes së BE-së. Shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë mbështeten në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë digjitalizimit, transportit, sigurisë kombëtare, shëndetësisë, arsimit dhe bujqësisë e zhvillimit rural.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2025 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën 71.3 miliardë lekë. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore, si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, mirëmbajta e sistemeve të teknologjisë së informacionit, programet e nxitjes së punësimit, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për arsimin dhe sportin.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025*,* janë parashikuar në masën 89.9 miliardë lekë, me një rritje prej 13.2% më shumë se buxheti i vitit 2024. Këto shpenzime për vitin 2025, zënë 3.43% të PBB-së nga 2.9% që zinin në vitin 2024 ose nga 2.3% në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 është 1.8 miliardë lekë më shumë ose rreth 7.6% më e lartë, dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale), është 13.9 miliardë lekë më shumë ose mbi dy herë më e lartë. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2025, 26.2 miliardë lekë, do të shtohen edhe fondet prej 13.2 miliardë lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, 200 milionë lekë grant performance i cili përdoret për herë të parë si mekanizëm financiar në qeverisjen vendore, si dhe 3.5 miliardë lekë transfertë sektoriale për rritjen e pagave. Në total, në vitin 2025, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 43.1 miliardë lekë nga 36.5 miliardë në 2024-ën me një rritje prej 6.6 miliardë lekë ose me një rritje prej 18%.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 1.85 miliardë lekë ose rreth 0.1% e PBB-së. Subvencionet shtetërore për vitin 2025 janë përqendruar në financimin e skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, si dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare.

Investimet publike për vitin 2025 janë planifikuar në masën 6.2% të PBB-së ose 161.8 miliardë lekë (*duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 5 miliardë lekë dhe 4.5 miliardë lekë financime të pritshme mbi bazë projektesh nga Plani i Rritjes me BE*-në*)*. Në planifikimin e investimeve për vitin 2025 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm, dhe do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Në raport me buxhetin e rishikuar të vitit 2024, vëllimi i investimeve publike në vitin 2025 parashikohet me rreth 11 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 263.8 miliardë

lekë. Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2025, parashikohet në masën 192.3 miliardë lekë ose 7.3% e PBB-së. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej 1.6 miliardë lekë dhe 3.75 miliardë lekë për bonusin e fundvitit për pensionistët. Ndërsa, shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2025 janë parashikuar në masën 63.1 miliardë lekë ose 2.4% e PBB-së.

Shpenzime të tjera sociale përfshijnë fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin 800 milionë lekë;
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 23.7 miliardë lekë ose 0.9% e PBB-së. Krahasuar me vitin 2024, totali i këtij zëri rezulton me ulje pasi reflekton në tërësi një rialokim prej rreth 2.8 miliardë lekë tek shpenzimet për Fondin e Sigurimeve Shoqërore, në mënyrë që të gjithë përfituesit që gëzojnë statusin e invalidit të punës të mund të marrin pensionet e tyre, si dhe përfitimet e tjera që burojnë nga ky status nëpërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pra një institucioni të vetëm.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1.4 miliardë lekë ose 0.05% e PBB-së;
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2.25 miliardë lekë ose 0.1% e PBB-së.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2025, planifikohet në masën 5.9 miliardë lekë, i përbërë nga:

- 3 miliardë lekë Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave;
- 2.5 miliardë lekë Fond Rezervë për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- 1.2 miliardë lekë fond rezervë për financimin e masave që do të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Agjendës së Planit të Rritjes me BE-në.

Financimi për disa sektorë të rëndësishëm:

Në Arsim, shpenzimet buxhetore parashikohen të jenë në vlerë nominale në masën 61.2 miliardë lekë ose rreth 2.4% në raport me Produktin e Brendshëm (PBB).

Për periudhën 2025–2027, disa nga prioritetet e financimit do të mbështesin:

- Rritjen e numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor;
- Reduktimin e numrit të klasave kolektive, në arsimin parauniversitar;
- Ofrimin e teksteve shkollore falas për rreth 240 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe tekste shkollore falas për rreth 16 mijë nxënës nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm të lartë;
- Investimet në arsim për ndërtimin, rindërtimin e infrastrukturës arsimore, ngritjen dhe fuqizimin e laboratorëve IT, laboratorëve didaktikë mësimorë, mjediseve sportive sipas standardeve evropiane;
- Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së, nëpërmjet: zbatimit të kurikulës së re në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar, si dhe përgatitjes së teksteve specifike për nxënësit e pakicave kombëtare;
- Garantimin e fondeve grant për mësimdhënie, si dhe për mbështetjen studentore/bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, studentëve që ndjekin degët në programet prioritare të përcaktuara me VKM, si dhe studentëve ekselentë në IAL-të publike. Mbështetja e IAL-ve publike duke siguruar fondet për kompensimin e efekteve financiare të tarifave të shkollimit për studentët e ciklit të parë që përjashtohen/reduktohen nga tarifa vjetore e shkollimit, si dhe për studentët e ciklit të dytë të studimeve që përjashtohen/reduktohen nga tarifa vjetore e studimit.
- Ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë – do të vijojë puna për hapjen e filialeve të universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe të programeve të studimit të përbashkëta/të dyfishta. MAS -ido të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare. (Plani i qeverisë 2021–2025).

Objektivat për arsimin

"Pakti për Universitetet", do të vijojë zbatimin përmes financimit me përparësi për ngritjen e infrastrukturës dhe investimeve në kampuset/godinat universitare.

Sektori i Shëndetësisë financohet me rreth 81.8 miliardë lekë në vitin 2025 ose rreth 3.2 % e PBB-së. Do të vijojë financimi i projekteve të rëndësishme, si:

- Rehabilitimi i 100 objekteve të tjera të qendrave shëndetësore dhe ambulancave, me një fond prej 296.6 milionë lekë për vitet 2025–2027;

- Në vitin 2025 parashikohet të nisë rikonstruksioni i godinës qendrore të Spitalit Pogradec, vlera e plotë është parashikuar 243 milionë lekë;

- Në vitin 2025 parashikohet të nis rikonstruksion i godinës qendrore të Spitalit Lushnjë, me vlerë të plotë 405 milionë lekë;

- Në vitin 2025 parashikohet të nisë rikostruksioni i Pediatrisë Infektive në QSUT (përforcim) me një vlerë 130 milionë lekë;

- Parashikohet financimi i projektit rikonstruksion i godinës shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë për vitet 2025–2027.

Në fushën e turizmit prioritetet, për periudhën 2025–2027, do të jenë:

- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor, duke promovuar gjerësisht Shqipërinë në komunitetin ndërkombëtar si një destinacion i denjë për të konkurruar globalisht;

- Sigurimi e zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, me qëllim rritjen e turistëve të huaj;

- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i imazhit të vendit duke promovuar produkte lokale.

Në fushën e ekonomisë, kulturës dhe inovacionit, buxheti i parashikuar për MEKI-n për vitin 2025 do të jetë rreth 49.3 miliardë lekë ose rreth 1.93 % e PBB-së. Prioritetet për periudhën 2025–2027 do të jenë:

- Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë;

- Nxitja e eksporteve dhe rritjes së konkurrueshmërisë së SME-ve nëpërmjet promovimit të eksporteve, ofrimit të shërbimeve mbështetëse, si dhe programeve të mbështetjes financiare me anë të granteve;

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme;

- Reformimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe përmirësimi i eficiencës së ISSH-së në menaxhimin e sistemit të të dhënave, si edhe në ofrimin e më shumë shërbimeve *online* në kuadër të rritjes së transparencës;

- Garancia Rinore është një angazhim nga të gjitha vendet e BE-së për të siguruar të rinjtë nga 16–29 vjeç të marrin një ofertë cilësore brenda një periudhe 4-mujore të regjistrimit si punëkërkues të papunë ose të braktisjes së arsimit formal, duke mbështetur mesatarisht 735 të rinj çdo vit, përgjatë 2025–2027;

- Ofrimi i formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, rritja e mundësisë për të nxënit gjatë të gjithë jetës, si për burrat dhe për gratë, dhe përshtatja me mundësitë e punësimit të ofruara nga tregu i punës;

- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza;

- Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve;

- Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare;

- Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjikë, si dhe përmirësimin i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin.

- Ulja e përqindjes së familjeve të cilat jetojnë në kushte të papërshtatshme strehimi nëpërmjet politikave akomoduese në fushën e strehimit social, duke garantuar kritere të drejta dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha kategoritë përfituese nga kjo politikë.

Programi "Strehimi", për periudhën 2024–2027, synon të arrijë treguesit e mëposhtëm të performancës:

- Të ulë përqindjen e familjeve të cilat jetojnë në kushte të papërshtatshme strehimi nga 53% në vitin 2024, në 31 % në vitin 2025, në 21 % në vitin 2026 dhe 15 % në vitin 2027;

-Të rrisë numrin e familjeve që i përmirësohen kushtet e banimit nga 17,088 në vitin 2024, në 24,852 familje në vitin 2025, 29,153 familje të planifikuara në vitin 2026 dhe 31,000 familje në vitin 2027;

- Të rrisë numrin e banesave që i shtohen fondit publik të banesave sociale me qira në 1,406 banesa për vitin 2025, 1,600 në vitin 2026 dhe 1,800 banesa për vitin 2027;

- 5% e përfituesve pritet të jenë të kategorisë Rom dhe Egjiptian për projektet e përmirësimit të banesave ekzistuese dhe rikonstruksionit të godinave;

- Nga 266 të punësuar në administratën publike që përfitojnë kredi të subvencionuar nga shteti në vitin 2024, në 1,000 që priten të përfitojnë në vitet 2025–2027.

Sektori i bujqësisë financohet në masën 14.2 miliardë lekë, duke synuar:

- Përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe industrisë agroushqimore, si dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale;

- Rritjen e numrit të përfituesve nga skema e subvencionit të naftës për bujqësinë nga 53,170 përfitues në vitin 2023 në 52,200 përfitues në vitin 2024;

- Shtimin e numrit të përfituesve nga masat mbështetëse në bujqësi nga 12,545 përfitues në vitin 2023 në 14,828 përfitues në vitin 2024, me një fond total për këtë të fundit prej 5.2 miliardë lekë;

- Rritjen e kapaciteteve të prodhimit në ferma nëpërmjet mbështetjes së investimeve për ndërtimin e serrave dhe stallave, për rrjeta anti-breshër, mekanikë bujqësore dhe akuakulturë, me një fond të ri prej 1.5 ml. lekë për 2024–2025 në Skemën e Investimeve. U regjistruan 404 aplikime.

Në **fushën e mbrojtjes sociale**, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesjes sociale në tri shtyllat kryesore të saj: Ndihma Ekonomike, Aftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale. Disa nga synimet kryesore janë:

- Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike parashikohet të jetë mesatarisht 62 000 përfitues në vit, ku për vitet 2026–2027 parashikohet të ulet me 1000 familje, ku synohet punësimi i anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese.

- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të shkojë në 162 mijë përfitues në vitin 2027 nga 164 mijë përfitues në vitin 2025, në zbatim të skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, pra sipas modelit bio-psiko-social, bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit, synohet krijimi i një sistemi shërbimesh integruese, të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesjes sociale;

- Mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale synohet të punësohen mesatarisht 148 persona çdo vit nga 60 persona që parashikohen për vitin 2024, me qëllim integrimin në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike;

- Rritja e numrit të personave të punësuar në ndërmarrjet sociale në raport me numrin e anëtarëve në moshë pune në skemën e ndihmës ekonomike në 2% në vitin 2027;

- Mbështetjen e fondit social për njësitë e vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE-së me paketa sociale shëndetësore, duke synuar ofrimin e 80–90 shërbime në bashkitë e vendit, me një fond mesatarisht prej 350 milionë lekë për periudhën 2025–2027. Parashikohet të përfitojnë 61 njësi të vetëqeverisjes vendore në vitin 2027 nga 30 NJVQVV që parashikohen të përfitojnë në vitin 2024.

- Financimi i politikës për mbrojtjen e veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje, duke synuar të

përfitojnë 8 500 gra në vitin 2027 nga 8 000 gra që janë parashikuar në vitin 2024, me një fond mesatarisht prej 850 milionë lekë për periudhën 2025–2027.

- Rritja e numrit të grave dhe vajzave në nevojë, të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesjes sociale, në 55 gra dhe vajza në vitin 2027, nga 45 gra/vajza që parashikohen në vitin 2025;
- Mbështetja e grave të dhunuara që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike kundrejt totalit të kategorive të veçanta në 51% në vitin 2027 nga 45% që parashikohen në vitin 2024.

Në fushën e **Infrastrukturës dhe Energjisë** është planifikuar një buxhet prej 68.4 miliardë lekë ose rreth 2.7% e PPB-së. Prioritetet për periudhën afatmesme do të jenë:

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes:

i. një portofoli të investimeve publike; dhe ii. përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës-kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;

- Rritja e eficiencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara, si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme.

Për **fushën e drejtësisë** parashikohen të alokohen në buxhetin e vitit 2025 fonde në masën 15.8 miliardë lekë, duke pasur si përparësi kryesore jetësimin e reformës në drejtësi.

Në fushën e rendit dhe sigurisë publike është planifikuar për vitin 2025 një buxhet prej 28.4 miliardë lekë.

Për sektorin e mbrojtjes, buxheti i parashikuar për vitin 2025 do të jetë rreth 52.7 miliardë lekë ose rreth 2.01 % e PBB-së. Me këtë buxhet Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA-së, duke:
- zhvilluar kapacitetet e FA-së në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- zhvilluar industrinë dhe asetet ushtarake;
- vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
- zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
- modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin dhe shtimin e kontributit në operacionet e NATO-s, OKB-së, BE-së, duke rritur nivelin e angazhimit të FA-së në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë, si dhe BE-ja në kuadër të CSDP-së.
- Zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve të FA-së për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-së dhe BE-së.
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2025, planifikohet në masën **5.9 miliardë lekë**, i përbërë nga:

- 3 miliardë lekë Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave;
- 2.5 miliardë lekë Fond Rezervë për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- 1.2 miliardë lekë fond rezervë për financimin e masave që do të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Agjendës së Planit të Rritjes me BE (AKR 2024–2027).

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin **68.5 miliardë lekë** ose **2.6% të PBB-së**, duke përfshirë në të dhe një rezervë prej 5.8 miliardë lekë për të mitiguar risqet e mundshme nga luhatjet e normave të interesit, kursit të këmbimit etj.

Rregulli Fiskal, balanca primare si ankorë kryesore e politikës fiskale

Balanca primare është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike. Në korrik 2020, u ndërmor një iniciativë e rëndësishme ligjore, duke futur një rregull të ri fiskal në kuadër të Ligjit Organik të Buxhetit (OBL) në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian

dhe parimet themelore të *acquis* të BE-së. Ky rregull vendos një detyrim ligjor që, duke filluar nga viti buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektoreje vijimësisht rënëse të borxhit publik. Qëllimi kryesor është të lehtësojë konsolidimin e vazhdueshëm fiskal, duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike si një gur themeli për stabilitetin makroekonomik dhe mirëfunksionimin e përgjithshëm të ekonomisë së vendit.

Balanca primare parashikohet në një mesatare prej rreth 0.5 për qind në vit gjatë periudhës së ardhshme afatmesme (2025–2027). Në vijim, projektojmë një balancë primare neutral për vitin 2025 dhe synojmë një suficit prej 0.7 për qind në vitin 2026 dhe duke arritur në 0.9 për qind në 2027.

Ulja e Borxhit Publik: Sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave, borxhi publik parashikohet të ulet nga rreth 55.2% e PBB-së në vitin 2024, në 54.8% në vitin 2025, në 53.2% në vitin 2027 dhe më tej në rreth 48 për qind deri në vitin 2031. Kjo qasje synon të rrisë qëndrueshmërinë fiskale, të forcojë besueshmërinë e politikave buxhetore dhe të krijojë hapësirë për manovra financiare për përballimin e sfidave ekonomike në të ardhmen.

2. Reforma në Administratën Publike

Reforma në Administratën Publike është një kriter i posaçëm përbërës i Grupkapitujve Themelorë, duke qenë kështu një agjendë ndërhyrjesh horizontale në të gjithë sektorët, për të garantuar suksesin e procesit të negociatave për të gjithë kapitujt negociues. Si shembulli më i qartë i prioritizimit të sektorit publik në agjendën e qeverisë shqiptare, krijimi i pozicionit qeveritar të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsioninm në janar 2024m synon avancimin e kësaj reforme, me vizion madhor përgatitjen e institucioneve publike për përballimin me sukses të procesit negociues me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin e Shqipërisë në BE brenda dekadës.

Në maj të vitit 2024, në kuadër të rienergjizimit të administratës publike, ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin prezantoi për të gjitha institucionet publike një "Paketë Motivimi" për nëpunësit publikë. Paketa synon të ofrojë një numër incentivash financiare dhe jofinanciare për të rritur angazhimin dhe kënaqësinë në punë, në kuadër të procesit të energjizimit të administratës shtetërore, duke kontribuar kështu në zhvillimin e një kulture të mirë organizative brenda institucioneve publike. Paketa është zhvilluar: i. bazuar në praktikat më të mira evropiane për ekselencën në administratën publike; dhe ii. posaçërisht e përshtatur për mjedisin të administratës publike shqiptare. Kjo paketë është strukturuar rreth katër shtyllave kryesore:

1. Përshtatja me sfidat bashkëkohore dhe mirëqenia;
2. Qasja në shërbime dhe aktivitete;
3. Fryma e ekipit dhe konkurrenca e shëndetshme në vendin e punës;
4. Motivimi financiar.

Aktualisht janë finalizuar suksesshëm ndërhyrjet e mëposhtme të parashikuara në Paketën e Motivimit:

a) Fleksibiliteti i orarit të punës: Përmes miratimit të VKM-së nr. 530, datë 1.8.2024, krijohet mundësia që punonjësit e administratës publike të zgjedhin të fillojnë ditën e punës më herët dhe ta përfundojnë më herët ose të fillojnë më vonë dhe ta përfundojnë më vonë. Më konkretisht, punonjësit kanë mundësinë të zgjedhin oraret e tyre të punës brenda një intervali të përcaktuar ditor, me kusht që të plotësojnë numrin e kërkuar të orëve të punës (8.5 orë nga e hëna deri të enjten dhe 6 orë të premten). Për të mundësuar ecurinë e proceseve që kërkojnë rakordim mes kolegëve, është parashikuar një fashë e detyrueshme orari nga ora 09:30 deri në 15:30 (dhe deri në orën 13:00 të premten), gjatë së cilës të gjithë punonjësit duhet të jenë të pranishëm në punë.

Qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve është ofrimi i një fleksibiliteti më të madh në orarin e punës, duke përmirësuar kështu balancën mes punës dhe jetës private – një aspekt i rëndësishëm sidomos për prindërit që punojnë, pasi u mundëson atyre të përshtatin orët e punës me oraret e shërbimeve sociale

të ofruara për fëmijët (kopsht/shkollë) – duke ruajtur njëkohësisht produktivitetin brenda institucioneve publike;

b) Dispozitat për pushimet vjetore: ndryshimet e miratuara së fundmi në Kodin e Punës me ligjin nr. 91/2024, kanë hequr kufizimin që pengonte punonjësit e administratës publike të marrin lejen vjetore në periudha më të shkurtra se një javë kalendarike. Gjithashtu, tashmë është përcaktuar qartë se kohëzgjatja e lejes vjetore është 22 ditë pune, pra 2 ditë më shumë lejeje për të gjithë punonjësit në raport me parashikimin e mëparshëm ligjor;

c) Aplikimi i modelit të punës hibride: në dhjetor 2024 është finalizuar Udhëzuesi për Punën Hibride në Administratën Publike, në zbatim dhe detajim të parashikimeve në fuqi për punën në distancë në Kodin e Punës dhe në VKM-në nr. 568, datë 6.10.2021, "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar. Ky udhëzues është krijuar për të ndihmuar institucionet shtetërore të përqafojnë këtë model të ri pune, duke ofruar një udhërrëfyes të qartë dhe të detajuar. Përmes tij, synohet jo vetëm rritja e produktivitetit, por edhe mirëqenia e nëpunësve publikë, duke krijuar një mjedis pune që u përshtatet nevojave të tyre personale dhe profesionale.

Reforma e Pagave

Në vitin 2024, qeveria shqiptare finalizoi me sukses fazën e dytë të reformës së pagave për nëpunësit civilë, në vijim të fazës së parë të zbatuar në vitin 2023, me qëllim për të përmirësuar kënaqësinë dhe motivimin e tyre, si dhe për të bërë shërbimin publik më tërheqës si punëdhënës në tregun e punës. Përveç rritjes së pagave, reforma ka sjellë edhe një rregullim në strukturën e pagës. Krahasuar me vitin 2013, pagat e nëpunësve civilë janë rritur mesatarisht nga 35% deri në 65%, varësisht nga kategoria. Gjithashtu, është rritur indeksi i shkallës së komprimimit të pagave dhe pesha e elementit të vjetërsisë në pagën totale.

Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve, qeveria shqiptare ka arritur jo vetëm objektivin për një pagë mesatare prej 900 euro në administratën publike, sipas angazhimit të marrë përsipër në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike, por ka siguruar një pagë mesatare prej 1.050 euro, nga 530 euro në fillim të vitit 2023. Kjo rritje është vlerësuar si domethënëse edhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit të vitit 2024, si dhe ka rritur kënaqësinë e nëpunësve me pagën e tyre (nga 13% e nëpunësve të kënaqur në vitin 2022 në 47% deri në prill 2024). **Reforma e plotë e pagave**, e shtrirë përgjatë dy viteve 2023–2024 arrin një kosto prej rreth 39 miliardë lekë dhe prej saj kanë përfituar rreth 130 mijë punonjës.

Në gusht 2024, qeveria shqiptare miratoi një reformë të plotë të pagave edhe për punonjësit e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke ndryshuar metodën e llogaritjes së vjetërsisë për ta përshtatur me atë të nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe duke barazuar pagën e nëpunësve lokalë me atë të klasës përkatëse në administratën shtetërore. Ndryshimet ligjore mundësuan rritjen e pagave nga 40% deri në dyfishimin e pagës për disa pozicione specifike, si dhe standardizimin e pagave në të 61 bashkitë e vendit.

Në vijim, qeveria shqiptare do të finalizojë Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2024–2030, e cila do të garantojë harmonizimin e ndërhyrjeve me angazhimet e parashikuara në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, përkatësisht në drejtim të zhvillimit dhe koordinimit të politikave, menaxhimit të shërbimit civil dhe burimeve njerëzore, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes, ofrimit të shërbimeve me fokus qytetarin, si dhe ndërtimin e një administrate publike të gjelbër.

Gjithashtu, do të vijojë zbatimi në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive i dispozitave për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe largimin nga shërbimi civil, mbi bazën e meritave në ligjin për shërbimin civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë. Për këtë qëllim, do të finalizohen ndryshimet ligjore në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, përmes së cilave do të synohet rritja e efektshmërisë së procedurës së rekrutimit dhe përsosja e testimit të mbështetur në kompetenca.

Në po të njëjtën linjë, do të finalizohen ndryshimet ligjore edhe në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", duke adresuar nevojën për përcaktimin e kritereve të sakta për secilën tipologji të institucioneve të varësisë.

Këto nisma ligjore do të shoqërohen edhe nga miratimi i projektvendimeve të kostuara, si më poshtë:

- Projektvendim "Për miratimin e procedurës për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë", kostoja për të cilin llogaritet ALL 1,349,436.00;
- Projektvendim "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", kostoja për të cilin llogaritet ALL 1,349,436.00;
- Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, 'Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura', kostoja për të cilin llogaritet ALL 1,255,611.00;
- Projektvendimi "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", kostoja për të cilën llogaritet ALL 1,255,611.00.

Gjithashtu, do të vijojë zbatimi i Paketës së Motivimit për nëpunësit publikë, si dhe puna për jetëzimin e vizionit për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), si një qendër e ardhshme ekselence në zhvillimin profesional të sektorit publik, përmes miratimit të ndryshimeve në VKM-në nr. 138, datë 12.3.2014, "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë". Këto ndryshime do të targetojnë reformimin e sistemit të trajnimit të ofruar nga ASPA, duke mundësuar kritere të rishikuara për përzgjedhjen e trajnerëve dhe përcaktimin e masës së pagesës së tyre, me qëllim tërheqjen e ekspertëve më të mirë, ku prioritet do të ketë trupa ekzistuese e ekspertizës sektoriale brenda administratës publike. Këto ndërhyrje do të synojnë në mënyrë madhore rritjen e përgjithshme të kapaciteteve administrative të institucioneve publike në drejtim të thellimit të përgatitjeve për zbatimin e suksesshëm të Agjendës Kombëtare për Integrimin Evropian të vendit.

Zbatimi i Reformës në Administratën Publike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me disa prej OZHQ-ve të Agjendës 2030, duke kontribuar drejtpërdrejt përmes përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të administratës publike për qytetarët dhe bizneseve në nivel lokal dhe kombëtar. Saktësisht, ajo mundëson zbatimin e Objektivit 8: "Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë", Treguesit 8.5 "Deri në vitin 2030, arritja e punësimit produktiv dhe punës së denjë për të gjitha gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë/të rejat dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë", si dhe veçanërisht Objektivit 16 "Paqe, drejtësi dhe institucione të forta (veçanërisht Treguesit 16.6 "Ndërtimi i institucioneve efikase, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet e qeverisjes).

3. Lufta kundër korrupsionit

Lufta ndaj korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Qëllimet e politikës kundër korrupsionit kanë synuar rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese ndaj korrupsionit, me synim final rritjen e besimit të qytetarëve dhe bizneseve në institucionet publike në vend.

Autoritetet shqiptare vijojnë punën në drejtim të parandalimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit, si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj., mes të tjerash.

Ndër vitet e fundit Shqipëria ka përparuar ndjeshëm drejt forcimit të strukturës së saj institucionale dhe ligjore në luftën kundër korrupsionit. Krijimi dhe konsolidimi gradual i një kuadri të plotë

institucional kundër korrupsionit është lehtësuar në masë të madhe nga zbatimi i reformës në drejtësi, e cila ka përmirësuar, gjithashtu, efikasitetin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale në çështjet që përfshijnë korrupsionin dhe ka përmirësuar ndjeshëm hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit.

Ky përparim njihet nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024, sipas së cilit Shqipëria ka bërë progres në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe në vijimin e masave të ndërmarra kryesisht në drejtim të hetimit dhe ndëshkimit të funksionarëve të lartë. Në raport vijon të vlerësohet puna e SPAK-ut në hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të funksionarëve të lartë, duke u konsideruar tashmë si një institucion në kapacitet të plotë operacional.

Drejtimet kryesore të politikës kombëtare antikorrupsion shtrihen në 3 qasje të mirëkonsoliduara, përkatësisht parandalimin e korrupsionit përmes promovimit të integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes, ndëshkimin e praktikave korruptive në institucionet publike, si dhe edukimin dhe ndërgjegjësimin ndaj korrupsionit. Këto qëllime madhore zbatohen në partneritet dhe në mbikëqyrje të vazhdueshme nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sektori privat dhe grupet e interesit.

Me VKM-në nr. 29, datë 17.1.2024, kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, funksion i ushtruar më parë nga ministri i Drejtësisë, u kaluan pranë ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Ky pozicion ndërthur agjendën e ndërhyrjeve të dedikuara në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e integritetit, transparencës dhe qeverisjes së hapur, me drejtimin politik të Reformës në Administratën Publike dhe zbatimin e parimeve të mirëqeverisjes.

Që nga krijimi i saj në vitin 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK) ushtron kompetenca të dyfishta, përkatësisht në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave antikorrupsion, si dhe në hetimin administrativ të praktikave korruptive. Me miratimin e VKM-së nr. 436, datë 26.6.2024, DPAK-ja, deri atëherë strukturë e brendshme e Ministrisë së Drejtësisë, u riorganizua si një institucion i mëvetësishëm juridik në varësi të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit. Koordinatorët kundër Korrupsionit janë tashmë të pranishëm në 26 institucione publike dhe ndërmarrje me kapital shtetëror që ofrojnë shërbime direkte për publikun dhe që operojnë në sektorët me riskun më të lartë për korrupsion.

Revolucioni digjital i dekadës së fundit në modernizimin e shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale, me synim final ofrimin e shërbimeve cilësore me fokus qytetarët, ka qenë një instrument kyç për minimizimin dhe parandalimin e korrupsionit "të vogël" në sportele.

Në vitin 2022, GRECO ka vlerësuar rritjen e burimeve financiare të akorduara nga buxheti i shtetit për ILDKPKI 37% nga viti 2019 deri në vitin 2021,146, si dhe faktin që buxheti i dedikuar për burimet njerëzore ka ndjekur një trajektore në rritje, duke kaluar nga 985,000 EUR në vitin 2019, në 1,002,166 EUR në vitin 2020 dhe duke arritur 1,052,666 EUR në vitin 2021. ILDKPKI-ja vlerësohet, gjithashtu, si një institucion i mirëorganizuar, me kapacitet të plotë kontrolli dhe verifikimi të pasurive të zyrtarëve publike, i cili kryhet *online* prej fillimvitit 2022.

Përgjatë vitit 2024, ka vijuar puna për zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s, në kuadër të Raundit V të Vlerësimit, i filluar në vitin 2022. Në shtator 2024, Shqipëria ka dorëzuar pranë Sekretariatit të GRECO-s Raportin Kombëtar të radhës, ku nga 19 rekomandimet e mbetura për adresim (nga të cilat 7 lidhen me qeverinë qendrore – funksionet e larta ekzekutive – dhe 12 lidhen me agjencitë e zbatimit të ligjit), 14 janë raportuar nga qeveria shqiptare si të adresuara plotësisht dhe 5 të tjera si në proces.

Seanca e vlerësimit dhe finalizimi i Raportit të Përputhshmërisë për fazën e dytë pritet të kryhet në vitin 2025, ku GRECO do të vlerësojë nivelin e zbatimit për rekomandime, si: masat e integritetit për personat me funksione politike, vlerësimet e riskut të korrupsionit dhe procesin e *vetting*-ut në Policinë e Shtetit, zbatimin e mjeteve të sinjalizimit, përpos atyre të vlerësuar shumë mirë në fazën e parë, ku përmenden nivelet e transparencës së administratës publike dhe kryesisht të informacioneve të bëra

publike për funksionarët e lartë politikë, për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe të konfliktit të interesave dhe për ecurinë e mirë të miratimit dhe zbatimit të instrumenteve të integritetit.

Në raportin më të fundit të OECD/SIGMA (2024), fusha e prokurimit publik ka marrë vlerësimin më të lartë lidhur me cilësinë e kuadrit ligjor, kapacitetin institucional dhe administrativ qendror për të zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive politikat e prokurimit publik, si dhe zhvillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesave. Miratimi i ligjit nr. 16/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, 'Për prokurimin publik'", solli ndërhyrje prioritare në sektorin e prokurimit publik, duke rritur përputhshmërinë me rekomandimet e BE-së dhe duke ofruar disa risi kyçe për të siguruar barazi në tendera, transparencë dhe forcimin e mekanizmave kundër korrupsionit, përfshirë:

i. digjitalizimin e të gjithë sistemit të prokurimit publik;

ii. vlerësimin automatik të përputhshmërisë me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikimin e ofertuesve në fazën fillestare të parakualifikimit;

iii. profesionalizimin e mëtejshëm të të gjithë stafit përgjegjës dhe të angazhuar në ciklin e prokurimit përmes certifikimit dhe trajnimeve të detyrueshme;

iv. përcaktimin e qartë të detyrimit për autoritetet ose entitetet kontraktuese të marrin masa të përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur rastet e konflikteve të interesit që lindin gjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, në përputhje me legjislacionin aktual, për të shmangur deformimin e konkurrencës dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në vijim, i gjithë cikli i prokurimit publik do të hyjë në një fazë tjetër përmes injektimit të teknologjisë më të avancuar dhe proceseve të robotizuara në përputhje me standardet më të larta evropiane, për të zvogëluar në minimum tendenca ndërhyrjeje, në procesin e hartimit të kritereve dhe më pas në kontrollin e zbatimit të kontratave. Për të minimizuar edhe ndikimin e pashmangshëm të faktorit njerëzor në këtë proces, do të punohet për një proces të evidentimit të risqeve të korrupsionit në prokurimet publike, të cilat shkojnë përtej automatizimit, për të krijuar një sistem që krijon imunitet të plotë dhe jep besueshmëri për përdorimin me ndershmëri dhe efektivitet të fondeve publike.

Policia e Shtetit Shqiptar është identifikuar vazhdimisht si një sektor me rrezik të integritetit nga gjetjet e Komisionit Evropian. Si pjesë e agjendës së autoriteteve shqiptare për plotësimin e rekomandimeve të Raundit V të GRECO-s, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit". Ky ligj i ri adreson në mënyrë efektive disa rekomandime të GRECO-s:

- Zbatimin e politikave që adresojnë në mënyrë të duhur rrezikun e korrupsionit dhe të konfliktit të interesit në ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës;
- Miratimin e rregullave për eliminimin ose, minimalisht, kufizimin e rreziqeve të korrupsionit dhe të konfliktit të interesit, në lidhje me dhuratat private ose sponsorizimet për Policinë;
- Krijimin e një sistemi dhe emërimin e individëve të trajnuar dhe të besueshëm për ofrimin e këshillave konfidencialë mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e policisë;
- Hartimin e rregullave të qarta për kufizimet pas punësimit për oficerët e policisë.

Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e politikave për reduktimin progresiv të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së mirë, në vijim, qeveria shqiptare do të vijojë zbatimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale 2024–2030. Vizioni i Strategjisë së re është ndërtimi i institucioneve publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, dhe ofrojnë shërbime eficiente ndaj qytetarëve.

Duke njohur përhapjen dhe qëndrueshmërinë e korrupsionit, rrezikun e shfaqur në institucionet publike dhe specifikisht në disa sektorë të konsideruar vulnerabil, si: pronat, taksat, tatimet, prokurimet publike, shëndetësia dhe arsimi, fokusi madhor i strategjisë së re antikorrupsion do të jetë kalimi nga një qasje ndërsektoriale në një qasje kombëtare, gjithëpërfshirëse dhe të integruar. Në këtë drejtim do të vijojë puna për krijimin e një mase kritike ekspertize sektoriale brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në funksion të kryerjes së vlerësimit të riskut të korrupsionit në fushat e prokurimit publik dhe të drejtat pronësore, ndjekur nga miratimi i planeve të dedikuara sektoriale të integritetit. Ky proces do të vijojë më pas edhe në sektorët e tjerë të identifikuar me risk të lartë korrupsioni.

Një hapësirë të posaçme në këtë strategji do të ketë edhe sektori privat, bashkëpunimi i tij me sektorin publik për të përmirësuar eficiencën dhe zvogëluar ndërhyrjet për korrupsion. Si risi vjen edhe bashkëpunimi i shtuar me shoqërinë civile posaçërisht për rritjen e rolit aktiv të grave në luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu, në një fotografim të situatës aktuale mbi instrumentet e promovimit të integritetit, në nivelin qendror, aktualisht të gjitha ministritë e linjës (11), të gjithë ministrat e Shtetit (6), 48 institucione varësie të ministrive të linjës, dhe 3 institucione të pavarura (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kuvendi dhe KLP-ja) kanë në fuqi plane të dedikuara integriteti. Ndërkohë, në nivelin vendor, 24 bashki kanë në fuqi plane të dedikuara integriteti. Në vijim do të punohet intensivisht për rritjen e kulturës së integritetit dhe të llogaridhënies në administratën publike, në nivel qendror dhe vendor. Etika në administratën publike është, gjithashtu, një element themelor në Strategjinë për Reformën në Administratën Publike 2024–2030 (drejt finalizimit). Zbatimi i rregullave të etikës do të forcohet përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit në njësitë që monitorojnë etikën dhe menaxhojnë burimet njerëzore. Përmes këtyre masave, synohet avancimi i përgjegjshmërisë institucionale dhe konsolidimi i një administrate të bazuar në ndershmëri dhe integritet.

Në vijim do të punohet për promovimin e kapitalit njerëzor në administratën publike, mes të tjerash edhe përmes promovimit të modeleve të integritetit në administratë. Për këtë, masat për zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke përfshirë rritjen e ndjeshme të pagave dhe përmirësimin e sistemit të vlerësimit në punë, do të ndërthuren me masa për rritjen e integritetit të zyrtarëve publikë, me fokus të veçantë në fushat me risk.

Edukimi i shtuar për integritetin dhe ligjshmërinë do të prioritizohet si investimi më i qëndrueshëm në mbrujtjen që në moshë të hershme me standardet e mirëqeverisjes dhe frymën e zbatimit të ligjit. Për këtë, do të vijojë puna e nisur përgjatë vitit 2024 për rishikimin e Kurrikulës së dedikuar për Integritetin për nxënësit e shkollave fillore dhe të arsimit të mesëm të ulët (klasat 1–9). Kjo kurrikul synon të angazhojë nxënësit në një mënyrë bashkëkohore, interesante dhe interaktive për të diskutuar mbi kulturën e ligjshmërisë dhe për të promovuar një shoqëri pa korrupsion. Kurrikula do t'i njohë nxënësit me konceptet themelore që lidhen me integritetin dhe do të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin e tyre në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të bazuar në integritet.

Përgjatë vitit 2025 do të finalizohet dhe miratohet ligji i ri për konfliktin e interesit. Zbatimi i suksesshëm i këtij ligji do të përmirësojë ndjeshëm zbatimin praktik të rregullimeve ligjore. Po brenda vitit 2025 do të finalizohet rishikimi i mëtejshëm i ligjit nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", me synim përmirësimin e efektivitetit të ligjit për sinjalizuesit dhe forcimin e masave mbrojtëse për ta, për ta përafruar atë me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane.

Thellimi i luftës kundër korrupsionit lidhet me Agjendën 2030, në kuadër të realizimit të Objektivit 16 "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet", dhe më posaçërisht, Treguesit 16.5 "Ulja në mënyrë të konsiderueshme e korrupsionit dhe mitmarrjes në të gjitha format e tyre".

4. Digjitalizimi

Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikimit kanë çelur mundësi dhe oportunitete të reja të paimagjinueshme deri disa dekada më parë. Këto teknologji të reja të zhvilluara shumë vrullshëm janë mundësi për më shumë zhvillim, mirëqenie dhe demokratizim, por njëherazi paraqesin rreziqe që mund të krijojnë hendeqe të reja midis vendeve e civilizimeve të ndryshme apo edhe midis vetë shtresave të ndryshme të shoqërisë së një vendi, duke mbarsur konflikte potenciale sociale apo midis shteteve.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale, rrjeteve të telekomunikacionit/komunikimeve elektronike të shpejta dhe shumë të shpejta është një domosdoshmëri për të mbështetur të gjithë transformimin digjital të ekonomisë dhe zhvillimet inovatore në sektorë strategjikë, si: energji, transport, industri, arsim etj. si dhe përmirësimin rrënjësor të cilësisë së shërbimeve publike. Qeveria shqiptare ka vazhduar promovimin e TlK-ut në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika

të ndryshme të cilat e kanë TIK-un në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digjitale, zhvillimin e *broadband*-it, sigurinë kibernetike, ndërveprueshmërinë, të dhënat e hapura etj.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale *broadband*, 5G, tarifat e *roaming*-ut dhe në tërësi komponentët e integrimit digjital janë pjesë e angazhimeve rajonale të Ballkanit Perëndimor (BP) në Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021–2024 (CRM). Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor, si një përpjekje e përbashkët e partnerëve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe Komisionit Evropian (KE) është prezantuar si një nga gjashtë iniciativat e Komunikatës mbi një perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe angazhimin e BE-së me Ballkanin Perëndimor.

Qasja në informacion të paanë është sot më e lehtë se kurrë, por teprimi me informacion të pasigurt apo të rremë mbart rrezikun e deformimeve zhvillimore, sociale dhe kulturore.

Shqipëria është një shembull për t'u ndjekur gjatë viteve të fundit sa i përket transformimit digjital dhe digjitalizimit të shërbimeve publike. Pamjet e radhëve në sportele, pritjet pa fund, mbledhjet e një tufe letrash nga qytetarët dhe bizneset janë pjesë e të kaluarës. Si tregues kryesor i ofrimit të shërbimeve është arritur që 95% e të gjitha shërbimeve publike të ofrohen vetëm *online*.

Viti 2022 shënoi një ndryshim rrënjësor në shërbimin e administratës publike ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Që prej majit 2022, për të gjitha shërbimet publike për të cilat aplikohej nëpërmjet *e-Albania*, dhe përgjigja e tyre, dokumenti administrativ final ofrohet vetëm *online*, duke shmangur në këtë mënyrë plotësisht kontaktin e drejtpërdrejtë fizik të qytetarëve dhe bizneseve me institucionet publike dhe, rrjedhimisht, duke shmangur mundësitë për korrupsion.

Në *e-Albania* aktualisht ofrohen 1,247 shërbime elektronike vetëm *online*. Portali *e-Albania* vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare për qytetarët dhe bizneset 24/7.

Aktualisht janë të regjistruar 3.2 milionë qytetarë dhe biznese të cilët shërbehen çdo ditë nëpërmjet *e-Albania*, pa asnjë kosto shtesë, pa pritur në radhë dhe pa pasur asnjë kontakt fizik me punonjësit apo administratën. Për vitin 2024 janë marrë nëpërmjet *e-Albania* 15,000,000 shërbime publike, kryesisht në shërbime të gjendjes civile, turizëm, kulturë dhe art, financë dhe ekonomi, shërbime sociale, arsim, punë të jashtme etj., Që nga viti 2017 e deri më tani janë gjeneruar mbi 38 milionë dokumente me vulë elektronike, përkthyer kjo në kursime në kohë dhe kosto për qytetarët dhe bizneset. Nëpërmjet ligjit nr. 100, datë 12.9.2024, janë bërë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike", nëpërmjet këtyre ndryshimeve është synuar rregullimi i procesit të riinxhinierimit të shërbimeve, krijimin dhe funksionimin pranë AKSHI-t të Bordit Këshillimor, si organ konsultativ për çështjet e teknologjisë së informacionit, i cili zëvendëson Komitetin Ndërministror për Teknologjinë dhe Inovacionin, shfuqizimi i ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", i cili është ligji themeltar i funksionimit të ADISA-s, si dhe disa ndryshime të tjera teknike, me qëllim përmirësimin e ligjit të qeverisjes elektronike, disa prej të cilave janë evidentuar gjatë zbatimit të tij. Gjithashtu, ofrimi i shërbimeve të autentifikimit, nënshkrimit elektronik, vulës elektronike dhe certifikatës elektronike, të cilat mundësojnë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore dhe për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, është një tjetër ndryshim i bërë në projektligj.

Vendimi nr. 479, datë 24 korrik 2024, shënon miratimin e një metodologjie gjithëpërfshirëse dhe të standardeve teknike për përdorimin e Inteligjencës Artificiale (AI) në Republikën e Shqipërisë. Ai përshkruan se si sistemet e AI-së duhet të zhvillohen, menaxhohen dhe rregullohen brenda vendit, veçanërisht në institucionet e sektorit publik. Metodologjia e miratuar për përdorimin e AI-së në Shqipëri synon të sigurojë zhvillimin, menaxhimin dhe përdorimin e sistemeve të AI, në përputhje me standardet ndërkombëtare për siguri dhe etikë. Ajo klasifikon sistemet e AI-së sipas rrezikut që paraqesin dhe kërkon vëzhgim të vazhdueshëm për të siguruar që ato të jenë të sigurta dhe të ndershme. Për më tepër, përfshin masa për mbrojtjen e të dhënave, transparencën dhe mbikëqyrjen njerëzore. Është bazuar në parimet e OECD-së për përdorimin e sigurt të IA, si dhe aktit të AI-së të BE-së, miratuar së fundmi (*EU AI Act*).

Ky vendim është në përputhje me punën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për hartimin e Strategjisë së parë Kombëtare të Shqipërisë për Inteligjencën Artificiale, e cila është finalizuar dhe është në proces konsultimi me partnerët e huaj dhe më pas do të përcillet në Kryeministri për procedim të mëtejshëm. Zhvillimi i sektorit digjital do të mbajë në konsideratë 4 çështje që konsiderohen kyçe:

- Rritjen e aksesit në teknologjitë digjitale qoftë nga pikëpamja e penetrimit gjeografik, po ashtu edhe nga pikëpamja e përballueshmërisë financiare;
- Aftësitë digjitale jo vetëm të nxënësve, të rinjve/të rejave, profesionistëve të sektorit, por edhe të popullsisë në moshë madhore;
- Mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian;
- Sigurinë kibernetike në bashkërendim me partnerët tanë strategjikë euroatlantikë.

Një fokus i veçantë i është dhënë sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave, duke pranuar rolin e tyre vendimtar në një ekonomi digjitale. Iniciativat në këtë drejtim përfshijnë krijimin e një Qendre Qeveritare të Sigurisë Kibernetike (Gov-SOC), duke përdorur zgjidhjet e Microsoft për monitorimin dhe reagimin ndaj aktiviteteve në rrjetin qeveritar. Përveç Gov-SOC, është krijuar edhe qendra e monitorimit të rrjetit qeveritar, e cila luan një rol kryesor në sigurimin e monitorimit, sigurisë dhe efikasitetit të vazhdueshëm të rrjetit qeveritar dhe pajisjeve të lidhura me to.

Situata e zhvillimit të infrastrukturës digjitale ka përmirësim por mbetet ndarja e theksuar midis zonave urbane dhe rurale. Për arritjen e objektivave për *gigabit society* nevojiten investime të rëndësishme. Vizioni për zhvillimin e infrastrukturës digjitale "*Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri gigabit*" mbështetet në objektivat strategjikë që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës *broadband*, reduktimin e ndarjes digjitale dhe ofrimin e shërbimeve *broadband* gjithëpërfshirëse, dhe rritjen e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri *gigabit*.

Ligji nr. 87/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Bashkimit 'Evropa Digjitale' (2021–2027)" është një arritje e rëndësishme në kuadrin e transformimit digjital, duke i hapur rrugën pjesëmarrjes së personave juridikë shqiptarë nga sektori publik, privat dhe akademik në projektet e BE-së që lidhen me: Kompjuterë me Performancë të Lartë (HPC), Inteligjencën Artificiale, aftësitë digjitale të avancuara dhe aplikimi, dhe përdorimi më i mirë i aftësive dhe ndërveprueshmërisë digjitale. Gjatë vitit 2024, Shqipëria shënoi një arritje të rëndësishme në kuadër të Programit Digjital të Evropës (DEP), duke u shpallur fituese me dy konsorciume të cilat u njohën si *European Digital Innovation Hubs (EDIHs*). Gjithashtu, janë organizuar me sukses sesione informuese për thirrjet e hapura për EDIH dhe për iniciativa të tjera në kuadër të DEP. Përmes platformave të komunikimit të MIE-s dhe AKSHI-t, është siguruar një shpërndarje e vazhdueshme dhe transparente e mundësive për aplikim, duke ndihmuar aktorët shqiptarë të përfitojnë nga mbështetja e Bashkimit Evropian për inovacion dhe teknologji digjitale.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, gjatë vitit 2024, u shpall fituese dhe po implementon në bashkëpunim me *Western Balkan Investment Framework* projektin "Studim i fizibilitetit për krijimin e *High Performance Computing* për të dhënat e institucioneve qeveritare dhe ngritjen e një rrjeti të sigurt shkëmbimi informacioni për të mundësuar ndërveprueshmërinë rajonale në rajonin e Ballkanit Perëndimor". Qendra HPC do të jetë hapi tjetër në rrugëtimin e qeverisë për transformimin digjital që mundëson njohuri nga të dhënat e ruajtura në Qendrën e të Dhënave Qeveritare për shkak të analizave dhe përpunimit në kohë reale dhe do t'i mundësojë qeverisë sonë të jetë në përputhje me "Programin e Evropës Digjitale".

Synimi afatgjatë është të integrojmë AI-n në të gjithë sektorët, duke synuar një ndikim transformues në kujdesin shëndetësor, arsim, bujqësi, taksa dhe tatime etj. Iniciativa të tilla, si diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve asistuar nga AI, rrugëtimet e personalizuara të arsimimit dhe bujqësia precize, pritet të përmirësojnë ndjeshëm rezultatet e politikave dhe efikasitetin e shërbimeve. Për më tepër, këto iniciativa parashikohen të reduktojnë ndjeshëm punën manuale, të minimizojnë gabimet njerëzore dhe

të thjeshtojnë proceset në të gjithë administratën. Më 28 dhjetor 2023, u lançua versioni i parë i asistentit virtual të *e-Albania* (versioni 1.0), duke shënjuar një shtesë novatore në portalin e shërbimeve publike të qeverisë shqiptare. Asistenti virtual i *e-Albania*-s, i cili ndihmon në kohë reale qytetarët për pyetjet që mund të kenë për shërbimet *online*, iu përgjigj rreth 1 milion pyetjeve gjatë vitit 2024. Gjatë vitit 2025, asistenti (në versionin e tij 2.0) do të zhvillohet më tej në një modalitet të bazuar në zë.

Digjitalizimi si një qasje horizontale ka efekte shumëdimensionale në thuajse të gjithë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030, por më drejtpërdrejt efektet e tij lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 9: "Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit" dhe synimit 9.c: "Rritja e ndjeshme e aksesin ndaj teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe përpjekje për ofrim aksesi universal dhe të përballueshëm në internet në vendet më pak të zhvilluara deri në vitin 2030".

5. Bujqësia

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga një mbizotërim i aktivitetit ekonomik nga bujqësia, sektor i cili dominohet nga fermat e vogla dhe familjare. Këto njësi ekonomike luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por ato janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Në periudhën 2022–2023, edhe falë integrimit të një pjese të rëndësishme të fermerëve në skemat kombëtare të mbështetjes, ku mbështetja ndaj naftës ka pasur një rol thelbësor, numri i fermerëve që zotërojnë një NIPT fermeri është rritur ndjeshëm.

Madhësia e vogël e fermës tipike prej 1.2 ha, kombinuar me fragmentimin e tokës janë sfida kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë ndonëse fermat familjare luajnë rol kritik për sigurinë ushqimore të popullsisë shqiptare, si dhe për rritjen e mirëqenies në zonat rurale. Bujqësia kontribuon në 18.27% të prodhimit të brendshëm bruto dhe punëson 32.3% të fuqisë punëtore në vend. Agropërpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 viteve të fundit duke arritur në 24.4% të xhiros totale të bujqësisë. Tendencat pozitive dëshmojnë se sektori ka potencial të lartë për zhvillim dhe krijimin e vendeve të punës. Zonat rurale kanë, gjithashtu, një potencial të lartë për turizmin e qëndrueshëm të bazuar në natyrë, por i cili po vlerësohet dhe lidhet me sektorët e tjerë të ekonomisë lokale. Sektori i turizmit rural, i cili ofron punësim tërheqës për të rinjtë/të rejat dhe gratë, është një forcë shtytëse e rimëkëmbjes ekonomike. Zhvillimi i sektorit po nxjerr në pah nevojën për të punësuar të kualifikuar. Sektori shihet si një prej motorëve të zhvillimit të zonave rurale duke lidhur kështu në të njëjtën pikë prodhimin, përpunimin, dhe shërbimet ndaj produktit.

Vizioni për sektorin e bujqësisë synon të bëjë të mundur një sektor agroushqimor dhe të peshkimit të efektshëm, inovativ dhe të qëndrueshëm në Shqipëri, i cili të mund të përballojë më mirë presionet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe të reagojë ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, ndërkohë që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonave rurale.

Në funksion të këtij vizioni mbështetet adresimi i sfidave kryesore ekonomike, mjedisore dhe sociale për të përmirësuar mundësitë për zhvillimin e bujqësisë, peshkimit dhe biznesit në zonat rurale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë barazisë gjinore dhe tërheqjes së fermerëve dhe sipërmarrësve të rinj, për të përmbushur prioritetet e politikave të sektorit dhe ambiciet e procesit të akreditimit të BE-së.

Objektivat e përgjithshëm për sektorin e bujqësisë konsistojnë në:

- Promovimin e prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor;
- Forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve lidhur me klimën;
- Forcimin e strukturës social-ekonomike të zonave rurale;
- Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme;

Harmonizimin e plotë të legjislacionit me *acquis* të BE-së për tre kapitujt të udhëhequr nga MBZHR-ja:

Kapitulli 11: "Bujqësia dhe zhvillimi rural"; "Kapitulli 12: "Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare"; Kapitulli 13: "Peshkimi"; Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt

përafrimit me *acquis* të BE-së në klasterin 5 dhe kapitujt përkatës 11, 12 dhe 13, si dhe transferimi i njohurive dhe inovacioni.

Bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 2.4 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2025–2027, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.4 pikë përqindje. Eksportet bujqësore shqiptare gjatë vitit 2023 arritën vlerën 57 miliardë lekë (55, 667.3 mln ALL) (512 milionë euro), duke shënuar një rritje vjetore rreth 17.7% ose 77 milionë euro krahasuar me vitin 2022.

Eksportet bujqësore shqiptare gjatë 11M 2024 arritën vlerën 48.44 miliardë lekë (48,445 mln ALL) (480 milionë euro), duke shënuar një rënie me rreth -4.86% të vlerës në lekë ose rritje me +3% të vlerës në euro (+14 milionë euro) krahasuar me 11M 2023. Synimi sipas SKZHIE 2022–2030 është arritja e eksporteve bujqësore në vlerën 1 miliard USD.

Bujqësia ka ndikim thelbësor në shumë prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030, por më drejtpërdrejt efektet e saj lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 2: "Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme" dhe synimit 2.4: "Deri në vitin 2030, sigurimi i sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore që rrisin produktivitetin dhe prodhimin, që ndihmojnë ruajtjen e ekosistemeve, që forcojnë kapacitetin për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirës, përmbytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që përmirësojnë në mënyrë progresive cilësinë e tokës". Gjithashtu, Objektivin 12: "Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit". Harmonizimi i plotë i legjislacionit dhe sigurimi i kapaciteteve të nevojshme institucionale dhe administrative drejt përafrimit me *acquis* të BE-së në sektorin bujqësor.

Në vijim të procesit të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), si synimi politik dhe strategjik i Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), pas përfundimit të procesit të shqyrtimit analitik (*screening*) po përgatit pozicionin negociues dhe planin e veprimit për përafrimin me *acquis* në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me një plan të qartë të aktiviteteve të ardhshme. Për zbatimin e planit të veprimit, në lidhje me politikat e integrimit, harmonizimin e legjislacionit kombëtar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural me standardet dhe kërkesat e BE-së, MBZHR-ja luan një rol të rëndësishëm si udhëheqëse për tre kapitujt e *acquis* të BE-së (kapitulli 11, 12 dhe 13).

Plani i veprimit përcakton metodologjinë dhe dinamikën e transpozimit të *acquis* dhe përafrimin e legjislacionit, duke përfshirë zhvillimet e reja në Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP), Organizimin e tregut të përbashkët (CMO); Bujqësinë organike; Politikat e cilësisë etj., reformën e politikave dhe forcimin e kapaciteteve administrative në periudhën e paraanëtarësimit, duke përfshirë gjithashtu planin për krijimin e Agjencisë së Pagesave dhe Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS).

Transpozimi i duhur i *acquis* të BE-së në legjislacionin kombëtar dhe zbatimi i tij janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP). Shqipëria synon të transpozojë dhe zbatojë gradualisht *acquis* të BE-së në "Bujqësi dhe Zhvillim Rural" deri në vitin 2030. Disa masa, në përputhje me CAP-in, do të futen në periudhën e paraanëtarësimit dhe do të financohen nga buxheti kombëtar.

Përshtatja dhe implementimi i politikave bujqësore me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE (EU CAP), krahas të tjerash, ka në themel të saj mbështetjen e fermerëve dhe të agrobiznesit me pagesa direkte, grante investimesh dhe masa të tjera kundrejt përmbushjes së kushtëzimeve që lidhen me objektivat e parashikuar. Zbatimi gradual i këtyre masave mbështetëse të ngjashme me ato që aplikohen në vendet anëtare të BE-së do të bëjë të mundur edhe përfitimin dhe absorbimin e fondeve respektive të BE-së për vendin tonë që nga momenti i anëtarësimit.

Plani i veprimit ofron vlerësimin e burimeve të nevojshme dhe masat e zhvillimit të kapaciteteve të nevojshme për të forcuar programimin dhe zbatimin e politikës në përputhje me BE-në. Ky është një parakusht për menaxhimin dhe kontrollin e pagesave në bujqësi, në përputhje me rregullat e CAP-it, dhe rregullat e funksionimit të Fondit Evropian të Garancive Bujqësore (EAGF) dhe Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD).

Plani i veprimit përfshin, gjithashtu, buxhetin e vlerësuar për miratimin, zbatimin e legjislacionit dhe rregullave në përputhje me kërkesat e *acquis* të BE-së. Struktura aktuale organizative e MBZHR-së nuk mund të sigurojë zbatimin në kohë të aktiviteteve të parashikuara nga plani i veprimit, ndaj nevojitet rritje kapacitetesh administrative që kërkon rritje në buxhet për transpozimin dhe forcimin e tyre.

6. Turizmi

Sektori i turizmit po konsolidohet si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit. Gjatë periudhës janar–nëntor 2024 numri i vizitorëve të huaj që hynë në Shqipëri tejkaloi 11 milionë persona. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë për 9-mujorin e parë të 2024 tregojnë se shpenzimet e të huajve për udhëtim/turizëm në Shqipëri arritën një vlerë prej 3,8 miliardë euro. Gjithashtu, kjo industri, pati një kontribut total në punësim me rreth 250 mijë, duke zënë rreth 21.5% të numrit të të punësuarve në Shqipëri.

Investimet në turizëm përgjatë vitit 2023 vlerësohet se arritën një vlerë prej rreth 0.3 miliard USD[8], duke përbërë rreth 6.1% të të gjitha investimeve në vend, ndërsa deri në vitin 2034 kjo shifër pritet të rritet në 7.5%. Me synim inkurajimin dhe tërheqjen e investimeve strategjike, kuadri ligjor ekzistues u ofron investitorëve strategjikë mekanizma nxitjeje dhe mbështetjeje, duke i konsideruar këto investime si prioritet dhe duke garantuar një sërë masash, shërbimesh dhe lehtësirash administrative të cilat do të zbatohen deri në 31 dhjetor 2026, pas të cilës datë do të miratohet një kuadër ligjor i ri. Një zhvillim të vrullshëm kanë pasur vitet e fundit të tri kategoritë kryesore të turizmit në vend – turizmi bregdetar, ai tematik (agroturizmi, kulturor etj.), si dhe turizmi natyror për të cilat Shqipëria ka potenciale të paçmuara zhvillimi.

Sfidat kryesore me të cilat lidhet zhvillimi i turizmit në Shqipëri kanë të bëjnë me natyrën sezonale të turizmit të bregdetit, përqendrimit të turizmit dhe mbipopullimit në zonat bregdetare gjatë sezonit veror, mungesës së fuqisë së kualifikuar punëtore, mungesa e standardizimit dhe sistemit të klasifikimit, informalitetit, zgjidhja e problemit të pronësisë, lidhjet jo të mira të infrastrukturës së transportit, veçanërisht atij detar etj.

Vizioni për zhvillimin e turizmit: "Shqipëria është destinacioni i ri më emocionues në Evropë, që ofron vlerën më të mirë të bazuar në aspektet e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë" mbështetet në arritjen e qëllimeve të mëposhtme strategjike:

- Mbështetjen e sektorit privat dhe investimeve në turizëm të qëndrueshëm në të gjithë zinxhirin e vlerës që krijohet brenda vendit sipas standardeve më të mira ndërkombëtare;
- Ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet përmirësimit të kornizave të arsimit profesional dhe të arsimit të lartë, dhe harmonizimit të tyre me nevojat e tregut dhe të sektorit, si dhe krijimin e qendrave rajonale të kompetencës në arsimin profesional për turizmin dhe hotelerinë;
- Nxitjen dhe zhvillimin e rrjeteve digjitale dhe shërbimeve që burojnë prej tyre, duke bashkërenduar me sektorin privat të turizmit, ofruesit e teknologjive dhe inovatorët;
- Zbatimin e investimeve që i kthejnë zonat e mbrojtura në parqe natyrore, me infrastrukturë të përshtatshme për vizitueshmërinë e tyre ku krijohet ekonomi e qëndrueshme;
- Zhvillimin e aktiviteteve të turizmit detar;
- Organizimin e eventeve të ndryshme me karakter kulturor, sportiv dhe jo vetëm, në gjithë vendin.

Turizmi lidhet me disa nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 por më drejtpërdrejt efektet e saj lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 8: "Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë" dhe synimit 8.9: "Deri në vitin 2030, hartimi dhe zbatimi i politikave për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet vendase".

7. Energjia

Sektori i energjisë është një prioritet kyç i SKZHIE 2022–2030 dhe gur themeli i zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë, duke luajtur një rol të dyfishtë në ruajtjen e rritjes së shpejtë në industri të ndryshme, si dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës për familjet shqiptare. Shqipëria e ka

[8] Raporti I WTTC "*The Economic Impact of Travel & Tourism-Albania 2024*".

përafruar kuadrin e saj legjislativ me direktivat e BE-së për të nxitur praktikat e qëndrueshme të energjisë, veçanërisht përmes ligjit të energjisë së rinovueshme, të vitit 2023, që promovon përdorimin e energjisë së rinovueshme, redukton varësinë nga lëndët djegëse fosile dhe integron Shqipërinë në tregjet rajonale të energjisë.

Sektori kontribuon ndjeshëm në performancën ekonomike të vendit, me energjinë e rinovueshme që është një tipar përcaktues i sektorit. Fuqia energjetike e Shqipërisë mbështetet shumë në burimet e rinovueshme, duke e pozicionuar vendin si lider në adoptimin e energjisë së rinovueshme. Qëllimi kryesor i sektorit është që deri në vitin 2030, të bëhet një eksportues neto i energjisë, duke balancuar prodhimin dhe konsumin e energjisë vendase, duke reduktuar ndikimet mjedisore, duke nxitur zhvillimin me karbon të ulët, duke rritur kontributet e energjisë së rinovueshme, si dhe duke rritur pavarësinë e energjisë përmes diversifikimit të burimeve të energjisë dhe reduktimin e varësisë nga tregjet globale.

Strategjia energjetike e Shqipërisë, deri në vitin 2030, mbështet një vizion më të gjerë të një tregu energjie të koordinuar të Ballkanit Perëndimor, duke nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë, duke përmirësuar konkurrencën rajonale, si dhe duke krijuar vende pune "të gjelbra". Iniciativat përfshijnë projekte bashkëpunuese për integrimin e sistemit energjetik dhe zhvillimin e kornizave të politikave për përfshirjen sociale dhe reformën fiskale për kalimin drejt rritjes me karbon të ulët.

Kapaciteti total i prodhimit të energjisë në vitin 2023 arriti në 2675 mw (+26 mw nga viti 2022). Prodhuesi publik KESH kontribuoi me 58.3% të prodhimit total të energjisë elektrike, me 8,796 gwh të prodhuara, 30% mbi mesataren 2009–2023. Kapaciteti i transmetimit ishte 10,148 gwh dhe rrjeti i shpërndarjes përbëhej nga 65,764 km linja të tensionit të mesëm dhe të ulët, me humbje energjie në 18,93%, pak më poshtë objektivit prej 19,63%. Konsumi total gjatë vitit 2023 arriti në 7,875,861 mwh, duke reflektuar një rënie prej 6,4% nga viti 2022, për shkak të zhvendosjeve ekonomike dhe rritjes së vetëprodhimit nga bizneset gjatë krizës energjetike. Konsumatorët familjarë zënë 39.5% të konsumit total, duke shënuar një rritje të lehtë nga viti 2022.

Në vitin 2022, burimet e rinovueshme përbënin 44% të konsumit total të energjisë, gati dyfishi i mesatares së BE-së prej 23%. Kapaciteti i instaluar i energjisë së rinovueshme arriti në 2,614 mw, duke shënuar një rritje prej 600 mw që nga viti 2017, kryesisht përmes projekteve diellore dhe të erës. Ankandet e suksesshme fotovoltaike në 2022 shtuan 240 mw kapacitet diellor. Ankandet e energjisë së erës dhanë 222 mw në kapacitet në tre projekte, duke mundësuar marrëveshje afatgjata për kontratat e blerjes së energjisë elektrike 15-vjeçare.

Në vitin 2023, prodhimi vendas i energjisë u rrit me 32,5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, duke sinjalizuar rimëkëmbjen dhe përmirësimin e efikasitetit.

Zhvillimet në sektor gjatë vitit 2024 nxorën në pah rritjen e jashtëzakonshme të energjisë diellore, e cila kontribuoi në 6.75% të totalit të energjisë së prodhuar (430,000 mwh), një rritje e konsiderueshme nga 1% në 2023 (72,500 mwh). Vetëm centrali diellor i Karavastasë përbënte 55% të prodhimit të energjisë diellore. Janë dhënë një rekord prej 16 licencash të reja për projektet diellore, me kapacitet të planifikuar, gjithsej, 253.14 mw. Kjo ka tejkaluar 9 licencat në 2023 (102 mw) dhe 15 në 2022 (225 mw). Impianti diellor lundrues në Vaun e Dejës (12,97 mwp) ka avancuar drejt zbatimit, i parashikuar të gjenerojë mesatarisht 17,822 mwh në vit. Rregullimet ligjore të paraqitura u mundësonin prodhuesve dhe konsumatorëve që kapacitete më të larta diellore (mbi 0.5 mw) të lidhen me rrjetin pa stimuj nga qeveria. Gjatë vitit janë iniciuar ankandet për projektet solare 300 mw me marrëveshje afatgjata të blerjes nga qeveria.

Zgjerimi i kapaciteteve gjeneruese pritet të vazhdojë trendin me fokus në rritjen e prodhimit të energjisë diellore dhe të erës bazuar në investimet e sektorit privat për të rritur më tej kontributet e energjisë së rinovueshme. Reformat në tregun e energjisë elektrike kulmuan me krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë në 2023, duke lehtësuar 827,541 mwh në tregti me një çmim mesatar prej 106.5 €/mwh dhe duke lejuar çmimet konkurruese të energjisë dhe një integrim më të madh në tregun ndërkombëtar. ALPEX-i ka iniciuar ankandet e energjisë brenda ditës, duke rritur transparencën dhe

efikasitetin në tregun shqiptar dhe atë të Kosovës. Mbi 2,100 biznese (20 kV) dolën nga tregu i rregulluar në fillim të vitit 2024, me 2,600 të tjera (10 kV) që do të pasojnë deri në vitin 2025.

Qeveria inkurajon investimet në sektorin e energjisë, duke ofruar një kuadër mbështetës dhe transparent për investime, duke nxitur IHD-të në këtë sektor, duke forcuar sistemet e transmetimit të energjisë për të mbështetur tregtinë e brendshme dhe rajonale të energjisë përmes shkëmbimeve energjetike lokale dhe rajonale, si dhe duke promovuar praktika eficiente ndaj energjisë në të gjithë sektorët, duke përfshirë banesat rezidenciale, ndërtesat publike, sistemet e furnizimit me ujë dhe vaditjen. Qeveria jep stimuj për sektorin privat dhe familjet si programi i subvencionimit për sistemet diellore të ngrohjes së ujit, duke ulur me 20% faturat e energjisë.

Pavarësisht reduktimit të humbjeve të shpërndarjes së energjisë nga 42% në 18.9% midis 2013-s dhe 2023-shit, një pjesë e energjisë elektrike të furnizuar ende mbetet e pa llogaritur, duke theksuar nevojën për përmirësime të mëtejshme. Luhatjet sezonale në konsumin e energjisë dhe mbështetja e tepërt në hidrocentralet e bëjnë Shqipërinë vulnerabël ndaj varësisë nga importi i energjisë. Sektori i energjisë është shumë i ndjeshëm ndaj modeleve të reshjeve, duke kërkuar diversifikimin dhe investimet në burime të tjera të rinovueshme.

Sektori i energjisë mbetet kritik për elasticitetin ekonomik të Shqipërisë dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Duke zgjeruar kapacitetet e energjisë së rinovueshme, duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke përafruar politikat me standardet e BE-së, Shqipëria është e pozicionuar mirë për të arritur pavarësinë dhe qëndrueshmërinë energjetike. Angazhimi i vendit për të modernizuar sektorin e tij energjetik jo vetëm që do të rrisë stabilitetin e brendshëm, por do ta vendosë Shqipërinë si një lider rajonal në energjinë e gjelbër.

Në funksion të bashkëpunimit rajonal për energjinë, në fillim të janarit 2025, qeveria shqiptare së bashku me qeverinë italiane dhe atë të Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me vlerë prej rreth 1 miliard eurosh (1.02 miliardë dollarë) për të krijuar një rrjet energjetik nënujor për të importuar energji të rinovueshme përmes detit Adriatik. Marrëveshja synon të forcojë infrastrukturën ekzistuese të energjisë dhe kapacitetin e energjisë së rinovueshme brenda rajonit të Mesdheut.

Sipas projektit, që parashikohet të finalizohet brenda 3 viteve, rrjeti i ndërlidhjes së energjisë do të shtrihet rreth 430 km përgjatë shtratit të detit Adriatik, që lidh Italinë me Malin e Zi dhe rajonin e Ballkanit. Projekti do t'i mundësojë vendit të tregtojë energjinë e rinovueshme të prodhuar në vend.

Energjia lidhet me Agjendën 2030, në kuadër të realizimit të Objektivit 7: "Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë" dhe synimit 7.1: "Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit universal në shërbime energjie me kosto të përballueshme, të besueshme dhe moderne".

Projekti i Kërkimit për vendet e Ballkanit Perëndimor WB6, "Inventari i Subvencioneve të Energjisë, OECD *Development Centre Project 2025"*

Qendra e Zhvillimit të OECD-së po zbaton një projekt në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë *, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi) për të mundësuar një ***Tranzicion të Drejtë në Ballkanin Perëndimor përmes sektorit të koordinuar të energjisë, mbrojtjes sociale dhe reformave fiskale.***

Realizimi i një rimëkëmbjeje të gjelbër të fokusuar në tranzicionin e energjisë është një nga prioritetet kryesore për Ballkanin Perëndimor. Subvencionet dhe çmimet artificialisht të ulëta të energjisë elektrike vazhdojnë të pengojnë konkurrencën e ndershme për energji elektrike alternative dhe përmirësimet në eficiencën e energjisë, duke mbyllur kështu pjesën më të madhe të rajonit në një rrugë zhvillimi me karbon të lartë. Në të njëjtën kohë, subvencionet ekzistuese bllokojnë burime të konsiderueshme publike që mund të kanalizohen më mirë për të mbështetur shtresat vulnerabël dhe për t'u përdorur për investime të tjera. Projekti synon të ndihmojë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor në adresimin e kryqëzimit të këtyre sfidave për të krijuar kushte për zhvillim me karbon të ulët dhe social gjithëpërfshirës. Ai synon të arrijë:

- Gjenerimin e **opsioneve konkrete të politikave** për reformat e koordinuara të sektorit të energjisë, fiskale dhe mbrojtjes sociale për të reduktuar ndikimin mjedisor të zhvillimit duke nxitur një rritje më gjithëpërfshirëse;

- Përgatitjen e vlerësimeve të **potencialit për krijimin e vendeve të gjelbra të punës (*green jobs*)** dhe rekomandime për krijimin e një mjedisi mbështetës për krijimin e vendeve të gjelbra të punës;

- Krijimin e një **shtytjeje ose motivimi për zbatim** përmes shkëmbimit të të mësuarit nga kolegët që bashkon politikëbërësit kryesorë dhe ekspertët nga rajoni dhe më gjerë.

Informacioni Gjeohapësinor

Me miratimin e dokumentit të politikave "Për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, 2020–2030", qeveria shqiptare ka vendosur infrastrukturën e gjeoinformacionit si një nga elementet kryesore që ndikojnë në mirëqeverisjen dhe zhvillimin e vendit. Në këtë dokument kuptohet qartë roli i ASIG-ut si drejtues dhe përgjegjës në zbatimin e masave, në lidhje me funksionimin e sistemit të gjeoinformacionit në Republikën e Shqipërisë.

ASIG-u operon që nga viti 2014 dhe ka arritur rezultate pozitive në krijimin e NSDI-së (Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Hapësinore/*National Spatial Data Infrastructure*), si:

- Projektimi dhe krijimi i kornizës referuese gjeodezike;
- Krijimi i Gjeoportalit Kombëtar (https://gjeoportal.asig.gov.al/);
- Projektimi i Ortoimazherisë dhe DTM & DSM 2015–2017, në nivel kombëtar;
- Projektimi i hartave topografike në shkallë të mëdha;
- Hartimi i standardeve teknike për NSDI-në.

Për realizimin e këtyre objektivave, ASIG-u ka pasur mbështetje jo vetëm nga qeveria shqiptare por edhe nga donatorët, ku vlen të përmendet qeveria norvegjeze nëpërmjet Agjencisë Hartografike Norvegjeze – *Statens Karteverket*, e cila ka mbështetur për krijimin, standardizimin dhe publikimin e informacionit gjeohapësinor në Shqipëri.

ASIG-u ka hartuar një listë projektesh që do të mundësojë realizimin e objektivave të paracaktuar prej tij, bazuar në përgjegjësitë ligjore, si dhe respektimin e masave të përcaktuara në dokumentin e politikave të sipërpërmendur. Këto projekte do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në fusha të tilla, si:

- Asistencën për Emergjencat Civile në nivel qendror dhe lokal;
- Zhvillimin e turizmit;
- Menaxhimin e infrastrukturës rrugore;
- Planifikimin urban;
- Rritjen e kapaciteteve dhe aksesit për gjeoinformacion në pushtetin vendor;
- Menaxhimin dhe inventarizimin e infrastrukturave inxhinierike.

2.2 PROGRAMET IPA 2022-2027 DHE FUSHAT PRIORITARE TË TYRE

IPA 2021

	Dokumenti i veprimit	(mln. euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për drejtësinë	8	MD
2	BE për të drejtat e pronësisë	10	KM, ASHK
3	BE për natyrën/SPIN	6	MTM
4	BE për ekonominë qarkulluese	30,9	MTM
5	BE për inovacionin	10	MEKI
Totali		**64,9**	

IPA 2022

	Dokumenti i veprimit	(mln. euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për sektorin e ujit	29	MIE, AMBU, MTM
2	EUIF (*instrumenti lehtësues për integrimin evropian*)	19	MIE, MBZHR, MF, MSHKN
3	BE për demokracinë	5	Kuvendi, KQZ
4	BE për rininë	5	MSHRF, MFE, MAS

5	BE për agjencitë e zbatimit të ligjit	14.9	MB
6	OMN/*Vetting*-u – Faza II	9.7	MD
Totali		**82.6**	

IPA 2023

Mbështetje buxhetore sektoriale prej **80 mln euro** për Shqipërinë: "*Kontrata e ndërtimit të shtetit dhe rezistencës për Shqipërinë*", pjesë e planit vjetor të veprimit që kontribuoi në Paketën e Mbështetjes Energjetike të Ballkanit Perëndimor në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2023.

	Dokumenti i veprimit	**(mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	Kontrata e ndërtimit të shtetit dhe rezistencës për Shqipërinë	80	MIE, MFE, MSHMS
Totali		**80**	

IPA 2024

	Dokumenti i veprimit	**Indikative (mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	Mbështetje për kuadrin institucional të antikorrupsionit	3.85	MSHAP, ILDKPKI
2	BE për qeverisjen vendore	10	MSHPV
3	BE për pyjet – ForestAl	13	MTM
4	BE për Sigurinë Ushqimore	12.5	MBZHR
5	BE për punësimin dhe përfshirjen sociale, faza II (Mbështetje Buxhetore).	28 (24 SBS + 4 TA)	MEKI, MSHMS
Totali (indikative)		**67.35**	

PROGRAMET OPERACIONALE 2024–2027

	Programet operacionale	**Kostoja indikative (mln euro)**	**Përfituesit**
1	Programi operacional për punësimin e të rinjve	63.48 (50 EU + 13.48 bashkëfinancim i qeverisë shqiptare)	MFE, MAS, MSHMS, MSHRF
2	Programi operacional për ekonominë dhe shoqërinë digjitale	44 (30 EU – 14 bashkëfinancim i qeverisë shqiptare)	AKSHI, MSHMS, MAS, MF, AKCESK, AKEP
3	Programi operacional për energjinë	79 (50 EU – 29 bashkëfinancim i qeverisë shqiptare)	MIE, AEE, AKUM
Totali		**186.48 (130 EU+ 56.48 bashkëfinancim i qeverisë shqiptare)**	

IPA 2025

	Dokumenti i veprimit	**(mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	BE për drejtësi të integruar dhe të drejtat e njeriut	25,563	MD dhe institucionet e pavarura të gjyqësorit.
2	BE për lëndët e para kritike	8	MIE
Totali indikativ		**33,563**	

IPA 2026

	Dokumenti i veprimit	**(mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	BE për mirëqeverisjen e integruar	22.437	MAPA, MSHPV, MF.
2	Instrumenti lehtësues i Integrimit Evropian	25.5	SASPAC, MSH dhe KN, MF,MSHMS, Bashkitë

Totali indikativ		**47,937**	

IPA 2027

	Dokumenti i veprimit	(mln euro)	Institucioni Përgjegjës
1	BE për sundimin e ligjit dhe demokracia	18.5	MB, dhe agjencitë të varësi Policia Shtetit, Akademia e Sigurisë, Agjencia për Administrimin e Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Përfitues të tjerë MF, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Kuvendi, KQZ etj.
Totali indikativ		**18.5**	

Buxhetet e dokumenteve të veprimit në kuadër të IPA 2025–2027 janë indikative dhe mund të pësojnë ndryshime pas procesit të vlerësimit nga Komisioni Evropian deri në miratimin final të tyre.

IPARD III

Vendimi i KE-së, datë 9.3.2022, për IPA III *Rural Development programme* (IPARD III) për Republikën e Shqipërisë në vitet 2021–2027. Kontributi maksimal indikativ i Bashkimit Evropian për zbatimin e programit IPARD III është vendosur në 112,000,000 euro, i ndarë në vite si më poshtë:

Viti	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**
Totali	**8**	**10**	**12**	**16**	**19**	**23**	**24**

2.3 PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT ME BANKËN BOTËRORE

Në vitin 2023 u ratifikuan katër programe bashkëpunimi me BB, (i–iv) dhe dy programe (v–vi) janë në proces për periudhën në vijim. Në total kemi 6 programe bashkëpunimi me Bankën Botërore:

i. Projekti i ndërtimit të urave të qëndrueshme, 100 milionë $; Marrëveshja është ratifikuar me ligjin nr. 80/2023;

ii. Projekti "Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë", 70 milionë $; Marrëveshja është ratifikuar me ligjin nr. 98/2023;

iii. Projekti i Qasjes Universale në Shërbime Publike me Standard të Lartë (GovTECH), 60 milionë €; Marrëveshja është ratifikuar me ligjin nr. 45/2023;

iv. Financimi i politikave të zhvillimit, 120 milionë $; Marrëveshja është ratifikuar me ligjin nr. 93/2023;

v. Mjedis i pastër dhe i sigurt për detin blu, 80 milionë $;

vi. Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, 132 milionë euro.

KREU III

3.1 KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL

1. Vështrim i përgjithshëm i objektivave ekonomikë

Gjatë viteve të fundit ekonomia e Shqipërisë ka demonstruar një elasticitet të jashtëzakonshëm, duke përballuar me sukses një sërë sfidash të rëndësishme. Vendi është përballur me disa goditje të njëpasnjëshme, duke përfshirë tërmetin e vitit 2019, pandeminë globale të COVID-19 dhe ndërprerjet e zinxhirëve të furnizimit të shkaktuara si pasojë e luftës Rusi–Ukrainë në vitin 2022. Pavarësisht këtyre sfidave të mëdha, fondamentet ekonomike dhe financiare të vendit, së bashku me stabilitetin makroekonomik, kanë dëshmuar qëndrueshmëri të fortë. Ekonomia ka tejkaluar pritshmëritë fillestare, duke shënuar rritje të fuqishme në secilin prej këtyre viteve. Edhe në vitin 2024, Shqipëria ka vijuar të shënojë performancë të qëndrueshme ekonomike, të udhëhequr nga rritja në sektorët e shërbimeve dhe të ndërtimit, e mbështetur nga konsumi privat, investimet dhe eksportet, të cilat kanë luajtur një rol kyç

në nxitjen e aktivitetit ekonomik. Parashikimet afatmesme tregojnë një trajektore të qëndrueshme dhe pozitive, duke përforcuar aftësinë e vendit për të përballuar dhe rikuperuar nga kushtet e pafavorshme ekonomike. Elasticiteti dhe përshtatshmëria e treguar gjatë kësaj periudhe e pozicionojnë vendi për një rritje të mëtejshme dhe të qëndrueshme në të ardhmen.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të mbrojtjes dhe forcimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Politika fiskale do të vijojë të targetojë një trajektore graduale rënëse të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të targetohet në nivel pozitiv që prej vitit 2024 dhe do të vijojë e tillë në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskalë në LOB.

Balanca primare parashikohet mesatarisht në rreth 0.5 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme vijuese 2025–2027. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target është edhe ligjërisht i detyrueshëm, ku një rregull fiskal në LOB përcakton që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare duhet të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Në vitin 2025, balanca primare është projektuar në nivel neutral dhe të vazhdojë të zgjerohet më tej në normën prej 0.7 për qind në vitin 2026 dhe në 0.9 për qind në vitin 2027.

Si rrjedhojë, borxhi publik ndaj PBB-së do të vazhdojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin fiskal përkatës. Në vitin 2024, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 55.2 për qind të PBB-së nga rreth 57.5 për qind në vitin 2023 dhe pritet të vazhdojë të bjerë më tej në rreth 54.8 për qind në vitin 2025. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 53.2 për qind në vitin 2027 dhe më tej në rreth 48 për qind deri në vitin 2031.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, do të synohet që të ruhet një raport i shëndetshëm i shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do të targetohen të jenë mbi 5 për qind e PBB-së në çdo vit buxhetor për periudhën 2025–2027 (mesatarisht 6.1 për qind në vit), duke përfshirë këtu investimet e reja publike që potencialisht do të mundësohen në kuadër të Planit të Ri të Rritjes të zbatuar nga Bashkimi Evropian me synimin përfundimtar për një zhvendosje të konsiderueshme të rritjes potenciale në vendet e Ballkanit Perëndimor). Ndërkohë që deficiti buxhetor për këtë periudhë targetohet në mesatarisht rreth 2.0 për qind në vit. Rrjedhimisht, bilanci korrent fiskal targetohet gjithmonë pozitiv, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal ("rregullin e artë" të buxhetit), konkretisht në mesatarisht rreth +4.1 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme 2025–2027.

2. Zhvillimet e fundit ekonomike

Ekonomia shqiptare ka ruajtur kahun pozitiv të zhvillimit gjatë vitit 2024. Rritja ekonomike vijoi e qëndrueshme, e shoqëruar nga rritja e punësimit dhe e pagave, ndërsa shkalla e papunësisë mbeti në nivele të ulëta historike. Inflacioni ka vazhduar të bjerë, duke u pozicionuar pranë – por pak nën – objektivin 3%. Treguesit kryesorë financiarë, përfshirë borxhin publik dhe atë të huaj shënuan përmirësime të dukshme. Po ashtu, sektori financiar ishte solid, i mbështetur nga banka të mirëkapitalizuara, likuide dhe fitimprurëse, ndërsa raporti i kredive të këqija mbeti në nivele të ulëta. Këto zhvillime pozitive u evidentuan edhe në përmirësimin e vlerësimit të kreditit të Shqipërisë nga *Moody's* në Ba3 me një perspektivë të qëndrueshme.

Ekonomia vazhdoi të rritet me një ritëm të qëndrueshëm dhe prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 3.9% në gjysmën e parë të vitit 2024, duke ruajtur dinamikën e vërejtur gjatë vitit 2023. Kjo rritje u diktua kryesisht nga performanca e mirë e turizmit dhe rritja e kërkesës së brendshme. Kjo e fundit u rrit me 5% në gjysmën e parë të vitit 2024, duke përshpejtuar ritmin në krahasim me vitin e kaluar (2.7%). Ky përshpejtim reflektoi njëkohësisht rritjen më të shpejtë si të konsumit me 5.2% (nga 3.25% në 2023), ashtu edhe të investimeve me 3.8% (nga 1.0% në 2023). Nga ana tjetër, megjithëse eksportet e turizmit u rritën me rreth 25.5%, kontributi i eksporteve neto në rritjen ekonomike ishte negativ. Ky kontribut u përcaktua nga rritja më e shpejtë e importit të mallrave dhe shërbimeve, dhe rënies së eksporteve të mallrave.

Nga një këndvështrim sektorial, rritja e PBB-së u nxit kryesisht nga rritja e aktivitetit në sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit. Sektori i shërbimeve kontribuoi me 2.9 pikë përqindjeje në dy-tremujorët e parë të vitit, ndërsa ndërtimi kontribuoi me 1.0 pikë përqindjeje. Në të kundërt, sektori industrial vazhdoi të japë kontribut negativ, veçanërisht nga sektori i minierave dhe prodhimit, gjë që u reflektua edhe në uljen e eksporteve të mallrave. Ndërkohë, kontributi i bujqësisë në rritje mbeti i papërfillshëm.

Rritja e PBB-së është mbështetur nga një sërë faktorësh, përfshirë bilancet e forta të sektorit privat, optimizmin e biznesit dhe të familjeve, kushtet e favorshme të financimit dhe vazhdimësinë e investimeve të huaja direkte (IHD). Për më tepër, rritja u mbështet nga politikat e kujdesshme makroekonomike: politika fiskale konsoliduese çoi në uljen e ndjeshme të borxhit publik, ndërsa politika monetare e matur vuri në kontroll inflacionin dhe politika mikro e makroprudenciale forcuan rezistencën e sektorit bankar.

Rritja e PBB-së u shoqërua me rritje të punësimit dhe pagave. Ndërsa statistikat zyrtare nga Anketa e Forcës së Punës ende nuk janë publikuar, të dhënat administrative sugjerojnë se punësimi u rrit me 1.3% në gjysmën e parë të vitit 2024, kryesisht në reflektim të rritjes së punësimit në sektorin e shërbimeve. Në përputhje me tendencat e viteve të fundit, pagat vazhduan të rriten edhe gjatë vitit 2024, duke reflektuar kushtet e shtrënguara në tregun e punës. Këto të fundit dëshmohet edhe në vrojtimet e besimit, të organizuara me kompanitë private të cilat identifikojnë gjithnjë e më shumë mungesën e fuqisë punëtore si një pengesë kryesore për zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik. Pagat në sektorin privat u rritën me 9.5% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2024 dhe kjo rritje ishte me bazë të gjerë në të gjithë sektorët dhe profesionet.

Rritja e shpejtë e eksporteve të shërbimeve, të investimeve të huaja direkte dhe të remitancave kanë kontribuar në përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë dhe mbiçmimin e lekut gjatë viteve të fundit. Deficiti i llogarisë korrente shënoi 1.3% të PBB-së gjatë dy-tremujorëve të parë të vitit, duke u qëndruar pranë nivelit të vitit të shkuar prej 1.2%. Kjo periudhë shfaqi një rritje të importeve, të nxitura nga zgjerimi i shpejtë i kërkesës së brendshme. Megjithatë, eksportet e mallrave pësuan rënie, për shkak të një mjedisi të pafavorshëm të jashtëm në terma të kërkesës dhe çmimeve, si dhe nga ndikimi i mbiçmimit të lekut. Në kontrast, eksportet e shërbimeve – të udhëhequra kryesisht nga turizmi – vazhduan të performojnë pozitivisht, duke shënuar një rritje prej 19.9% krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit 2023. Në të njëjtën kohë, remitancat u rritën me një ritëm të përshpejtuar prej 14.3%, ndërsa flukset e IHD-ve u zgjeruan me 5.8% gjatë kësaj periudhe.

Leku vazhdoi prirjen e tij mbiçmuese gjatë vitit 2024, megjithëse me një ritëm më të moderuar krahasuar me vitin 2023. Pas një tremujori të parë të qëndrueshëm, monedha rifilloi trajektoren mbiçmuese prej muajit prill, me kursin e këmbimit EUR/LEK që ra në 98.4 në tetor dhe nëntor nga 103.8 në tremujorin e parë. Mbiçmimi vjetor mbeti i fortë deri në maj dhe u moderua më pas, duke arritur në 6.2% në tetor dhe nëntor. Presionet e vazhdueshme për forcimin e kursit vijuan të burojnë nga rritja e flukseve hyrëse valutore të ushqyera nga rritja e turizmit, remitancave dhe IHD-ve. Tregu i këmbimit valutor ka funksionuar normalisht, i karakterizuar nga rritje e volumit të tregtimit dhe volatilitet i ulët.

Shqipëria ka forcuar qëndrueshmërinë e saj ndaj goditjeve të mundshme të jashtme. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së ka rënë në 44% në gjysmën e parë të vitit 2024, nga 47.2% në fund të vitit 2023. Rezervat ndërkombëtare, gjithashtu, janë rritur duke arritur në 24% të PBB-së gjatë nëntëmujorit të parë të vitit.

Inflacioni i çmimeve të konsumit vazhdoi trendin rënës gjatë vitit 2024. Ai zbriti në 2.1% në fund të vitit 2024, nga 4.8% në vitin 2023. Kjo rënie u ndikua, fillimisht, nga rënia e inflacionit të çmimeve të ushqimeve, dhe, më tej, u intensifikua nga rënia e çmimeve të naftës gjatë muajve të fundit. Paralelisht me to, mbiçmimi i vazhduar i lekut vijoi të ushtrojë presione disinflacioniste. Ndërsa rënia e çmimeve të ushqimeve ishte një trend rajonal, ndikimi i saj në inflacionin e Shqipërisë u amplifikua nga pesha jashtëzakonisht e lartë e ushqimeve në shportën e konsumit (rreth 40). Kontributi i inflacionit të çmimeve të ushqimeve në inflacionin total ra në 1.1 pikë përqindjeje në vitin 2024, nga 3.6 pikë

përqindjeje në vitin 2023. Ndërkohë, kontributi i kategorive të naftës ka mbetur në territor negativ (-0.1 pp nga 0.5 pp në 2023) dhe kontributi i kategorive të tjera është luhatur pranë vlerave të vitit 2023.

Procesi disinflacionist u nxit më së shumti nga rënia e shpejtë e inflacionit të importuar. Ky i fundit reflektoi rënien e çmimeve globale të mallrave dhe mbiçmimin e kursit të këmbimit. Kontributi i këtij komponenti në inflacionin total ka rënë në rreth 15%, nga një mesatare historike prej 45%. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste – të nxitura nga rritja e kërkesës, kushtet e shtrënguara në tregun e punës dhe rritja e pagave – janë zbutur pjesërisht nga rritja e produktivitetit, marzhet më të ulëta të fitimit të biznesit dhe pritjet inflacioniste të ankoruara. Këto pritje reflektojnë normalizimin e kujdesshëm të politikës monetare gjatë viteve 2022–2023. Në reflektim të tyre, matjet e inflacionit të brendshëm dhe bazë kanë ardhur, gjithashtu, në rënie, ndonëse më ngadalë se inflacioni i importuar. Matjet e inflacionit bazë kanë rënë mesatarisht në 2.5% për 11 muajt e vitit 2024, nga 4.6% për të njëjtën periudhë një vit më parë.

Tregu financiar është karakterizuar nga kushte të mira likuiditeti, prime të ulëta rreziku dhe norma interesi në rënie. Reduktimet e normës bazë të ndërmarra nga BSH-ja kanë gjetur pasqyrim të gjerë në segmentet e tij. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë, pas një rritjeje të përkohshme në tremujorin e parë, kanë treguar prirje rënëse në vazhdim të vitit, duke zvogëluar diferencën me normën bazë, si dhe diferencat mes tyre. *Yield*-i 12-mujor ka rënë në 2.8% në muajin nëntor, nga 3.4% që ishte në fund të vitit të kaluar.

Normat e interesit të depozitave kanë vijuar rritjen graduale deri në gjysmën e parë të vitit, duke treguar për një tejçim të ngadaltë të rritjeve të mëparshme të normës bazë. Interesi mesatar i depozitave me afat, pasi kulmoi në 2.2% në tremujorin e dytë, nga 1.9% që ishte në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, ra sërish në ndjekje të reduktimit të normës bazë në muajin korrik.

Kombinimi i niveleve të ulëta të *yield*-eve dhe të kostos së depozitave dhe ngushtimit të primeve të rrezikut të kredisë, në përputhje me sinjalet nga politika monetare, ka çuar në uljen e normave të interesit në shumicën e segmenteve të kredisë gjatë vitit 2024. Ulja e tyre ka qenë më e pranishme tek kreditë për individë, e veçanërisht tek ato konsumatore. Interesi mesatar i kredive për individë rezultoi 6.4% në tremujorin tretë të vitit dhe 5.9% në muajin tetor, nga 6.7% në pjesën e parë të vitit dhe 7.0% në vitin 2023. Nga ana tjetër, interesi i kredive për biznese është shfaqur më i luhatshëm gjatë këtij viti. Në dhjetë muajt e parë, ai ka ruajtur nivelet mesatare të vitit të kaluar, prej 6.7%, por duke faktorizuar një rënie të interesit për kreditë mesatare dhe një rritje të tij për kreditë e vogla e të mëdha.

Kredia për sektorin privat u përshpejtua gjatë vitit 2024, e nxitur nga kërkesa më e lartë dhe kushte të favorshme financimi. Këto të fundit u mbështetën dhe nga një gatishmëri e lartë e bankave në kreditim, në përputhje me likuiditetin e bollshëm, rrezikun e ulët të kredisë dhe përmirësimin e përgjithshëm të besimit në ekonomi. Rritja vjetore e kredisë mesatarisht prej 14.5% për 10 muajt e parë të vitit 2024, ishte 6 pikë përqindje më e lartë se e njëjta periudhë një vit më parë. Zhvillimet në kreditim evidentojnë disa tendencat pozitive: i. rritja e kredisë është me bazë të gjerë, duke iu përgjigjur nevojave për financim si të individëve, ashtu edhe të bizneseve për konsum, kapital punues dhe investime; ii. kredia në lekë po rritet me një ritëm më të shpejtë se kredia në valutë, duke rritur kështu pjesën e portofolit të lekut në totalin e kredisë. Kjo prirje rrit efektivitetin e politikës monetare dhe zbut rreziqet për stabilitetin financiar; iii. cilësia e kredisë mbetet e mirë, sikurse ilustrohet nga raporti i kredisë me probleme ndaj totalit i cili qëndron në nivelet më të ulëta që nga viti 2008.

Kredia në lekë ka shfaqur një rritje të shpejtë prej 19%, dy herë më e lartë se ajo e vitit 2023. Kjo ecuri është mbështetur nga mbiçmimi i monedhës lekë, rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun e kursit të këmbimit dhe nga diferenciali negativ i interesave të kredisë së lekut ndaj euros. Si rrjedhojë, raporti i kredisë lekë ndaj totalit është rritur në 57.3%, duke u zgjerua me 7 pikë përqindjeje në dy vitet e fundit. Nga ana tjetër, kreditimi në monedhë të huaj është rritur me një normë të moderuar prej 8%; normë e ngjashme me vitin e shkuar.

Kredia për biznese është rritur mesatarisht me 15% deri në muajin tetor, normë kjo tre herë më e lartë se rritja e vitit 2023. Kjo ecuri është nxitur kryesisht nga kërkesa e lartë për financimin e projekteve të investimit, e cila ka sjellë rritjen e kredisë për investime mesatarisht me 15%. Kreditimi i investimeve

lidhet më së shumti me financimin e projekteve në infrastrukturë, turizëm dhe tregti, në përputhje me rritjen e kontributit të këtyre sektorëve në aktivitetin ekonomik në vend. Ndërkohë, likuiditeti i bollshëm i biznesit, siç konfirmohet edhe nga niveli i lartë i depozitave, është shoqëruar me një rritje të moderuar të kreditimit të biznesit për likuiditet, në 6%.

Gjatë së njëjtës periudhë, kredia për individë tregon një rritje të qëndrueshme në 14.4%, duke mbetur pranë mesatares së tri viteve të fundit. Brenda segmentit, rritja e përshpejtuar e kredisë për konsum ka ekuilibruar rritjen më të ngadaltë të kredisë hipotekare. Megjithatë, kjo e fundit mbetet kontribuesi kryesor i rritjes së kredisë për individë, me rritjen vjetore prej 16.3% dhe përfaqëson 67% të totalit të portofolit. Kredia për konsum ka shfaqur një përshpejtim të rritjes vjetore në 15%, duke rezultuar rreth 6 pikë përqindje më e lartë se në vitin 2023. Në përgjithësi, kreditimi i individëve është zgjeruar në monedhën vendase, mbështetur nga diferenciali negativ i normave së interesit, ndërgjegjësimi më i lartë për rrezikun e kursit të këmbimit, si dhe nga konkurrenca në rritje në sektorin bankar.

Depozitat e bankave kanë shfaqur norma të qëndrueshme rritjeje gjatë vitit 2024**.** Ato janë rritur mesatarisht në 10.8%, një normë kjo rreth 1 pikë përqindje më lart se në vitin 2023. Ndryshe nga një vit më parë, rritja e depozitave të lekut u përshpejtua në 9.3% – pothuajse tre herë më shpejt se një vit më parë – ndërsa depozitat në valutë në ngadalësuan në 12.5% Në tetor 2024, depozita në valutë përfaqësojnë rreth 53% të totalit, ose 2 pikë përqindje më pak se e njëjta periudhë një viti më parë.

Përmirësimi i rritjes së depozitave në lek reflekton ndërmjetësimin më të lartë në lekë nga bankat, uljen e *yield-ve* të letrave me vlerë dhe besimin më të lartë në sektorin bankar. Në të kundërt, niveli i lartë i depozitave të qeverisë në BSH ka ngadalësuar rritjen e depozitave në lekë.

3. Politika fiskale

Pas një stimuli të lartë, për të kryer një politikë fiskale ekspansioniste të domosdoshme dhe njëkohësisht të paevitueshme gjatë viteve 2020 dhe 2021, me qëllim amortizimin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale u rikthye qartësisht drejt konsolidimit, duke filluar prej vitit 2022. Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2025–2027, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Me synimin për të ruajtur të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, politika fiskale do të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv prej vitit 2024 dhe e në vijim, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskalë respektivë në LOB.

Balanca primare parashikohet në një mesatare prej rreth 0.5 për qind në vit gjatë periudhës së ardhshme afatmesme (2025–2027). Në vijim, projektojmë një balancë primare neutral për vitin 2025 dhe synojmë një suficit prej 0.7 për qind në vitin 2026 dhe duke arritur në 0.9 për qind në 2027-n.

Për rrjedhojë, ky angazhim ndaj kujdesit fiskal pritet të drejtojë borxhin publik bruto në një trajektore rënëse, duke u përafruar me rregullin fiskal përkatës. Shifrat e parashikuara për vitin 2024 tregojnë një rënie të borxhit publik në rreth 55.2 për qind të PBB-së nga afërsisht 57.5 për qind në vitin 2023. Prirja është vendosur të vazhdojë, me një ulje të mëtejshme të pritshme në rreth 54.8 për qind në vitin 2025. Sipas skenarit aktual bazë, borxhi publik pritet të ulet në rreth 53.2 për qind deri në vitin 2027, me një rënie të mëtejshme në afërsisht 48.0 për qind deri në vitin 2031 dhe (në mungesë të ndonjë shoku makroekonomik të konsiderueshëm negativ), duke qëndruar nën 45% të PBB-së deri në vitin 2034.

Në të njëjtën kohë, krahas angazhimit për konsolidim fiskal, ne do të përpiqemi të ruajmë një ekuilibër të kujdesshëm midis shpenzimeve buxhetore korente dhe kapitale. Konkretisht, shpenzimet kapitale të qeverisë qendrore, duke përfshirë pjesën më të madhe të investimeve publike, do të synohen në një mesatare vjetore prej 6.1 për qind të PBB-së përgjatë periudhës 2025–2027, duke përfshirë këtu edhe investimet e reja publike që potencialisht do të mundësohen në kuadër të Planit të Ri të Rritjes, të implementuar nga Bashkimi Evropian me synimin përfundimtar për një zhvendosje të konsiderueshme

të rritjes potenciale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo shpërndarje konsiderohet thelbësore për të mbështetur rritjen ekonomike si në afat të mesëm ashtu edhe në atë afatgjatë. Në të njëjtën kohë, deficiti i përgjithshëm buxhetor synohet të jetë mesatarisht 2.0 për qind në vit gjatë kësaj periudhe kohore. Ndaj, në bazë të strategjisë sonë fiskale qëndron përkushtimi për të ruajtur një bilanc fiskal korrent pozitiv, në përputhje me përcaktimet e "rregullit të artë" të buxhetit. Bilanci aktual fiskal, i llogaritur si diferencë ndërmjet investimeve publike dhe deficitit fiskal, pritet të jetë pozitiv në çdo vit dhe mesatarisht në +4.1 për qind të PBB-së në vit në harkun afatmesëm nga viti 2025 deri në vitin 2027. Më saktësisht, bilanci i përgjithshëm fiskal është synuar në -2.6 për qind për vitin 2025, i ndjekur nga objektivat prej -1.9 për qind për vitin 2026 dhe -1.6 për qind për vitin 2027. Njëkohësisht, shpenzimet kapitale janë parashikuar përkatësisht në 6.2 për qind, 6.1 për qind dhe 6.1 për qind për vitet 2025, 2026 dhe 2027. Për rrjedhojë, suficiti fiskal korrent i synuar është 3.6 për qind për vitin 2025 dhe 4.2 për qind dhe 4.5 për qind për 2026 dhe 2027, respektivisht.

4. Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Rritja ekonomike parashikohet të qëndrojë të paktën në vlerën 3.9 për qind për vitin 2024, nisur nga kushtet pozitive ekonomike, si dhe nga ecuria mjaft e mirë e sektorit të turizmit dhe aktivitetit të ndërtimit. Vlerësimet më të fundit të disponueshme nga INSTAT-i për PBB-në tremujore, korrespondojnë në mënyrë të plotë me parashikimin vjetor, pasi rritje reale e PBB-së për nëntëmujorin e parë të vitit shënoi vlerën prej 4 për qind. Për vitin 2025, rritja ekonomike parashikohet të qëndrojë në të njëjtin nivel, pra në 3.9 për qind. Gjatë periudhës afatmesme 2025–2027, rritja parashikohet të vijojë trendin pozitiv me mesatarisht në nivelin 3.9 për qind në vit, ndikuar nga zhvillimet e ekonomisë së brendshme dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Aktiviteti ekonomik do të vazhdojë të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, nga rritja e mëtejshme e konsumit privat, ashtu edhe nga investimet në infrastrukturë, si dhe zhvillimi i sektorëve strategjikë si turizmi. Gjithashtu, kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të kenë performancë pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Më konkretisht, konsumi final për periudhën afatmesme (2025–2027) parashikohet të rritet në terma real me rreth 2.5 për qind mesatarisht në vit, duke kontribuar me një mesatare prej 2.1 pp në vit në rritjen e përgjithshme. Ndërkohë që investimet parashikohen të rriten në terma real me një mesatare prej 5.9 për qind në vit, me një kontribut mesatar në rritjen e PBB-së prej 1.4 pp në vit.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2025–2027 parashikohen të rriten në terma real me një mesatare prej 4.4 për qind në vit, me një kontribut mesatar pozitiv prej 1.7 pp në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën afatmesme parashikohen të rriten me 3.0 për qind, me një kontribut mesatar negativ në rritjen totale me rreth -1.4 pp në vit. Për rrjedhojë, kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rriten e përgjithshme me një mesatare prej 0.3 pikë përqindjeje në vit.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej 0.2 për qind në vit gjatë periudhës 2025–2027. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe. Papunësia pritet të vazhdojë rënien graduale duke arritur në 9.3 për qind në vitin 2027.

Objektivi kryesor i politikës monetare është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Banka e Shqipërisë operon sipas një regjimi të shënjestrimit të inflacionit, me një objektiv afatmesëm për inflacionin e çmimit të konsumit prej 3.0% në vit. Politika monetare zbatohet në aplikimin e instrumenteve të tregut

dhe instrumenti kryesor për zbatimin e saj është norma e interesit e aplikuar për marrëveshjet e anasjella të riblerjes 7-ditore.

Banka e Shqipërisë ndjek një regjim të kursit të këmbimit të lirë dhe vlera e monedhës vendase kundrejt monedhave të tjera përcaktohet nga ndërveprimi midis kërkesës dhe ofertës në treg. Megjithatë, ajo rezervon të drejtën të ndërhyjë në tregun valutor për të ruajtur një nivel të përshtatshëm të rezervave valutore dhe për të siguruar stabilitetin monetar e financiar të vendit.

Ndërhyrjet për rezervë valutore kryhen përmes ankandeve, bazuar në një kalendar të publikuar paraprakisht. Deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka blerë rreth 134.2 milionë euro për rritjen e rezervës valutore. Përveç ankandeve, që prej 2 majit 2024, ajo ka nisur ndërhyrje direkte në treg për të frenuar mbiçmimin e shpejtë të lekut dhe për të kufizuar implikimet potenciale të tij në stabilitetin monetar e financiar të vendit. Në këtë kuadër, gjatë tremujorit të dytë, janë blerë 137.6 milionë euro.

Inflacioni ka vazhduar trendin rënës gjatë vitit 2024. Megjithatë, rënia ishte më e shpejtë se pritjet, e shkaktuar kryesisht nga goditje pozitive të ofertës së jashtme – të shprehura në rënien e inflacionit të çmimeve të ushqimeve dhe naftës. Këto goditje krahas mbiçmimit të vazhduar të kursit të këmbimit e shtynë inflacionin poshtë objektivit 3%. Paralelisht me rënien e inflacionit të importuar, presionet inflacioniste nga ekonomia vendase kanë ardhur në rënie, gjithashtu, duke u afruar gjithnjë e më pranë me objektivin për inflacionin. Reduktimi i tyre ka reflektuar një përcjellje të pjesshme të rritjes së pagave në çmimet e konsumit dhe ndikimin e politikës monetare në stabilizimin e pritjeve për inflacionin në një kohë kur inflacioni qëndronte në nivele të larta.

Banka e Shqipërisë ndoqi një kurs normalizues të politikës monetare nga marsi 2022 deri në nëntor 2023, duke e rritur normën bazë të interesit nga 0.5% në 3.25%. Ky qëndrim ishte i suksesshëm në reduktimin e inflacionit nga nivelet e larta pa rrezikuar perspektivën e rritjes ekonomike.

Politika monetare u lehtësua gjatë vitit 2024. Rënia e inflacionit dhe rreziku që kjo ecuri të ndikojë pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin në të ardhmen – duke vështirësuar kthimin e tij në objektiv – motivoi Bankën e Shqipërisë të ulë normën bazë të interesit gjatë vitit 2024. Norma bazë e interesit u ul dy herë në muajt korrik e nëntor, duke zbritur në 2.75%.

Banka e Shqipërisë parashikon që inflacioni të rritet gradualisht drejt objektivit deri në vitin 2025. Efektet e goditjeve pozitive të ofertës pritet të vazhdojnë deri në fund të vitit dhe të shuhen më tej, duke lehtësuar kthimin e inflacionit të importuar tek nivelet historike të kontributeve të tij në inflacion. Paralelisht me të, rritja e ekonomisë pranë potencialit të saj dhe ankorimi i pritjeve inflacioniste në objektivin 3% pritet të mbështesin kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv.

Balanca e rreziqeve ndaj inflacionit është e zhvendosur për poshtë në afat të shkurtër dhe neutrale në afat të mesëm. Rreziku në afatin e shkurtër lidhet më së shumti me një rënie të mëtejshme të çmimeve globale të mallrave. Nga ana tjetër, një rritje më shpejtë se parashikimi e pagave paraqet një rrezik për lart, ndërsa një mbiçmim më i shpejtë i kursit të këmbimit një rrezik për poshtë.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të mbetet e përkushtuar ndaj arritjes së stabilitetit të çmimeve. Vendimet e ardhshme për normën bazë të interesit do të kalibrohen me kujdes dhe do të orientohen nga të dhënat e reja. Kjo qasje, krahas një strategjie komunikimi të orientuar nga e ardhmja, do të mundësojnë që BSH-ja të reagojë me efektivitet ndaj ndryshimeve në perspektivën makroekonomike, duke garantuar, gjithmonë, stabilitetin e çmimeve dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste. Në skenarin bazë, qëndrimi aktual i politikës monetare vlerësohet i përshtatshëm për të mbështetur kthimin e inflacionit në objektivin e tij në vitin 2025.

Miksi aktual i politikave makroekonomike është mbështetës për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe forcimin e stabilitetit financiar. Fokusi i politikës fiskale në konsolidimin e financave publike dhe uljen e borxhit ndihmon në kontrollin e presioneve inflacioniste të brendshme, duke krijuar, gjithashtu, hapësirë fiskale për përballimin e goditjeve të mundshme në të ardhmen. Po ashtu, politika monetare, me fokusin për të mbajtur inflacionin në nivele të ulëta dhe të qëndrueshme, dhe politika makroprudenciale, me fokusin për të forcuar shëndetin e sektorit financiar, do të kontribuojnë në ruajtjen e një mjedisi makroekonomik të qëndrueshëm, me stabilitet monetar dhe

financiar, i cili është kyç për rritjen e qëndrueshme dhe të shëndetshme të ekonomisë në afatin e mesëm dhe afatgjatë. Ndërkohë, reformat strukturore të gjera, në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, do të kontribuojnë në orientimin e ekonomisë drejt një trajektoreje më të shpejtë zhvillimi.

5. Përshkrimi i risqeve financiare

Intensifikimi i tensioneve gjeopolitike mund të ketë pasoja në ekonomi duke shkaktuar çmime të larta të mallrave, ulje të shkëmbimeve tregtare, rritje të kufizimeve financiare dhe ulje të besimit të biznesit dhe konsumit. Luhatjet e mundshme të çmimeve të mallrave, si rezultat i ndërprerjes së tregtisë nga konfliktet, pasiguritë dhe kufizimet e eksportit, mund të çojnë në paqëndrueshmëri të çmimeve të mallrave, duke ushtruar presion mbi rritjen ekonomike dhe të ardhurat fiskale.

Një rritje e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, të përkeqësojë ekuilibrin e llogarisë korente, dhe të rrisë deficitin buxhetor. Për më tepër, një skenar i tillë ngre rreziqe fiskale që lidhen me sektorin e energjisë.

Ekonomia shqiptare mund të ndikohet nga një recesion i mundshëm në Evropë si pasojë e uljes të kërkesës së jashtme. Kjo rënie mund të prekë veçanërisht sektorë të tillë si turizmi dhe të çojë në një reduktim të remitancave.

Frekuenca në rritje e motit ekstrem dhe fatkeqësive natyrore mund të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike, produktivitetin dhe deficitet fiskale.

Sulmet e mundshme kibernetike mund të ngadalësojë shërbimet publike dhe ato financiare. Kërcënime të tilla kibernetike mund të pengojnë zgjerimin dhe përdorimin e shërbimeve publike digjitale dhe ato të sistemeve bankare dhe financiare.

Propozimi i dokumentit të politikave prioritare:

Bazuar në të dhënat e kuadrit makroekonomik, sektorët prioritarë të dokumentit DPP 2026–2028, do të vijojnë të financohen, por politikat e reja duhet të akomodohen brenda tavaneve ekzistuese. Gjithashtu, projektet e reja strategjike do të akomodohen brenda tavaneve të vitit 2027, bazuar në kushtin që investimet të fillojnë në vitin 2027.

Shënim sqarues. Duke filluar nga viti 2026, disponohet hapësirë fiskale për fillimin e projekteve të reja strategjike. Tavanet e vitit 2025 janë ezauruar me projektet në vazhdim. Politikat e tjera, të cilat kërkojnë financim sipas këtij draftdokumenti janë tashmë të akomoduara në tavanet buxhetore.

KREU IV

4.1 PROGRAME PRIORITARE TË REJA PËR PERIUDHËN 2025–2027

1. Programi i garancisë rinore

Qeveria shqiptare do të nisë pilotimin e një programi të ri për përfshirjen e të rinjve/të rejave në tregun e punës. Skema e Garancisë Rinore synon të reduktojë largimin e të rinjve/të rejave nga Shqipëria, si dhe papunësinë për të rinjtë/të rejat, që është në nivelet mbi mesataren e papunësisë referuar kategorisë NEETs (as në edukim, as në punësim dhe as në trajnim). Programi është lançuar në tetor–nëntor 2023 dhe faza pilot ka filluar të zbatohet në 2024-n në tri Bashki Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe pritet zgjerimi, dhe aplikimi i plotës i skemës në vijim.

Ky program do të zbatohet në bashkëpunim me Bashkimin Evropian dhe si institucione zbatuese janë AKPA-ja, AKR-ja etj. Pritet edhe angazhimi i strukturave rinore si këshilla vendorë rinorë, organizata rinore, punonjës rinorë etj., në mënyrë që skema të jetë sa më efektive.

2. Programi i kodimit në shkolla

Qeveria shqiptare në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) po zbaton projektin e kodimit që në klasën e I. Faza e parë e implementimit të projektit nisi gjatë vitit 2022, dhe përfshin ngritjen e 100 laboratorëve "*smart*" në 100 shkollat pilot, hartimin e një kurrikule mësimore "TIK" tërësisht të re për klasat e para, rreth 60% e së cilës zhvillon aftësitë e programimit (kodimit) të nxënësve dhe implementohet nëpërmjet një platforme *online* (*CodeMonkey*) të integruar në platformën SMIP për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimin e kodimit, dhe mendimit kritik dhe logjik për nxënësit e klasave të para në 100 shkolla, për vitin shkollor 2022–2023, hartimin e manualeve të mësuesve dhe librave të punës së nxënësve të klasave të para, si dhe trajnimin e mësuesve për

implementimin e kurrikulës së re të TIK-ut në klasën e parë. Faza e parë e implementimit përgjatë vitit mësimor 2022–2023 rezultoi e suksesshme, bazuar në procesin e vlerësimit të implementimit të lëndës, që u realizua nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

Përgjatë vitit 2023 filluan përgatitjet për implementimin e fazës së dytë të këtij projekti, në vitin arsimor 2023-2024, ku u përfshi monitorimi i implementimit të fazës së parë të projektit, hartimi i kurrikulës së klasës së dytë së bashku me manualin e mësuesit dhe librin e punës së nxënësit, trajnimi i mësuesve për mësimdhënien në klasën e parë dhe të dytë, përfshirja e shkollave jopublike të interesuara në program për të implementuar fazën e parë, etj. Në shtator të 2023-shit nisi implementimin faza e dytë e programit, e cila përfshin mësimdhënien e kurrikulës së klasës së dytë në 100 shkollat fillestare pilot dhe shtrirjen e mësimdhënies së kurrikulës së klasës së parë në 306 shkolla publike gjithsej (ka përfunduar ndërtimi i *smart labeve*), si dhe në 40 shkolla jopublike. Gjatë vitit 2024 është pilotuar edhe mësimdhënia e kurrikulës së klasës së tretë.

Kurrikulat e klasës së parë dhe të dytë sigurojnë që fëmijët të kenë mundësi të përftojnë aftësitë e nevojshme për të përdorur kompjuterin e për t'u orientuar me pjesët e ndryshme të tij, të mësojnë bazat e programimit nëpërmjet një platforme që i mundëson që bashkë me mësuesit të ndjekin aventura të ndryshme të kodimit e të zhvillojnë aftësi të mendimit kritik, algoritmik dhe logjik.

Synimi afatgjatë i këtij projekti është riformatimi i të gjithë kurrikulës së lëndës së teknologjisë së informacionit, duke përfshirë këtu dhe kurrikulën aktuale që ndiqet nga klasa e katërt deri në të nëntën, por edhe në gjimnaz, si dhe pajisja me laboratorë "*smart*" e të gjitha shkollave të arsimit parauniversitar.

Në vijim disa të dhëna statistikore:

- Janë ngritur **100 laboratorët e parë *smart*** nëpër shkolla, në **34 qytete**;
- Në fazën e parë të projektit janë përfshirë **270 klasa të para** me **7076 nxënës**;
- Në fazën e dytë të projektit janë përfshirë mbi **645 klasa të para** me mbi **15000 nxënës**, si dhe **270 klasa të dyta** me **7076 nxënës**;
- Janë hartuar dhe miratuar zyrtarisht kurrikula e klasës së parë dhe kurrikula e klasës së dytë në bashkëpunim me ekspertin e huaj të kontraktuar nga AADF-ja dhe ekspertët shqiptarë të ASCAP-it dhe AKSHI-t;
- Në fazën e parë janë trajnuar **118 mësues**, gjatë **4 fazash trajnimi** përgjatë periudhës shtator 2022 –shkurt 2023;
- Në fazën e dytë është përfunduar faza e parë e trajnimit të 346 mësuesve, si dhe faza e dytë e trajnimit;
- Janë hartuar, prodhuar dhe shpërndarë 'Manuali i mësuesit' dhe 'Libri i punës për nxënësit' për klasat e dyta në të 100 shkollat pilot të projektit.
- Kurrikula e klasës së tretë – gjatë vitit 2024 është realizuar dhe përshtatur në shqip kurrikula e TIK-ut për klasën e III, e cila është miratuar nga MAS-i. Realizuar dhe përshtatur në shqip libri i punës për nxënësin TIK, për klasën e III.

3. Programi i nxitjes së kodimit

Në kuadër të rritjes së shpejtë së nevojës për talente njerëzore në arritjen e potencialit të plotë dhe të shpejtë të digjitalizimit të Shqipërisë, qeveria shqiptare ka vlerësuar që, krahas mënyrave tradicionale të edukimit, duhet nxitur dhe modeli i formimit për punë përmes qendrave të formimit profesional në fushën e programimit kompjuterik dhe kodimit, që i **mundëson individëve pa përvojë në shkencat kompjuterike, brenda një periudhe relativisht të shkurtër të aftësohen dhe të kalojnë në një karrierë në industrinë teknologjike**.

Për këtë arsye qeveria ka përgatitur një skemë mbështetjeje për ndjekjen e këtyre programeve nga të rinjtë/të rejat, punëkërkuesit dhe punëmarrësit që duan të zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale.

Faza e parë e implementimit të skemës së mbështetjes ka filluar zbatimin nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, në janar 2023. Aktualisht janë në proces përgatitjet për të vijuar me implementimin e fazës së dytë të projektit.

Financimi ofrohet sipas kritereve të mëposhtme:

- Pjesëmarrësit **punëkërkues të papunë të regjistruar**, financohen në masën **100%**, por, në asnjë rast, më të lartë **se 300,000 (treqind mijë) lekë** të kostos së kursit të formimit profesional;

- Ç'do pjesëmarrës **punëkërkues apo punëkërkues i punësuar i regjistruar**, financohet në vlerën **50% t**ë **kostos** së kursit të formimit profesional, por, në asnjë rast, më të lartë se **150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë**;

- Për **personat me aftësi të kufizuara**, institucionit të formimit profesional, publik apo privat, i financohen elementet e përshtatjes së arsyeshme, për sa u përket programeve të veçanta të trajnimit, kurrikulës së përshtatur, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar, përgatitjen e instruktorëve për të ofruar trajnim të posaçëm për këtë kategori, **deri në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë.**

Informacione për procesin:

- Aplikimi kryhet **nëpërmjet portalit *e-albania*,** nën përshkrimin: "Aplikim për kursin e formimit profesional me mbështetje financiare";

- Aplikuesit përzgjedhin akademinë ku dëshirojnë të marrin formimin profesional dhe pas validimit të aplikimit të tyre kontaktohen nga kompania për të kryer testin e pranimit;

- Kursantët, të cilët përfitojnë nga kjo mbështetje **kanë detyrimin të qëndrojnë** dhe të kërkojnë punë brenda Republikës së Shqipërisë, për një periudhë **jo më pak se 2-vjeçare**, menjëherë pas mbarimit të kursit, në të kundërt janë të detyruar të kthejnë 100% të vlerës së mbështetjes financiare të përfituar, sipas skemës së përcaktuar në këtë vendim.

Të dhëna statistikore për implementimin e programit përgjatë vitit 2023 dhe 2024:

- Në program kanë aplikuar 5242 individë për të ndjekur kurset profesionale me mbështetje financiare, nga të cilët kanë kaluar procesin e vlerësimit dhe kanë filluar kursin 1162 individë, duke tejkaluar synimin paraprak për vitin 2023 që 1000 të rinj të përfitonin nga kjo skemë;

